Violeta Shamku

# LIBËR PËR MËSUESIN
# Muzika 8

BOTIME

pegi

# Përmbajtja

**1. Hyrje**

- Pse shërben ky libër?
- Çfarë synon ky libër?
- Çfarë përmban ky libër?

2. **Kompetencat** dhe kuptimi i tyre

2.1. *Kompetencat kyçe* dhe rezultatet e të nxënit

2.2. Lidhja e muzikës me *fushat e tjera kurrikulare*

2.3. *Kompetencat lëndore muzikore*, dhe krijimi i tyre përmes zbatimit të njohurive të tematikave.

3. **Planifikimi i mësimdhënies në muzikë**

3.1. Planifikimi vjetor "Muzika 8"

3.2. Planifikimi sipas periudhave (shtator – dhjetor; janar – mars; prill – qershor)

3.3. Planifikimi ditor

**4. Vlerësimi për të nxënë dhe i të nxënit në muzikë**

4.1. Krijimi i *portofolit të të nxënit*

4.2. Llojet e vlerësimit: *Vlerësimi i vazhdueshëm, periodik* dhe *përfundimtar.*



# Hyrje

## *I dashur koleg/e!*

Muzika është një disiplinë artistike që ndihmon nxënësit/et të kuptojnë dhe lidhin fenomenet dhe dukuritë muzikore, proceset dhe çështjet që i përkasin muzikës, duke gjykuar dhe vërtetuar ligjshmërinë e tyre. Shpjegimi i mënyrave të krijimit, interpretimit dhe ndërtimit të formave muzikore, çon drejt realizimit të një procesi të suksesshëm të mësuarit në muzikë. Muzika është disiplina, e cila qëndron mes të gjitha formave të tjera inteligjente të njeriut (arteve në përgjithësi, shkencave shoqërore e historike dhe shkencave artistike), si një përbërës i barabartë me to i progresit intelektual dhe i humanitetit.
Ndaj zhvillimi i muzikës në shkollë është një vlerë e madhe për të mundësuar:
- edukimin dhe formimin kulturor,
- zhvillimin e personalitetit të nxënësve/eve,
- zhvillimin e aftësive të tyre për të punuar dhe krijuar në mënyrë të pavarur e sistematike si dhe për të menduar në mënyrë krijuese dhe kritike.

### › *Pse shërben ky libër?*

Ky libër do t'u shërbejë mësuesve/eve të muzikës, të zhvillojnë aftësitë e tyre profesionale, duke kuptuar më së miri qasjen me bazë kompetencat për zbatimin e saj edhe në muzikë.

### › *Çfarë synon ky libër?*

Zbatimi i mësimdhënies bazuar në qasjen me ***kompetenca***, do të shërbejë si një udhërrëfyes për të gjithë mësuesit/et e muzikës të AB-së, të cilët do të ndërtojnë punën e tyre të përditshme bazuar në njohjen e dokumentacionit të ri: *korniza kurrikulare, kurrikula bërthamë e arteve, programi mësimor.* Ndërsa vlerësimi bazuar në *nivelet e arritjes së kompetencave kyçe dhe ato lëndore,* përkojnë me tri faza mjaft të rëndësishme:
a) planifikimin e të nxënit përmes situatave të të nxënit;
b) planifikimin e metodologjisë së mësimdhënies;
c) vlerësimin e të nxënit bazuar në nivelet e arritjes për realizimin e qasjes së re me kompetenca.
Qëllimi i këtij libri është të orientojë mësuesit/et të planifikojnë mësimdhënien, duke përmbushur synimet e programit mësimor, për ndërtimin e *kompetencave kyçe dhe lëndore muzikore*, si dhe për të planifikuar dhe realizuar detyrat e tyre si mësimdhënës së kësaj lënde, konform dokumenteve zyrtare dhe fazave nëpër të cilat kalon mësimdhënia.

## › *Çfarë përmban ky libër?*

Ky libër është konceptuar në përputhje me programin e klasës së tetë, përkatësisht shkalla e katërt e lëndës Muzikë, miratuar nga MAS-i.
Ky libër merr përsipër ***të sqarojë*** çdo mësues/e të muzikës për të gjitha çështjet e *planifikimit, metodologjisë* dhe *vlerësimit të nxënësve/eve,* që duhet të zbatojë çdo mësues/e në lëndën e tij. Kështu libri:

- ***drejton*** me modelet e dhëna rreth formateve të planifikimit *vjetor, tremujor, ditor;*
- ***drejton dhe udhëzon*** mbi krijimin e *portofolit të të nxënit të nxënësve;*
- ***drejton dhe shpjegon*** *format e vlerësimit* bazuar mbi *nivelet arritjes së nxënësve/eve*;
- ***shpjegon*** kuptimin e simboleve të përdorura në *tekstin e nxënësit/es* duke sjellë modele të veprimtarive që përmban ky tekst, me të cilat duhet të punojë mësuesi/ja gjatë një viti shkollor.

Ndryshe nga çka mësuesi/ja është mësuar të gjejë në një libër mësuesi, ky libër në parim jep dhe ofron modele ose sugjeron modele, por nuk i dikton ato. Çdo model që ka të bëjë me planifikimin, situatat e të nxënit, metodologjinë, krijimin e portofolit të të nxënit apo vlerësimin, krijohet mbi një bazë të caktuar të realitetit dhe nivelit të klasës ku mësuesi/ja jep mësim.

Realiteti në çdo klasë, mund të sugjerojë modele të ndryshme, për tema të caktuara**.**

**AUTORJA**



# II KOMPETENCAT DHE KUPTIMI I TYRE

Muzika zhvillohet në të gjithë arsimin e detyruar përmes 4 shkallëve, që përfshijnë *arsimin fillor* (AF) klasat 1-5 dhe *arsimin e mesëm të ulët (AMU)* klasat 6-9, pra, dy cikle arsimimi, të cilat përfshijnë 9 vite shkollimi brenda katër shkallëve.

*Të katërta shkallët grupohen në mënyrë të tillë:*

- ***shkalla e parë:*** parashkollori (mosha 5-6 vjeçare) – klasa dytë
- ***shkalla e dytë:*** klasa e tretë – klasa e pestë
- ***shkalla e tretë:*** klasa e gjashtë – klasa e shtatë
- ***shkalla e katërt:*** klasa e tetë – klasa e nëntë

## 2.1 Kompetencat kyçe dhe lëndore

*Kompetencat kyçe* dhe ato *lëndore* shprehen nëpërmjet *rezultateve të të nxënit* që tregojnë njohuri, shkathtësi, vlera dhe qëndrime në trajtimin e plotë dhe të kuptueshëm të situatave kontekstuale në të cilën zhvillohet përmbajtja muzikore.

Domosdoshmëria e zotërimit të kompetencave i aftëson individët/et/nxënësit/et të bëhen të aftë/a dhe t'i përdorin ato përgjatë gjithë jetës.

**Kompetencat kyçe janë:**

1. *Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit;*
2. *Kompetenca e të menduarit;*
3. *Kompetenca e të mësuarit për të nxënë;*
4. *Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin;*
5. *Kompetenca personale;*
6. *Kompetenca qytetare;*
7. *Kompetenca digjitale.*

Rezultatet kryesore të të nxënit sipas kompetencave kyçe që realizohen nëpërmjet lëndës së muzikës për shkallën e katërt (shkëputur nga Programi mësimor, miratuar nga MAS-i).



# SHKALLA E KATËRT
# KLASA E TETË

**Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit**

**Nxënësi/ja:**
- zhvillon personalitetin e vet dhe është aktiv në veprimtaritë artistike;
- gjykon drejt mesazhin artistik;
- shprehet nëpërmjet një komunikimi të qartë dhe saktë me anë të gjuhëve, simboleve, shenjave dhe formave muzikore;
- shfrytëzon mjetet artistike dhe mundësitë e komunikimit dhe të të shprehurit në muzikë në mënyrë të pavarur, të vazhdueshme, kritike dhe krijuese.

**Kompetenca e të menduarit**

**Nxënësi/ja:**
- përpunon njohuritë muzikore në mënyrë të pavarur, krijuese dhe me përgjegjësi;
- zgjidh probleme të ndryshme muzikore/artistike;
- zhvillon aftësitë për të menduar në mënyrë kritike, krijuese dhe ndërvepruese;
- ndjek udhëzimet për të realizuar një krijim apo veprimtari muzikore artistike.

**Kompetenca e të mësuarit për të nxënë**

**Nxënësi/ja:**
- vendos mjetet në funksion të realizimit të krijimit muzikor;
- përdor burime të ndryshme informacioni për të realizuar një krijim muzikor;
- krijon në mënyrë të pavarur detyrën e dhënë.

**Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin**

**Nxënësi/ja:**
- merr përsipër ose drejton aktivitetet muzikore brenda dhe jashtë klasës duke kontribuar në mënyrë krijuese.

**Kompetenca personale**

**Nxënësi/ja:**
- krijon besimin te vetja gjatë veprimtarive muzikore;
- merr pjesë në mënyrë aktive në jetën artistike shkollore dhe komunitet;
- ndërgjegjëson veten dhe zhvillon vetëbesimit dhe krijimin e besimit tek të tjerët.

**Kompetenca qytetare**

**Nxënësi/ja:**
- promovon me të tjerët për çështje të ndryshme kulturore;
- respekton punën e të tjerëve;
- bashkëpunon me të tjerët pavarësisht kulturës, aftësive dhe nevojave brenda dhe jashtë shkollës për një qëllim të përbashkët.

**Kompetenca digjitale**

**Nxënësi/ja:**
- shkëmben informacion si dhe bashkëpunon në rrjetet informuese në internet;
- përdor, njeh mjete të ndryshme në funksion të informacionit muzikor si: magnetofon, audio, video CD, DVD etj.

Çdo mësues/e duhet të dijë pse shërbejnë shtatë (**7) kompetencat kyçe**, dhe si t'i zhvillojë dhe ndërtojë ato në kontekstin e lëndës së vet me nxënësit/et, sipas formateve të përcaktuara. Këto kompetenca ndërtohet dhe arrihen përgjatë një shkalle të caktuar, në këtë rast, **kompetencat kyçe** të shkallës së katërt, lidhen me klasën e tetë dhe të nëntë.

## 2.2 Kuptimi dhe zbatimi i kompetencave lëndore dhe tematikave, që zhvillohen në lëndën e muzikës.

**Qasja e bazuar në kompetenca** është i gjithë procesi i të nxënit që zhvillohet në fushën e arteve në përgjithësi, në të gjitha shkallët dhe ndërtohet përmes kompetencave të kësaj fushe apo lëndëve

1. ***krijimit,***
2. ***performimit/realizimit dhe***
3. ***vlerësimit***.

Ato zhvillohen përmes **rezultateve të të nxënit** brenda secilës fushë të arteve. Kompetencat lëndore të muzikës, lidhen dukshëm dhe në mënyrë logjike e metodike me *kompetencat kyçe***.** Këto kompetenca janë të lidhura ngushtë me *tematikat* e lëndës së muzikës dhe zhvillohen nëpërmjet tyre.

Përvetësimi i njohurive muzikore nënkupton ***zotërimin e kompetencave muzikore***, që do të thotë ***zotërimi i një kompetence***. Në këto kushte, **zotërimi i kompetencave muzikore** do të thotë aftësia për të kuptuar, gjykuar përdorur muzikën në një shumëllojshmëri situatash dhe kontekstesh, jo vetëm brenda kontekstit të programit mësimor dhe kërkesave të tij, por edhe në situata në të cilën muzika luan ose mund të luajë një rol të rëndësishëm.

Programi i muzikës është strukturuar në **tri (3) tematika përmbajtësore** dhe **tri (3) kompetenca lëndore.**

**Tematikat që përshkojnë lëndën e muzikës, synojnë të përmbushin dhe ndërtojnë 3 kompetencat e lëndës muzikore.**

**Tematikat** ***përmbajtësore,*** janë ato tematika që zhvillohen përgjatë programit, duke krijuar kushte që nxënësi/ja të ndërtojë dhe të zbatojë *njohuritë, shkathtësitë, qëndrimet* dhe *vlerat*, në funksion të *kompetencave të lëndës* dhe *kompetencave kyçe*. Për secilën tematikë janë paraqitur njohuritë për klasën e tetë.

| TEMATIKAT E MUZIKËS[1] | KOMPETENCAT E MUZIKËS |
|---|---|
| ***Tematika 1:*** Gjuha dhe komunikimi muzikor. | **Kompetenca 1:** Krijimi muzikor. |
| ***Tematika 2:*** Teknika dhe procese muzikore. | **Kompetenca 2:** Performimi/ interpretimi muzikor. |
| ***Tematika 3:*** Historia, muzika dhe shoqëria. | **Kompetenca 3:** Vlerësimi i veprave muzikore. |

***Kompetenca 1: Krijimi muzikor:*** a) synon në zhvillimin dhe përdorimin e ideve të ndryshme për të organizuar krijimin muzikor, b) përdorimin e elementeve muzikore gjatë krijimit, c) zhvillimin e ideve të reja gjatë krijimit dhe organizimin e krijimit sipas strukturës muzikore, duke ndarë përvojat e veta krijuese me të tjerët.

***Kompetenca 2: Performimi/interpretimi muzikor***, synon në: a) kuptimin dhe zbatimin e teknikave të këndimit, b) kuptimin dhe zbatimin e teknikave të interpretimit, improvizimit deri në perfeksionimin e saj, c) respektimin e rregullave dhe ndarjen e përvojave të veta performuese me të tjerët.

***Kompetenca 3: Vlerësimi muzikor,*** synon në: a) kuptimin dhe analizimin e veprave muzikore,

që nga format e vogla e deri tek ato të mëdhatë, duke bërë një gjykim kritik dhe estetik që i përgjigjet kësaj grupmoshe.

**Tabela[1] e kompetencave lëndore të muzikës dhe përshkrimi i tyre.**
Në krah të kompetencës lëndore është bërë përshkrimi i asaj çka duhet të realizojë nxënësi/ja për ndërtimin e secilës kompetencë muzikore.

| Kompetencat muzikore | Përshkrimi i kompetencave lëndore |
|---|---|
| **Krijimi muzikor** | Nxënësi/ja:<br>- përdor ide të ndryshme për të organizuar krijimin muzikor;<br>- përdor elementet muzikore gjatë krijimit;<br>- zhvillon ide të reja gjatë krijimit muzikor;<br>- organizon krijimin e vet muzikor, sipas rregullave të strukturës së periudhës muzikore;<br>- ndan përvojat e veta krijuese me të tjerët. |
| **Performimi/ interpretimi muzikor** | Nxënësi/ja:<br>- zhvillon teknikat e këndimit, të luajtjes, së dëgjimit, analizimit, improvizimit në nivele të ndryshme;<br>- perfeksionon këndimin duke zbatuar teknikat e performimit/interpretimit muzikor;<br>- respekton rregullat e luajtjes në instrumente;<br>- ndan përvojat e veta performuese me të tjerët. |
| **Vlerësimi i veprave muzikore** | Nxënësi/ja:<br>- analizon veprat muzikore që nga format e vogla e deri tek ato të mëdhatë;<br>- vlerëson veprat muzikore, duke bërë një gjykim kritik dhe estetik. |






[1] Kjo tabelë është marrë nga program mësimor i muzikës, klasa e tetë, shkalla e katërt.

Sipas diagramit të mëposhtëm, *kompetencat kyçe* dhe *kompetencat lëndore* zhvillohen përmes *tematikave* të lëndës së muzikës, ku në qendër të mësimdhënies është nxënësi/ja dhe lënda e muzikës.

**Diagrami[2]: Kompetencat *kyçe dhe lëndore,* që formohen përmes *tematikave përmbajtësore* të muzikës.**




## 2.3 Lidhja e muzikës me fushat e tjera kurrikulare

Muzika është e lidhur me lëndët brenda fushës së saj (arti pamor, kërcimi dhe teatri), por edhe me fusha të tjera të nxëni në kurrikul. Melodia, ritmi, harmonia, dinamika, tempi, forma, struktura etj., janë koncepte që lidhen shumë mirë me disiplinat e tjera artistike brenda fushës së arteve, por edhe me fusha të tjera të nxëni brenda kurrikulës si: matematikën, gjuhën dhe komunikimin, shkencat shoqërore dhe mjedisi etj. Kështu mësuesit/et duhet t'u japin mundësinë nxënësve/eve të konsolidojnë dhe formojnë përvojat që ata/ato kanë krijuar përmes njohurive, duke i pasuruar dhe duke u dhënë drejtim të mëtejshëm këtyre përvojave.

2 Kjo diagramë është marrë nga programi mësimor i muzikës, klasa e tetë, shkalla e katërt.

# III LLOJET E PLANIFIKIMIT

Planifikimi i përmbajtjes së programit përgjatë tri periudhave është një proces mjaft i rëndësishëm në punën e mësuesit/es, që zgjat gjithë vitin shkollor. Përgatitja e dokumenteve që shoqërojnë punën e tij/saj përgjatë vitit janë të shumta dhe kanë të bëjnë me *planifikimin e mësimdhënies* dhe *dokumentet* përkatëse. Planifikimi i këtyre dokumenteve nga mësuesi/ja kërkon: a) liri në krijueshmëri, b) fleksibilitet dhe përgjegjshmëri në planifikim. Këto dokumente janë:

*1) Planifikimi vjetor i lëndës*
*2) Planifikimi sipas 3 periudhave*
*3) Planifikimi ditor*

Këto tri planifikime, bëhen bazuar në ndarjen e kohës mësimore që sugjeron programi mësimor i muzikës dhënë në tabelën e mëposhtme:

**Tabela 2: Orë të sugjeruara për çdo tematikë**

| Tematikat | Gjuha dhe komunikimi muzikor | Teknikat dhe proceset | Historia, muzika dhe shoqëria | Gjithsej orë |
|---|---|---|---|---|
| **Klasa e tetë** | 11 orë | 14 orë | 10 orë | **35 orë** |

**Kujdes!**
Përgjatë planifikimit të temave mësimore numri i orëve të përcaktuara për secilën tematikë, mund të mos jenë sa në tabelë. Por, kjo është bërë në mënyrë të qëllimshme që ju të keni mundësi të zhvilloni: ***çështje të tjera lidhur me muzikën, orë përforcimesh apo orë prezantimesh, të testit, të projekteve apo detyrave përmbledhëse.***
Kështu mund të përdorni orët e tematikës "Teknika dhe procese" për të realizuar orët e ***testit*** apo ***projekteve kurrikulare***.
Në renditjen e temave mësimore, përgjatë librit të nxënësit, nuk është vendosur se ku do t'i llogarisni këto tema, ndaj shumë mirë mund t'i fusni pikërisht në këto tematika. E rëndësishme është që të jeni korrektë me kohën mësimore, që ju kërkon tabela e mësipërme e programit mësimor, klasa VIII.
Përdorimi i metodave efikase në procesin e të nxënit të muzikës është kusht për rritjen e cilësisë së arritjeve nga ana e nxënësve/eve, duke i dhënë secilit/secilës mundësinë të shfaqë dhe të zhvillojë potencialin muzikor/artistik, që zotëron brenda vetes. ***Organizimi*** dhe ***planifikimi*** i mirë i procesit të mësimit të muzikës, do të thotë që nxënësit/et të vendosen në situata konkrete krijuese, ku ata/ato përjetojnë dhe provojnë vetë, gjatë proceseve muzikore.
Nxënësit/et e një klase janë të ndryshëm, për sa i përket mënyrës sesi ata/ato nxënë: *individualisht, në grup, nën udhëheqjen e mësuesit/es, të pavarur, me anë të situatave konkrete* etj.

Ndaj një planifikim i mirë duhet të mbajë parasysh:

a) ndërtimin e kompetencave kryesore të të nxënit në muzikë;
b) lidhjen konceptuale, ruajtjen e koherencës vertikale të njohurive e aftësive në kuptimin që ndërtimi i çdo njohurie dhe edukimi i çdo aftësie, mbështeten në ato të mëparshmet;
c) formimin dhe forcimin e aftësive dhe shprehive muzikore;
d) zbatimin e veprimtarive krijuese/interpretuese/vlerësuese muzikore, brenda dhe jashtë klasës, të cilat lidhin konceptet muzikore me situata të jetës reale;
e) përdorimin e mjeteve muzikore konkrete didaktike dhe ato të teknologjisë CD, DVD, kompjuter, magnetofon;
f) nevojën e individit për të nxënë gjatë gjithë jetës;
g) zhvilllimin e qëndrimit pozitiv ndaj lëndës së muzikës dhe vlerësimit të përdorimit të gjithanshëm të saj;
h) nxitjen e bashkëveprimit mësues/e-nxënës/e që në procesin mësimor mësuesi/ja dhe nxënësi/ja të jenë plotësues të njëri/a-tjetrit/ës.

Një mësimdhënie e planifikuar mirë, krijon kushtet e nevojshme për një nxënie të suksesshme dhe lehtëson, si punën e mësuesit/es, ashtu edhe atë të nxënësit/es. Planifikimi i mirë i përmbajtjes dhe ndërtimi i kompetencave muzikore të përcaktuara në këtë program, janë të ndërlidhura dhe zhvillohen nëpërmjet *situatave të të nxënit*.

*Situata e të nxënit* për secilin model të planifikimit ditor në këtë libër, është <u>sugjerues.</u> Niveli i nxënësve/eve, burimet materiale, përvoja e vetë mësuesit/es, mjetet në dispozicion për realizimin e orës mësimore, vendosja e rezultateve të të nxënit, për zhvillimin e kompetencave kyçe dhe lëndore **nuk** mund të jenë për të gjithë njësoj. Kështu që çdo mësues/e zgjedh të zhvillojë sipas modelve të sugjeruara, por mund të zhvillojë situata të reja në një realitet tipik për klasën e vet. Ato synojnë pjesëmarrjen aktive të nxënësve/eve përmes njohurive që ata/ato kanë, dhe përfshirjen e tyre në veprimtari, krijime ose simulime të njohurive, interpretimeve/performimeve, gjykimeve dhe qëndrimeve artistike. Për të siguruar këtë pjesëmarrje aktive të nxënësve/eve, mësuesi/ja duhet të krijojë një atmosferë që i bën ata/ato të ndihen të lirshëm/me dhe të zhdërvjellët/ta për të zhvilluar njohuritë e tyre në muzikë.

# IV KRIJIMI I PORTOFOLIT TË TË NXËNIT

## 4.1 Krijimi i portofolit

**Portofoli i të nxënit** është një qasje bashkëkohore, që bazohet në kriteret e cilësisë dhe dokumenton kontributin e nxënësve/eve në veprimtari mësimore të orientuara nga kompetenca. Portofoli është *pasqyrim i mësimdhënies së bazuar në dëshmi që.*

- na ndihmojnë *të eksplorojmë dhe të zhvillojmë qasjet për një mësim efektiv;*
- nëpërmjet portofolit *përthyhen dhe dokumentohen qasjet e mësimit të bazuara në kompetencën/performancën e nxënësit/es;*
- në thelbin e tij portofoli me dokumentacionin që e përbën, *argumenton përgjegjësitë e mësuesit/es, në lidhje me mësimdhënien dhe të nxënit.*

**Karakteristikat e portofolit të të nxënit janë se ai:**

- reflekton ***rezultatet e identifikuara të nxënësit/es*** bazuar në pritshmëritë e RN të kurrikulës;
- përqendrohet në ***përvojat e të nxënit të nxënësve/eve të bazuara në performancë***, si dhe në përvetësimin e kompetencave kyçe (njohurive, aftësive dhe qëndrimeve);
- përmban ***shembuj të punës që shtrihet gjatë gjithë vitit shkollor*** dhe jo në disa ditë të shkëputura të vitit;
- përmban ***produkte të punëve të nxënësve/eve që përfaqësojnë një shumëllojshmëri*** rezultatesh për t'u vlerësuar;
- përmban një ***shumëllojshmëri të modeleve të punës dhe vlerësimet*** e kësaj pune nga vetë nxënësit/et, shokët/qet, mësuesit/et, prindërit etj.

**Një portofol mund të përmbajë:**

- *detyra me shkrim;*
- *teste të përfunduara;*
- *punë krijuese;*
- *projekte individuale dhe në grup;*
- *kërkime në internet mbi jetët dhe veprimtaritë e kompozitorëve/eve shqiptarë/e dhe të huaj/a;*
- *koleksione të krijuara me muzikë të ndryshme CD apo DVD;*
- *albume me foto apo vepra të ndryshme muzikore;*
- *ese;*
- *prezantime nga kërkime të ndryshme;*

**Portofoli në lëndën e muzikës duhet të përmbaje:**

- *2-3 detyra shtëpie që konstistojnë në krijime muzikore.*
- *1 ese krijuar pë një vepër muzikore apo mbi përjetimin e fjalëve të tekstit të këngës.*
- *1 Cd me këngët apo veprat muzikore të preferuara ose 1 album me foto me kompozitorët apo këngëtarët e preferuar*
- *1 projekt individual apo në grup, lidhur me çshtje të ndryshme të muzikës.*

Pra, ***portofoli i të nxënit*** është koleksionimi i kontributeve të nxënësit/es dhe paraqet përpjekjet, progresin dhe arritjet e tij/saj në lëndën e muzikës.

## 4.2 Vlerësimi i portofolit

Portofoli i të nxënit është një koleksion i punimeve të nxënësit/es, për të dëshmuar zotërimin e kompetencave (të njohurive, shkathtësive dhe qëndrimeve), punimet individuale në një portofol janë shpesh të referuara si "objekte". Pra, mësuesi/ja duhet të përcaktojë jo vetëm *çfarë*, por edhe *si* duhet të jetë "objekti", që do të përmbajë portofoli. Rubrikat e portofolit përcaktohen edhe nga lloji i vlerësimit. Vlerësimi i nxënësit/es bazuar në portofol, mund të jetë i orientuar nga "procesi" ose "produkti". Në rastin kur vlerësimi i portofolit ***orientohet nga procesi,*** synohet gjykimi i përparimit të nxënësit/es p.sh. përgjatë një tremujori, viti akademik, shkalle kurrikule etj. Në raste të tilla, nëpërmjet portofolit dokumentohet ecuria e procesit të të nxënit, nëpërmjet studimit të evidencave në fillim, gjatë dhe në fund të periudhës së përcaktuar. Nëpërmjet kësaj mënyre, evidentohen si arritjet e nxënësit/es, ashtu edhe mangësitë apo vështirësitë individuale.
***Vlerësimi i portofolit është përfshirë në paketën dhe rregulloren e vlerësimit për arsimin e mesëm të ulët.*** Portofoli lehtëson vënien e notës, realizon vlerësim objektiv, si dhe plotëson procedurat tradicionale të vlerësimit. Nxitja e vetëvlerësimit si pjesë përbërëse e vlerësimit të portofolit, krijon sa një klimë konkurruese ndërmjet nxënësve/eve, po aq edhe përmirësimin e vetë nxënësit/es, në ato drejtime që ai/ajo i evidenton si problematike.



# V VLERËSIMI I NXËNËSIT/ES

Vlerësimi i nxënësve/eve është ndër komponentët më të rëndësishëm të kurrikulës me bazë kompetencat. Ky vlerësim, bazuar në rezultatet e të nxënit, përfshin gjykimin për arritjet e nxënësve/eve (njohuri, shkathtësi, qëndrime) përkundrejt niveleve të arritjeve.
Mësuesi/ja, në përputhje me parimet themelore të vlerësimit, siguron përdorimin e të gjitha llojeve të vlerësimit, të cilët përcaktohen si të domosdoshme, për të gjykuar në lidhje me arritjet e nxënësve/eve, në funksion të mbështetjes së të nxënit dhe mësimdhënies.

**Vlerësimi për të nxënë i nxënësit/es kryhet nëpërmjet:**
*1. vlerësimit të vazhduar;*
*2. vlerësimit me test/detyrë përmbledhës/e;*
*3. vlerësimit të portofolit lëndor të nxënësit/es.*

**1** **Vlerësimi i vazhduar** bazohet në vëzhgimet dhe gjykimet e mësuesit/es mbi:

*përgjigjet me gojë ose me shkrim, kuicet, punët në grup, diskutimet e mësuesit/es me nxënësit/et, vetëvlerësimin e nxënësit/es, vlerësimin e nxënësit/es nga nxënësi/ja, pjesëmarrjen në aktivitete dhe debatet në klasë, vlerësimin e detyrave të shtëpisë apo të klasës, përgjatë* ***një periudhe****.*

- Për vlerësimin e vazhduar të arritjes së rezultateve të të nxënit, mësuesi/ja **mban shënime në evidencë për çdo nxënës/e**. Shënimet në evidencë mund të mbahen me **notë, simbole** etj., të shoqëruara me **komente,** të cilat i referohen niveleve të arritjes së kompetencave lëndore.
- Për lehtësimin e punës së tij mësuesit/es i sugjerohet të shkruajë në fund të evidencës **një legjendë,** e cila shpjegon kuptimin e simboleve të vendosura.



- Komentet i referohen **niveleve të arritjes së kompetencave lëndore** bazuar në dokumentin përkatës të "Niveleve të arritjes" shkalla IV (klasa 8-9).
- Mësuesi/ja është i/e lirë të përshtasë **formatin e evidencës**, në varësi të specifikave të lëndës, ose të krijojë një formë tjetër të mbajtjes së shënimeve, duke ruajtur pjesën përmbajtësore të saj.
- **Evidenca** dorëzohet në drejtori në përfundim të periudhës dhe ruhet deri në përfundim të vitit shkollor.

**2** **Vlerësimi me test/detyrë përmbledhës/e**

Në përfundim të periudhës kryhet vlerësimi me test ose detyrë përmbledhëse, e cila ka për qëllim të matë nivelin e arritjeve të nxënësit/es, për një grup të caktuar rezultatesh të nxëni.



- Mësuesi/ja përzgjedh të zhvillojë test ose detyrë përmbledhëse, në varësi të veçorive të lëndës.
- Testi përmbledhës është test që përmban vetëm rezultatet e të nxënit (njohuritë dhe shkathtësitë) kryesore të periudhës përkatëse.
- Koha e realizimit të testit është 45 minuta, si të gjitha testet e tjera.

### 3 Vlerësimi me portofol lëndor



Portofoli është **koleksionim sistematik i detyrave dhe punimeve** të kryera nga nxënësi/ja përgjatë periudhës, për të dëshmuar zhvillimin e kompetencave (njohurive, shkathtësive, qëndrimeve). Mësuesi/ja udhëzon nxënësit/et për krijimin e portofolit dhe bashkëpunon me ta rreth përmbajtjes së tij. Në fillim të periudhës, mësuesi/ja në bashkëpunim me nxënësit/et, **përcaktojnë** detyrat dhe punimet që do të përfshijnë në portofol përgjatë periudhës, në varësi të specifikave të lëndës.

- Këto detyra zhvillohen gjatë periudhës dhe nuk janë pjesë e vlerësimit të vazhduar (në evidencë), por vetëm pjesë e portofolit lëndor.
- Pjesë e portofolit është edhe projekti kurrikular. Projekti kurrikular mund të jetë i shtrirë vetëm brenda një periudhe, por mund të jetë i shtrirë edhe përgjatë gjithë vitit.
- Sido që të jetë shtrirja e projektit ai ka vlerësimin e tij brenda vlerësimit të portofolit. Nëse projekti ka shtrirje përgjatë gjithë vitit, në çdo periudhë vlerësohet si pjesë e portofolit, ajo pjesë e projektit që është realizuar. Në rastin kur ka shtrirje brenda një periudhe vlerësohet i gjithë projekti.
- Për vlerësimin e portofolit, mësuesi/ja përcakton kritere të qarta dhe ua komunikon nxënësve/eve. Vlerësimi i detyrave të portofolit varet nga pesha që secili/a mësues/e i vendos secilës detyrë.
- Vlerësimi i portofolit mund të planifikohet në planifikimin e periudhave si orë e veçantë ose mund të realizohet përgjatë tre-katër orëve të fundit të periudhës. Në këtë rast mësuesi/ja përcakton një grafik të nxënësve/eve, të cilëve/cilave do t'u vlerësohet portofoli.

**Shembull evidence të vlerësimit të vazhduar**
**Periudha: Shtator–Dhjetor**
**Shënim:** Shembulli i mëposhtëm është vetëm një ilustrim i modelit të plotësimit të evidencës. Mësuesi/ja është i/e lirë në përcaktimin e numrit të vlerësimeve të një nxënësi/e përgjatë periudhës.

| *Nr.* | *Nxënësi/ja / Data* | *28.09* | *3.10* | *31.10* | *9.11* | *25.11* | *19.12* | *KOMENTE* |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| *1* | *Alban Rama* | +- | | | | | | *N3 Ritmi 5/8* |
| | | | ✓ | | | | | *N3 Kënga "Thuaja rini"* |
| | | | | *9* | | | | *N4 Muzika popullore* |
| | | | | | *10* | | | *N4 Ushtrime ritmike dhe melodike* |
| | | | | | | + | | *N4 Ritmi 7/8* |
| | | | | | | | *10* | *N4 Testi* |

• **Legjendë:** ++ (sh. mirë); + (mirë); +- dhe ü (mesatar); -+ dhe ? (nën mesatar); - dobët; - - (sh. dobët); N1 – Niveli 1; N2 – Niveli 2; N3 – Niveli 3; N4 – Niveli 4; TN – test i ndërmjetëm.

• **Vlerësimi periodik,** bëhet në përfundim të çdo periudhe dhe përmban tri nota:
- *vlerësimin e vazhdueshëm* – NVv, e cila vendoset në regjistër në kolonën përkatëse në faqet e vlerësimit;
- *vlerësimin me test ose detyrë përmbledhëse* – NTp, e cila vendoset në regjistër në kolonën përkatëse në faqet e vlerësimit;
- *vlerësimin e portofolit lëndor – NVp,* e cila vendoset në regjistër në kolonën përkatëse në faqet e vlerësimit.

• **Vlerësimi përfundimtar,** shënohet në regjistër duke plotësuar kollonat e "Vlerësimit Vjetor" dhe në kollonën e "Notës përfundimtare".
Vlerësimet vjetore përmbajnë:
- *notën vjetore të vlerësimit të vazhduar* që është rezultat i tri periudhave;
- *notën vjetore të vlerësimit me test ose detyrë përmbledhëse* që është rezultat i tri periudhave;
- *notën vjetore të vlerësimit të dosjes së nxënësit/es* që është rezultat i tri periudhave;

**Në rast kur ecuria e nxënësit/es është e dukshme, progresive ose regresive gjatë dy periudhave të fundit, vlerësimi i tij/saj vjetor në secilën nga rubrikat, mund të jetë progresiv ose regresiv**. Në rast kur ecuria e tij/saj nuk është e qëndrueshme përgjatë tri periudhave, atëherë vlerësimi llogaritet me mesatare.

**Nota përfundimtare** llogaritet me përqindje për secilën nga rubrikat.
• **Pesha në përqindje, e llojeve të vlerësimit është:**
- *vlerësimin e vazhdueshëm* – 40% ;
- *vlerësimin me test ose detyrë përmbledhëse* – 40% ;
- *vlerësimin e portofolit lëndor – 20%.*

• **Hapat për njehsimin e notës përfundimtare janë:**
- përcaktohet nota vjetore e vlerësimit të vazhduar (NVV), bazuar në tri notat e periudhave, duke gjykuar në mënyrë progresive;
- përcaktohet nota vjetore e testit/detyrës përmbledhëse (NTP) bazuar në tri notat e periudhave, duke gjykuar në mënyrë progresive;
- përcaktohet nota vjetore e portofolit të nxënësit/es (NVP) bazuar në tri notat e periudhave, duke gjykuar në mënyrë progresive;
- shumëzohet secila prej notave me përqindjen përkatëse;
- mblidhen këto prodhime dhe shuma rrumbullakoset me numër të plotë (p.sh. 8,8 9).

• **Formula: (NVV x 0.4) + (NTP x 0.4) + (NVP x 0.2) = Nota përfundimtare**

• **Përshkrimi i notës përfundimtare vjetore argumenton** nivelin e arritjeve të kompetencave të lëndës. Përshkrimi i referohet pikave më të forta që ka nxënësi/ja lidhur me përmbushjen e kompetencave të lëndës.

**Shembull 1 – Klasa VIII**

| Periudha I | | | Periudha II | | | Periudha III | | | Notat vjetore | | | Nota përfundimtare |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| NVV | $NT_P$ | NVP | NVV | $NT_P$ | NVP | NVV | $NT_P$ | NVP | NVV | $NT_P$ | NVP | 9 |
| 7 | 8 | 9 | 9 | 8 | 10 | 9 | 9 | 10 | 9 | 8 | 10 | |

$$(9 \times 0.4) + (8 \times 0.4) + (10 \times 0.2) = 8.8$$

**Nota përfundimtare 9**

| Nota përfundimtare | Përshkrimi i vlerësimit |
|---|---|
| **9** | *Iliri (nxënësi)* këndon dhe interpreton me korrektësi këngë të ndryshme për fëmijë dhe këngë popullore, në ritme të thjeshta dhe të përziera muzikore, duke respektuar rregullat e këndimit dhe interpretimit. Njeh dhe shpjegon, duke sjellë shembuj muzikorë, të muzikës popullore, duke i ritmizuar dhe duke i kënduar ose luajtur me një instrument muzikor, ato me saktësi. |

**Shembull 2: Klasa VI**

| Tremujori I | | | Tremujori II | | | Tremujori III | | | Notat vjetore | | | Nota përfundimtare |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| NVV | $NT_P$ | NVP | NVV | $NT_P$ | NVP | NVV | $NT_P$ | NVP | NVV | $NT_P$ | NVP | 7 |
| 7 | 6 | 8 | 7 | 7 | 9 | 8 | 6 | 8 | 7 | 6 | 8 | |

$$(7 \times 0.4) + (6 \times 0.4) + (8 \times 0.2) = 6.8$$

**Nota përfundimtare 7**

| Nota përfundimtare | Përshkrimi i vlerësimit |
|---|---|
| **7** | *Albani (nxënësi) lexon dhe këndon* ushtrime që janë ndërtuar në ritmet e thjeshta muzikore dhe me figurat e simbolet muzikore, *por paraqet vështirësi* në krijimin e ushtrimeve me këto lloj ritmesh. Ai i *lexon pjesërisht* simbolet muzikore si *sinkopa dhe kontratempo*, ndërton me ndihmë intervalet muzikore dhe identifikon me ndihmë format muzikore, duke përdorur një fjalor të thjeshtë muzikor. |

**Vlerësimi i nxënësit/es për zhvillimin e kompetencave kyçe**

- Vlerësimi i nxënësit/es për kompetencat kyçe bazohet në rezultatet e të nxënit të kompetencave kyçe për shkallën përkatëse.
- Vlerësimi i nxënësit/es për kompetencat kyçe, realizohet nga mësuesi/ja kujdestar/e në bashkëpunim me mësuesit/et e të gjitha lëndëve.

# VI MODELET E PLANIFIKIMEVE:
## 1) Planifikimi vjetor
## 2) Planifikimi sipas periudhave dhe
## 3) Planifikimi ditor

### V.I PLANIFIKIMI VJETOR

| TEMATIKAT | SHPËRNDARJA E PËRMBAJTJES LËNDORE SIPAS PERIUDHAVE | | |
|---|---|---|---|
| | **Shtator – Dhjetor 13 orë** | **Janar – Mars 12 orë** | **Prill – Qershor 10 orë** |
| **Gjuha dhe komunikimi muzikor (11 orë)** | Kujtojmë së bashku | | Shkalla muzikore Sol Maxhore |
| | Sinkopa dhe kontratempo | | |
| | Nota 1/8 me pikë vlere | | Shkalla muzikore Mi minore |
| | Ritmet e përziera, ritmi 5/8 | | Shkalla muzikore Fa Maxhore |
| | Ritmi 7/8 | | Shkalla muzikore Re minore |
| | Ritmi 9/8 | | Ushtrime këndimi në Sol+ dhe Fa+ |
| **Teknika dhe procese (14 orë) (11+3 orë test ose projekt)** | "Pëllumbi i bardhë" | Melodi dhe këngë popullore | Këndojmë në gjuhë të huaj |
| | "O sa bukur paske çil-e" | "Lunxhëri plot lezete" (valle e kënduar) | "Jam i lashtë se jam shqiptar" |
| | "Lule bore" | "Kënga e krushqve" | Kolona zanore nga filma të ndryshëm (dëgjim dhe këndim) |
| | "Trimëreshat tona" | "Thuaja rini" | |
| **Historia, muzika dhe shoqëria ( 10 orë)** | Muzika popullore shqiptare | Muzika polifonike | Muzika e filmit |
| | Vallja popullore shqiptare | Muzika e kultivuar shqiptare | |
| | | Instrumentet muzikore popullore | |
| | | Muzika instrumentale shqiptare | |
| | | Muzika vokale shqiptare | |
| | | Baleti shqiptar | |
| | | *Muzika profesioniste shqiptare pas viteve '45* | |

| | | | |
|---|---|---|---|
| **Test** | Verifikojmë njohuritë muzikore/Test | Verifikojmë njohuritë muzikore/ Test | Verifikojmë njohuritë muzikore/Test |
| **Detyrë përmbledhëse** | Projekt: *Trashëgimia jonë kulturore (TK) materiale dhe jomateriale* | | Projekt: *"Muzika dhe filmi"* |
| **Portofoli i të nxënit për çdo periudhë** | Projekt individual ose në grup (1)<br>Detyra shtëpie – krijime muzikore (2 - 3)<br>Ese (1)<br>Kërkime mbi çështje apo informacione të ndryshme (1)<br>Krijim Cd apo Dvd ose 1 album me foto. | Projekt individual ose në grup (1)<br>Detyra shtëpie – krijime muzikore (2- 3)<br>Ese (1)<br>Kërkime mbi çështje apo informacione të ndryshme (1)<br>Krijim CD dhe DVD | Projekt individual ose në grup (1)<br>Detyra shtëpie – krijime muzikore (2 - 3)<br>Ese (1)<br>Kërkime mbi çështje apo informacione të ndryshme (1)<br>Krijim CD dhe DVD |
| 35 orë | 13 orë | 12 orë | 10 orë |

# Planifikimi i periudhës së parë: Shtator - Dhjetor

| Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe |
|---|
| **Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit**<br>Nxënësi/ja:<br>- zhvillon personalitetin e vet dhe është aktiv/e në veprimtaritë artistike;<br>- gjykon drejt mesazhin artistik;<br>- shprehet nëpërmjet një komunikimi të qartë dhe të saktë me anë të gjuhëve, simboleve, shenjave dhe formave muzikore;<br>- shfrytëzon mjetet artistike dhe mundësitë e komunikimit dhe të të shprehurit në muzikë në mënyrë të pavarur, të vazhdueshme, kritike dhe krijuese.<br><br>**Kompetenca e të menduarit**<br>Nxënësi/ja:<br>- përpunon njohuritë muzikore në mënyrë të pavarur, krijuese dhe me përgjegjësi;<br>- zgjidh probleme të ndryshme muzikore/artistike;<br>- zhvillon aftësitë për të menduar në mënyrë kritike, krijuese dhe ndërvepruese;<br>- ndjek udhëzimet për të realizuar një krijim apo veprimtari muzikore artistike.<br><br>**Kompetenca e të mësuarit për të nxënë**<br>Nxënësi/ja:<br>- vendos mjetet në funksion të realizimit të krijimit muzikor;<br>- përdor burime të ndryshme informacioni për të realizuar një krijim muzikor;<br>- krijon në mënyrë të pavarur detyrën e dhënë.<br><br>**Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin**<br>Nxënësi/ja:<br>- merr përsipër ose drejton aktivitetet muzikore brenda dhe jashtë klasës, duke kontribuar në mënyrë krijuese.<br><br>**Kompetenca personale**<br>Nxënësi/ja:<br>- krijon besimin te vetja gjatë veprimtarive muzikore;<br>- merr pjesë në mënyrë aktive në jetën artistike shkollore dhe komunitet;<br>- ndërgjegjëson veten dhe zhvillon vetëbesimin e krijimin e besimit tek të tjerët.<br><br>**Kompetenca qytetare**<br>Nxënësi/ja:<br>- promovon me të tjerët për çështje të ndryshme kulturore;<br>- respekton punën e të tjerëve;<br>- bashkëpunon me të tjerët pavarësisht kulturës, aftësive dhe nevojave brenda dhe jashtë shkollës për një qëllim të përbashkët.<br><br>**Kompetenca digjitale**<br>Nxënësi/ja:<br>- shkëmben informacion si dhe bashkëpunon në rrjetet informuese në internet;<br>- përdor, njeh mjetet e ndryshme në funksion të informacionit muzikor si: magnetofon, audio, video CD, DVD etj. |

| Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të lëndës | | |
|---|---|---|
| ***Krijimi muzikor*** | ***Performimi/ interpretimi muzikor*** | ***Vlerësimi muzikor*** |
| **Nxënësi/ja:**<br>- krijon në ritmet 5/8,7/8,9/8; përdor simbole të ndryshme muzikore të mësuara duke krijuar diversitet në krijimin e vet;<br>- demonstron kuptimin e tyre gjatë shpjegimit të krijimit të vet. | **Nxënësi/ja:**<br>- shpjegon funksionin dhe rolin e simboleve muzikore në pjesët që interpreton;<br>- interpreton në ritme të ndryshme (*të përziera),* duke demonstruar se i ka kuptuar ato qartë;<br>- këndon duke respektuar kohët dhe simbolikat e mësuara;<br>- këndon ushtrime në ritmet e mësuara. | **Nxënësi/ja:**<br>- kupton dhe shpjegon ndryshimin e ritmeve tek ushtrimet, këngët apo shembujt muzikore;<br>- bën lidhje midis ritmeve dhe shembujve muzikore;<br>- shpjegon lindjen dhe funkisonin e muzikës popullore;<br>- identifikon dhe gjykon mbi muzikën popullore insturmentale apo vokale nga krahina të ndryshme, duke dhënë mendimin e vet. |

| Nr. | Tematika | Tema mësimore | Situatae parashikuar e të nxënit | Burimet |
|---|---|---|---|---|
| | Gjuhadhe komunikimi (GJ&K) | Kujtojmë së bashku | **Situata e të nxënit: Provojmë njohuritë tona**<br>Improvizohet një konkurs ose kuic me pyetje të ndryshme rreth njohurive më të rëndësishme të muzikës nga klasa VII. | • Teksti i nxënësit;<br>• materiale interaktive të përshtatura nga mësuesi/ja;<br>• postera me tekstin e këngës dhe flamurin kombëtar;<br>• shembuj në CD. |
| 2 | Gjuha dhe komunikimi (GJ&K) | Sinkopa dhe kontratempo | **Situata e të nxënit: Partitura muzikore dhe simbolet**<br>Libri i muzikës ka plot pjesë/partitura muzikore, ku vetë nxënësit/et hulumtojnë dhe veçojnë simbole të ndryshme muzikore që njohin apo nuk njohin, duke diskutuar se çfarë funksioni kryejnë ato në muzikë. | • Teksti i nxënësit;<br>• materiale të ndryshme të parapërgatitura nga mësuesi/ja;<br>• fletorja e nxënësit;<br>• shembuj në CD. |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| 3 | Gjuha dhe komunikimi GJ&K | Nota 1/8 me pikë vlere | **Situata e të nxënit: Matematika dhe thyesat** Vetë nxënësit/et shkruajnë një ekuacion matematikor ku përdorin thyesa të ndryshme. Thyesat kanë një funksion në matematikë por edhe në muzikë. Si mund t'i kuptojmë ato në një partiturë? | • Teksti i nxënësit;<br>• materiale të ndryshme të parapërgatitura nga mësuesi/ja;<br>• fletorja e nxënësit;<br>• shembuj në CD. |
| 4 | Teknika dhe procese (T&P) | "Pëllumbi i bardhë" | **Situata e të nxënit: Paqja** "Çfarë mund të bësh që të promovosh paqe për të gjithë botën? Shko në shtëpi dhe duaje familjen tënde." - Nënë Tereza Duke u nisur nga kjo thënie diskutohet rreth paqes dhe simbolikës së saj. | • Teksti i nxënësit;<br>• materiale të përgatitura nga mësuesi/ja;<br>• materiale nga burime të ndryshme rreth temës;<br>• kënga në CD. |
| 5 | Gjuha dhe komunikimi (GJ&K) | Ritmet e përziera, ritmi 5/8 | **Situata e të nxënit: Dëgjojmë dhe imitojmë ritmet** Vendoset CD-ja për të dëgjuar fragmente të ndryshme muzikore dhe nxënësit/et improvizojnë ritmin që dëgjojnë. Mësuesi/ja ritmizon ritme dyshe dhe treshe, duke i nxitur fëmijët ta ndjekin në imitimin e tyre dhe kuptimin e karakteristikës si ritëm i përzier. | • Teksti i nxënësit;<br>• materiale të ndryshme të parapërgatitura nga mësuesi/ja;<br>• fletorja e nxënësit;<br>• shembuj në CD. |
| 6 | Teknika dhe procese (T&P) | "O sa bukur paske çil-e" | **Situata e të nxënit: Mjedisi ku unë jetoj** Nxënësit/et flasin rreth qytetit/krahinës/fshatit të tyre por jo vetëm, duke listuar të mirat e bimësisë në mjedisin e tyre ku jetojnë. | • Teksti i nxënësit;<br>• materiale të përgatitura nga mësuesi/ja;<br>• materiale nga burime të ndryshme rreth temës;<br>• kënga në CD. |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| 7 | Gjuha dhe komunikimi (GJ&K) | Ritmi 7/8 | **Situata e të nxënit: Dëgjojmë dhe imitojmë ritmet**<br>Vendoset CD-ja për të dëgjuar fragmente të ndryshme muzikore dhe nxënësit improvizojnë ritmin që dëgjojnë. Mësuesi/ja rikujton ritmin 5/8 duke ritmizuar atë duke i nxitur fëmijët ta ndjekin në imitimin e tyre dhe kuptimin e karakteristikës si ritëm i përzier. | • Teksti i nxënësit;<br>• materiale të ndryshme të parapërgatitura nga mësuesi/ja;<br>• fletorja e nxënësit;<br>• shembuj në CD. |
| 8 | Teknika dhe procese (T&P) | "Lule bore" | **Situata e të nxënit: Mjedisi me lule**<br>U kërkohet për një moment nxënësve/eve të imagjinojnë një kopësht me lule, dhe të thonë emrat e luleve të preferuara. Pse lulet janë shpesh subjekt në tekste këngësh? | • Teksti i nxënësit/es<br>• materiale të përgatitura nga mësuesi/ja,<br>• material nga burime të ndryshme rreth temës,<br>• Kënga në Cd. |
| 9 | Gjuha dhe komunikimi (GJ&K) | Ritmi 9/8 | **Situata e të nxënit: Dëgjojmë dhe imitojmë ritmet**<br>Vendoset CD-ja për të dëgjuar fragmente të ndryshme muzikore dhe nxënësit/et improvizojnë ritmin që dëgjojnë. Mësuesi/ja rikujton dy ritmet e tjera të mësuara dhe ritmizon ritmin 9/8, duke i nxitur fëmijët ta ndjekin në imitimin e tyre dhe kuptimin e karakteristikës si ritëm i përzier. | • Teksti i nxënësit;<br>• materiale të ndryshme të parapërgatitura nga mësuesi/ja;<br>• fletorja e nxënësit;<br>• Shembuj në CD. |
| 10 | Teknika dhe procese (T&P) | "Trimëreshat tona" | **Situata e të nxënit: Femra** dhe kontributi i saj<br>Cili është kontributi që kanë dhënë nënat shqiptare gjatë Luftës së Dytë Botërore? Po në shoqërinë e sotme a është e respektuar femra shqiptare? | • teksti i nxënësit;<br>• materiale të përgatitura nga mësuesi/ja;<br>• materiale nga burime të ndryshme rreth temës;<br>• Kënga në CD. |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| 11 | Historia, muzika dhe shoqëria (H,M&SH) | Muzika popullore shqiptare | **Situata e të nxënit: Kënga popullore e preferuar** Vendosen disa fragmente nga këngë popullore të krahinave të ndryshme dhe nxënësit/et listojnë karakteristikat e secilës këngë që dëgjojnë. | • teksti i nxënësit;<br>• materiale të përgatitura nga mësuesi/ja, me<br>• fragmente muzikore popullore të ndryshme;<br>• Shembuj në CD/ DVD. |
| 12 | Historia, muzika dhe shoqëria (H,M&SH) | Vallja popullore shqiptare | **Situata e të nxënit: Vallja popullore e preferuar** Vendosen disa fragmente nga valle popullore të krahinave të ndryshme dhe nxënësit/et listojnë karakteristikat e secilës valle që dëgjojnë ose mund t'i shikojnë në DVD. | • teksti i nxënësit;<br>• materiale të përgatitura nga mësuesi/ja, me<br>• fragmente nga valle popullore të ndryshme;<br>• Shembuj në CD/ DVD. |
| 13 | Teknika dhe procese (T&P) | Verifikojmë njohuritë muzikore | **Situata e të nxënit: Test** | • teksti i nxënësit;<br>• test i përgatitur nga mësuesi/ja. |
| | **Projekt[2]:** Trashëgimia jonë kulturore (TK) materiale dhe jomateriale | | | • teksti i nxënësit;<br>• materiale të përgatitura nga nxënësit/et;<br>• prezantime në ppt;<br>• koleksione në DVD apo albume. |
| | **Metodologjia**<br>Metoda interaktive, bashkëvepruese, gjithëpërfshirëse.<br>- Punë në grup dhe punë individuale.<br>- Hetimi dhe zbulimi.<br>- Zbatime praktike brenda dhe jashtë klase.<br>- Metoda integruese.<br>- Bashkëbisedim.<br>- Teknika që zhvillojnë mendimin kritik dhe krijues.<br>- Prezantime në forma të ndryshme, përfshirë TIK.<br>- Projekte kurrikulare. | | | |
| | **Vlerësimi:**<br>- vlerësimi përshkrues;<br>- vlerësimi i detyrave përmbledhëse ose test;<br>- vlerësimi i portofolit. | | | |

**Shënim: Modele udhëzuese për zhvillimin e mësimit, mësuesi mund të gjejë edhe në "Fletoren e punës" së nxënësit.**

# Planifikimi ditor për tremujorin ë parë: Shtator – Dhjetor

| Fusha: Arte | Lënda: Muzikë | Shkalla: IV | Klasa VIII |
|---|---|---|---|

**Tematika:** Gjuha dhe komunikimi (GJ&K)
**Tema mësimore:** Kujtojmë së bashku

• ***Situata e të nxënit:***
***Provojmë njohuritë tona***
Improvizohet një ***konkurs ose kuic*** me pyetje të ndryshme rreth njohurive më të rëndësishme të muzikës nga klasa VII.

**Rezultatet e të nxënit të kompetencave të lëndës sipas temës mësimore:**

Nxënësi/ja:
- Rikujton saktë dhe komunikon qartë njohuritë muzikore, që zotëron;
- plotëson saktë njohuritë e marra në ushtrimet e përgatitura;
- punon vetëm, ose në grup, fishat e përgatitura.

**Fjalë kyçe:**
- njohuritë bazë nga klasa VII (shkalla muzikore, intervalet, termat dinamike, koha 3/8, 6/8, formacionet muzikore etj.);
- rregullat e këndimit;
- këngë himn.

**Burimet:**
- teksti i nxënësit;
- fletorja e punës;
- materiale të parapërgatitura nga mësuesi/ja.

**Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve**

● ***Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve***

Mësimi fillon me një veprimtari interaktive, ku mësuesi/ja mund të përgatisë disa fisha të gatshme për rikujtimin e njohurive të marra nga klasa VII. Kështu improvizohet një ***konkurs ose kuic*** me pyetje të ndryshme, rreth njohurive më të rëndësishme të muzikës nga klasa VII, ku të përfshihen nga të tria tematikat p.sh.: duke bërë pyetje rreth ritmeve të thjeshta, ose duke vendosur apo shfaqur me projektor kuice të ndryshme, ku nxënësit/et fillojnë të përgjigjen rreth pyetjeve që lexojnë. Ata/ato rikujtojnë dhe Himnin Kombëtar, duke nxitur në këtë mënyrë tek ta/to dëshirën e bashkëbisedimit për identitetin e tyre dhe simbolet që përfaqëson një komb.

● ***Ndërtimi i njohurive të reja***

Mësuesi/ja krijon disa fisha pune të ndryshme për të nxitur nxënësit/et në:
- rikujtimin e njohurive të marra në klasën VII, pra të rikujtojnë këngët më të bukura, si dhe i nxit të diskutojnë rreth muzikës dhe se çfarë do t'u pëlqente më shumë të mësonin këtë vit,
- plotësimin me shkrim ose me gojë të ushtrimeve në tekstin dhe fletoren e tyre, informacionet e kërkuara,
- këndimin e himnit në ritëm dhe intonacion, vetëm ose në grup.

● ***Vlerësimi***

Vlerësimi i nxënësit/es do të bëhet për *demonstrimin e rezultateve të arritura në:*
- plotësimin e ushtrimeve që ata/ato bëjnë lidhur me njohuritë muzikore nga klasa VII;
- plotësimin e kuiceve dhe pyetjeve rreth njohurive muzikore;
- këndimin korrekt të këngës në ritëm dhe intonacion, duke respektuar rregullat e këndimit.

**Portofoli i nxënësit/es:**
Përmban punime, të cilat realizohen brenda orës, ose në vazhdimësi të periudhës.

| Fusha: Arte | Lënda: Muzikë | Shkalla: IV | Klasa VIII |
|---|---|---|---|

**Tematika:** Gjuha dhe komunikimi muzikor

**Tema mësimore:** Sinkopa dhe kontratempo

• ***Situata e të nxënit: Partitura muzikore dhe simbolet***

Libri i muzikës ka plot pjesë/partitura muzikore, ku vetë nxënësit/et hulumtojnë dhe veçojnë simbole të ndryshme muzikore, që i njohin ose jo, duke diskutuar se çfarë funksioni kryejnë ato në muzikë.

**Rezultatet e të nxënit të kompetencave të lëndës sipas temës mësimore:**

Nxënësi/ja:
- demonstron kuptimin e figurave muzikore, *sinkopa* dhe *kontratempo*;
- lexon ushtrime ritmike me *sinkopën* dhe *kontratempon;*
- identifikon dhe ritmizon figurat muzikore, sinkopën dhe kontratempon, gjatë leximit të një ushtrimi muzikor;
- komunikon qartë njohuritë muzikore, mbi sinkopën dhe kontratempon dhe përdorimit të tyre në muzikë;
- punon vetëm ose në grup.

**Fjalë kyçe:**
- sinkopë;
- kontratempo.

**Burimet:**
- teksti i nxënësit;
- materiale të përgatitura nga mësuesi/ja;
- fletorja e nxënësit.

**Lidhja me fushat e tjera:**
- gjuha shqipe: përdorimi i drejtë i *theksit*, *apostrofit,* etj., gjatë lexmit të një vepre letrare.

**Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve**

● ***Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve***

Mësimi fillon me një veprimtari konkrete, ku mësuesi/ja vendos shembuj/partitura muzikore, e ku vetë nxënësit/et hulumtojnë dhe veçojnë në të (shembuj të paraqitur me projektor, apo në vetë librin e nxënësit) disa shenja të veçanta, të cilat janë *sinkopa* dhe *kontratempo*. Nxiten të diskutojnë se çfarë funksioni mund të kenë ato në muzikë.

Nxënësve/eve u kërkohet të flasin për *simbole* , që ata/ato përdorin në lëndët e tjera si gjuhë shqipe, matematikë, fizikë, kimi etj., për të kuptuar edhe më mirë kuptimin e figurave muzikore në muzikë. Diskutimet ndihmojnë që ata/ato të kuptojnë vetë se sa të rëndësishme janë simbolet në jetën tonë të përditshme.

● ***Ndërtimi i njohurive të reja***

Ora mësimore vazhdon më tej, kur mësuesi/ja fillon:
- me shpjegimin hap pas hapi të *dy figurave muzikore, të sinkopës dhe kontratempos,* shumë të përdorura në muzikë, duke vazhduar më tej me:
- paraqitjen e shembujve të tjerë të përgatitura nga vetë ai/ajo, në librin ose në fletoren e nxënësit,
- leximin me zë të ushtrimeve, që kanë dy figurat muzikore, *sinkopa* dhe *kontratempo*.
- ushtrimin përmes shembujve të ndryshëm muzikorë deri në fund të orës,
- diskutimin rreth figurave muzikore nga vetë nxënësit/et.

● ***Vlerësimi***
Vlerësimi i nxënësit/es do të bëhet për *demonstrimin e rezultateve të arritura në:*
- kuptimin e figurave muzikore *sinkopa* dhe *kontratempo;*
- identifikimin dhe ritmizimin e figurave muzikore, *sinkopë dhe kontratempo,* gjatë leximit të një ushtrimi muzikor;
- komunikimin qartë të njohurive muzikore, mbi *sinkopën dhe kontratempon* dhe përdorimit të tyre në muzikë;
- bashkëpunimin gjatë plotësimit të detyrës, vetëm ose në grup.

● **Detyra: Krijo** në fletoren tënde një ushtrim muzikor në ritmin 2/4 prej 8 masash muzikore, duke përdorur figurat *e sinkopës* dhe *të kontratempos*.

**Portofoli i nxënësit/es:**
Punimet e zhvilluara nga nxënësit/et, ruhen në dosjet e tyre personale.

***Shënime specifike:***



| Fusha: Arte | Lënda: Muzikë | Shkalla: IV | Klasa VIII |
|---|---|---|---|

**Tematika:** Gjuha dhe komunikimi muzikor

**Tema mësimore:** Nota 1/8 me pikë vlere

• ***Situata e të nxënit: Matematika dhe thyesat***

Vetë nxënësit/et shkruajnë një ekuacion matematikor ku përdorin thyesa të ndryshme. Thyesat kanë një funksion në matematikë por edhe në muzikë. Si mund t'i kuptojmë ato në një partiturë?

**Rezultatet e të nxënit të kompetencave të lëndës sipas temës mësimore:**

Nxënësi/ja:
- demonstron kuptimin e figurave muzikore *nota 1/8 me pikë vlere*;
- lexon ushtrime ritmike me *notën 1/8 me pikë vlere;*
- këndon vijën melodike ku përdoret *notë 1/8 me pikë vlere;*
- komunikon qartë njohuritë muzikore, mbi *notën 1/8 me pikë vlere* dhe përdorimit të tyre në muzikë.

**Fjalë kyçe:**
- nota 1/8;
- pika e vlerës.

**Burimet:**
- teksti i nxënësit;
- materiale të përgatitura nga mësuesi/ja;
- fletorja e nxënësit.

**Lidhja me fushat e tjera:**
- matematika: përdorimi i thyesave në matematikë dhe kuptimi i tyre edhe në muzikë.

**Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve**

● ***Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve***

Mësimi fillon me një veprimtari konkrete, ku mësuesi/ja vendos shembuj/partitura muzikore, e ku vetë nxënësve/eve u kërkohet të hulumtojnë dhe veçojnë në të (shembuj të paraqitur me projektor, apo në vetë librin e nxënësit) *notën 1/8 me pikë vlere*.

Nxiten të diskutojnë dhe të rikujtonë *piramidën e vlerave të notave* në muzikë. Si ndaheshin ato? Po *pika e vlerës* çfarë funksioni ka në muzikë?

Nxënësve/eve u kërkohet të flasin për *simbolin e thyesës në matematikë* për të kuptuar më mirë kuptimin e figurave muzikore edhe në muzikë.

Diskutimet i ndihmojnë të kuptojnë më mirë notën 1/8 me pikë vlere.

● ***Ndërtimi i njohurive të reja***

Ora mësimore vazhdon më tej, ku mësuesi/ja fillon me shpjegimin hap pas hapi të *notës 1/8 me pikë vlere,* shumë e përdorur në muzikë, duke vazhduar më tej me:
- paraqitjen e shembujve të tjerë të parapërgatitur nga vetë ai/ajo, ose që gjenden në librin apo në fletoren e nxënësit,
- leximin e ushtrimeve që kanë *notën 1/8 me pikë vlere* me zë,
- ushtrimin përmes shembujve të ndryshëm muzikorë deri në fund të orës,
- diskutimin rreth *notës 1/8 me pikë vlere* nga vetë nxënësit/et.

● ***Vlerësimi***

Vlerësimi i nxënësit/es do të bëhet për *demonstrimin e rezultateve të arritura në:*

- kuptimin e *notës 1/8 me pikë vlere;*
- identifikimin dhe ritmizimin e ushtrimeve me përdorimin e *notës 1/8 me pikë vlere*;
- komunikimin qartë të njohurive muzikore, mbi *notën 1/8 me pikë vlere* dhe përdorimin e saj në muzikë;
- bashkëpunimin gjatë plotësimit të detyrës, vetëm ose në grup.

● **Detyra: Krijo** në fletoren tënde një ushtrim muzikor në ritmin 4/4 prej 8 masash muzikore, duke përdorur *notën tetëshe me pikë vlere*.

**Portofoli i nxënësit/es:**

Punimet e zhvilluara nga nxënësit/et, ruhen në dosjet e tyre personale.

***Shënime specifike:***



| Fusha: Arte | Lënda: Muzikë | Shkalla: IV | Klasa VIII |
|---|---|---|---|

**Tematika:** Teknika dhe procese

**Tema mësimore:** "Pëllumbi i bardhë"

***• Situata e të nxënit: Paqja***

Paraqitet ose shkruhet thënia e Nënë Terezës që vijon: *"Çfarë mund të bësh që të promovosh paqe për të gjithë botën? Shko në shtëpi dhe duaje familjen tënde."*
Dhe diskutohet rreth paqes dhe simbolikës së saj.

**Rezultatet e të nxënit të kompetencave të lëndës sipas temës mësimore:**

Nxënësi/ja:
- komunikon qartë, kuptimin që ka për konceptin e paqes;
- këndon duke respektuar teknikën e këndimit përmes rregullave të përcaktuara;
- interpreton këngët me ndjenjë dhe emocion;
- respekton interpretimin dhe performimin e shokëve/shoqeve;
- këndon vetëm dhe në grup.

**Fjalë kyçe:**
- melodia e këngës;
- teksti i këngës;
- rregullat e këndimit.

**Burimet:**
- teksti i nxënësit;
- materiale të përgatitura nga mësuesi/ja, nga burime të ndryshme rreth temës;
- kënga në CD.

**Lidhja me fushat e tjera:**
- shkencat shoqërore: njohuri për shoqërinë;
- gjuhët dhe komunikimi: letërsia.

**• Lidhja me temat ndërkurrikulare**
- paqja dhe të drejtat e njeriut.

**Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve**

***● Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve***

Mësuesi/ja shkruan në tabelë thënien e Nënë Terezës, që vijon: *"Çfarë mund të bësh që të promovosh paqe për të gjithë botën? Shko në shtëpi dhe duaje familjen tënde."*
Dhe diskutohet rreth, paqes dhe simbolikës së saj, rreth të drejtave të njeriut dhe respektimi i tyre.

***● Ndërtimi i njohurive të reja***
- Vendoset në CD kënga "Pëllumbi i bardhë".
- Mësuesi/ja nxit nxënësit/et të diskutojnë nëse kënga do të ishte më e bukur dhe do të krijonte emocion vetëm përmes muzikës apo të dyjave së bashku?
- **Rivendoset** përsëri kënga "Pëllumbi i bardhë", dhe **vazhdohet** puna me mësimin e saj, sipas hapave të mëposhtëm:
- këndimi varg pas vargu,
- përsëritja e vargjeve herë pas here,
- këndimi i strofës,
- këndimi i strofës dhe refrenit,
- përsëritja e këngës nga fillimi në fund,

| |
|---|
| - interpretimi i këngës me ndjenjë dhe emocion,<br>- këndimi i këngës vetëm dhe në grup.<br><br>**Gjatë mësimit të këngës, tregohet** kujdes të respektohet *ritmi, intonacioni, interpretimi i* këngës.<br><br>Kënga këndohet disa herë në intonacion dhe në ritëm, duke respektuar rregullat e këndimit sidomos të këndimit në grup. |
| ● ***Vlerësimi***<br>Vlerësimi i nxënësit/es do të bëhet për *demonstrimin e rezultateve të arritura në*:<br>- diskutimin me njëri/a-tjetrin/ën rreth karakteristikave të qytetit dhe të krahinës së tyre;<br>- këndimin korrekt, duke e interpretuar këngën me ndjenjë dhe emocion, sipas rregullave të këndimit në ritëm dhe intonacion;<br>- interpretimin e këngës me ndjenjë dhe emocion, vetëm ose në grup. |
| ● **Detyra:** ***Ese/krijim individual:*** Përshkruaj emocionet që të krijohen nga kjo këngë përmes një ese-je të shkurtër.<br> **Portofoli i nxënësit/es:**<br>Punimet e zhvilluara nga nxënësit/et, ruhen në dosjet e tyre personale. |

***Shënime specifike:***



| Fusha: Arte | Lënda: Muzikë | Shkalla: IV | Klasa VIII |
|---|---|---|---|

**Tematika:** Gjuha dhe komunikimi muzikor

**Tema mësimore:** Ritmet e përziera, ritmi 5/8

• ***Situata e të nxënit: Dëgjojmë dhe imitojmë ritmet***
Vendoset CD-ja për të dëgjuar fragmente të ndryshme muzikore dhe nxënësit/et improvizojnë ritmin që dëgjojnë. Mësuesi/ja ritmizon ritme dyshe dhe treshe, duke i nxitur fëmijët ta ndjekin në imitimin e tyre dhe në kuptimin e karakteristikës, si ritëm i përzier.

**Rezultatet e të nxënit të kompetencave të lëndës sipas temës mësimore:**

Nxënësi/ja:
- identifikon *ritmin 5/8* në ushtrime apo partitura të ndryshme muzikore;
- lexon ushtrime ritmike në *ritmin 5/8;*
- këndon fragmente muzikore/këngë *në ritmin 5/8;*
- krijon duke përdorur një ose të gjitha variantet e *ritmit 5/8;*
- komunikon qartë njohuritë muzikore, mbi *ritmin 5/8* dhe përdorimit të tyre, në muzikën tonë popullore.

**Fjalë kyçe:**
- nota 5/8;
- dy variantet muzikore të ritmit 5/8.

**Burimet:**
- teksti i nxënësit;
- materiale të ndryshme të parapërgatitura nga mësuesi/ja;
- fletorja nxënësit;
- shembuj në CD.

**Lidhja me fushat e tjera:**
- matematika: përdorimi i thyesave në matematikë dhe kuptimi i tyre edhe në muzikë.

**Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve**

● ***Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve***
Mësimi fillon me një veprimtari konkrete ku mësuesi/ja vendos CD-në për të dëgjuar fragmente të ndryshme muzikore dhe nxënësit/et improvizojnë ritmin që dëgjojnë. Mësuesi/ja ritmizon ritme dyshe dhe treshe, duke i nxitur fëmijët ta ndjekin në imitimin e tyre dhe kuptimin e karakteristikës si ritëm i përzier.
Diskutimet i ndihmojnë të kuptojnë më mirë ritmin 5/8.

● ***Ndërtimi i njohurive të reja***
Ora mësimore vazhdon më tej, kur mësuesi/ja fillon:
- shpjegimin hap pas hapi të *ritmin 5/8,* shumë i përdorur në muzikën tonë popullore, duke vazhduar më tej me
- paraqitjen e shembujve të tjerë të parapërgatitur nga vetë ai/ajo, ose që gjenden në librin apo në fletoren e nxënësit,
- leximin dhe këndimin e ushtrimeve *në ritmin 5/8* me zë,

- ushtrimin dhe krijimin përmes shembujve të ndryshëm muzikorë, në *ritmin 5/8* deri në fund të orës,
- diskutimin rreth *ritmit 5/8* nga vetë nxënësit/et.

● ***Vlerësimi***

Vlerësimi i nxënësit/es do të bëhet për *demonstrimin e rezultateve të arritura në:*
- kuptimin e *ritmit 5/8;*
- identifikimin dhe ritmizimin në ushtrime të ndryshme *të ritmit 5/8*;
- komunikimin qartë të njohurive muzikore, mbi *ritmin 5/8* dhe përdorimin e tij në muzikën tonë popullore;
- bashkëpunimin gjatë plotësimit të detyrës vetëm ose në grup.

● **Detyra: Krijo** në fletoren tënde një ushtrim muzikor në ritmin 5/8 prej 8 masash muzikore.

**Portofoli i nxënësit/es:**

Punimet e zhvilluara nga nxënësit/et, ruhen në dosjet e tyre personale.

***Shënime specifike:***

______________________________________________

______________________________________________

______________________________________________

______________________________________________

______________________________________________

______________________________________________

______________________________________________

______________________________________________



| Fusha: Arte | Lënda: Muzikë | Shkalla: IV | Klasa VIII |
|---|---|---|---|

**Tematika:** Teknika dhe procese

**Tema mësimore:** “O sa bukur paske çil-e”

• ***Situata e të nxënit: Mjedisi ku unë jetoj.***
Nxënësit/et flasin rreth qytetit/krahinës/fshatit të tyre por jo vetëm, duke listuar të mirat e bimësisë në mjedisin ku jetojnë.

**Rezultatet e të nxënit të kompetencave të lëndës sipas temës mësimore:**

Nxënësi/ja:
- komunikon qartë çka di për mjedisin dhe ruajtjen e tij;
- këndon duke respektuar teknikën e këndimit përmes rregullave të përcaktuara;
- interpreton këngët me ndjenjë dhe emocion;
- respekton interpretimin dhe performimin e shokëve;
- këndon vetëm dhe në grup.

**Fjalë kyçe:**
- melodia e këngës;
- teksti i këngës;
- rregullat e këndimit.

**Burimet:**
- teksti i nxënësit.
- materiale të përgatitura nga mësuesi/ja, nga burime të ndryshme rreth temës;
- kënga në CD.

**Lidhja me fushat e tjera:**
- shkencat shoqërore: njohuri për shoqërinë;
- shkencat natyrore: Biologjia;
- gjuhët dhe komunikimi: letërsia;

**• Lidhja me temat ndërkurrikulare**
- mjedisi.

**Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve**

● ***Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve***

Mësuesi/ja shkruan në tabelë një fjalë: “*Mjedisi ynë”* dhe nxënësit/et flasin rreth qytetit/krahinës/fshatit të tyre por jo vetëm, duke listuar të mirat e bimësisë në mjedisin ku jetojnë.
Diskutohet rreth rëndësisë së ruajtjes së mjedisit nga njeriu.

● ***Ndërtimi i njohurive të reja***
- Vendoset në CD kënga “O sa bukur paske çil-e”.
- Mësuesi/ja nxit nxënësit/et të diskutojnë nëse kënga do të ishte më e bukur dhe do të krijonte emocion vetëm përmes muzikës apo të dyjave së bashku?
- **Rivendoset** përsëri kënga dhe **vazhdohet** puna me mësimin e “O sa bukur paske çil-e” sipas hapave të mëposhtëm:
  - këndimi varg pas vargu,
  - përsëritja e vargjeve herë pas here,
  - këndimi i strofës,
  - këndimi i strofës dhe refrenit,
  - përsëritja e këngës nga fillimi në fund,
  - interpretimi i këngës me ndjenjë dhe emocion,
  - këndimi i këngës vetëm dhe në grup.

● **Gjatë mësimit të këngës, tregohet** kujdes të respektohet *ritmi, intonacioni, interpretimi i* këngës.

Kënga këndohet disa herë në intonacion dhe në ritëm, duke respektuar rregullat e këndimit, sidomos të këndimit në grup.

● ***Vlerësimi***

Vlerësimi i nxënësit/es do të bëhet për *demonstrimin e rezultateve të arritura në*:

- diskutimin me njëri/a-tjetrin/ën rreth karakteristikave të qytetit dhe krahinës së tyre;
- këndimin korrekt duke e interpretuar këngën me ndjenjë dhe emocion, sipas rregullave të këndimit në ritëm dhe intonacion;
- interpretimin, e këngës me ndjenjë dhe emocion vetëm ose në grup.

● **Detyra: Rendit** disa këngë popullore që u kushtohen luleve dhe diskuto rreth tyre në klasë. **Përshkruaj** në një ese të shkurtër emocionet që të jep kënga shkodrane, kur e dëgjon apo kur e këndon.

**Portofoli i nxënësit/es:**

Punimet e zhvilluara nga nxënësit/et, ruhen në dosjet e tyre personale.

***Shënime specifike:***



*Pazari i vjetër i Shkodrës*

| Fusha: Arte | Lënda: Muzikë | Shkalla: IV | Klasa VIII |
|---|---|---|---|

**Tematika:** Gjuha dhe komunikimi muzikor

**Tema mësimore:** Ritmi 7/8

• ***Situata e të nxënit: Dëgjojmë dhe imitojmë ritmet***

Vendoset CD-ja për të dëgjuar fragmente të ndryshme muzikore dhe nxënësit/et improvizojnë ritmin që dëgjojnë. Mësuesi/ja rikujton ritmin 5/8, i mësuar më parë, duke ritmizuar atë e duke i nxitur fëmijët ta ndjekin në imitimin e tyre dhe në kuptimin e karakteristikës, si ritëm i përzier.

**Rezultatet e të nxënit të kompetencave të lëndës sipas temës mësimore:**

Nxënësi/ja:
- identifikon *ritmin 7/8* në ushtrime apo partitura të ndryshme muzikore;
- lexon ushtrime ritmike në *ritmin 7/8;*
- këndon fragmente muzikore/këngë *në ritmin 7/8;*
- krijon duke përdorur një ose të gjitha variantet e *ritmit 7/8;*
- komunikon qartë njohuritë muzikore, mbi *ritmin 7/8* dhe përdorimit të tyre në muzikën tonë popullore.

**Fjalë kyçe:**
- nota 7/8;
- tri variantet muzikore të ritmit 7/8.

**Burimet:**
- teksti i nxënësit;
- materiale të ndryshme të parapërgatitura nga mësuesi/ja;
- fletorja nxënësit;
- shembuj në CD.

**Lidhja me fushat e tjera:**
- matematika: përdorimi i thyesave në matematikë dhe kuptimi i tyre edhe në muzikë.

**Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve**

● ***Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve***

Mësimi fillon me një veprimtari konkrete ku mësuesi/ja vendos CD-në për të dëgjuar fragmente të ndryshme muzikore dhe nxënësit/et improvizojnë ritmin që dëgjojnë. Mësuesi/ja ritmizon ritme dyshe dhe treshe duke i nxitur fëmijët ta ndjekin në imitimin e tyre dhe në kuptimin e karakteristikës si ritëm i përzier.

Diskutimet i ndihmojnë të kuptojnë më mirë ritmin 7/8.

● ***Ndërtimi i njohurive të reja***

Ora mësimore vazhdon më tej, kur mësuesi/ja fillon:
- shpjegimin hap pas hapi të *ritmin 7/8* shumë i përdorur në muzikën tonë popullore, duke vazhduar më tej me
- paraqitjen e shembujve të tjerë të parapërgatitur nga vetë ai/ajo, ose që gjenden në librin apo në fletoren e nxënësit,

- leximin dhe këndimin e ushtrimeve *në ritmin 7/8* me zë,
- ushtrimin përmes shembujve të ndryshëm muzikorë në *ritmin 7/8* deri në fund të orës,
- diskutimin rreth *ritmit 7/8* nga vetë nxënësit/et.

● ***Vlerësimi***

Vlerësimi i nxënësit/es do të bëhet për *demonstrimin e rezultateve të arritura në:*

- Kuptimin e *ritmit 7/8;*
- identifikimin dhe ritmizimin në ushtrime të ndryshme *të ritmit 7/8*;
- krijimin me variantet e mësuara të ritmit 7/8;
- komunikimin qartë të njohurive muzikore, mbi *ritmin 7/8* dhe përdorimin e tij në muzikën tonë popullore;
- bashkëpunimin gjatë plotësimit të detyrës vetëm ose në grup.

● **Detyra: Krijo** në fletoren tënde një ushtrim muzikor në ritmin 7/8 prej 8 masash muzikore. Përdor tri variantet e mësuara të këtij ritmi.

**Portofoli i nxënësit/es:**

Punimet e zhvilluara nga nxënësit/et, ruhen në dosjet e tyre personale.

***Shënime specifike:***



| Fusha: Arte | Lënda: Muzikë | Shkalla: IV | Klasa VIII |
|---|---|---|---|

**Tematika:** Teknika dhe procese

**Tema mësimore:** "Lule bore"

***• Situata e të nxënit: Mjedisi me lule***
U kërkohet për një moment nxënësve të imagjinojnë një kopësht me lule, dhe të thonë emrat e luleve të preferuara. Pse lulet janë shpesh subjekt në tekste këngësh?

**Rezultatet e të nxënit të kompetencave të lëndës sipas temës mësimore:**

Nxënësi/ja:
- këndon duke respektuar teknikën e këndimit përmes rregullave të përcaktuara;
- interpreton këngët me ndjenjë dhe emocion;
- respekton interpretimin dhe performimin e shokëve/shoqeve;
- këndon vetëm dhe në grup.

**Fjalë kyçe:**
- melodia e këngës;
- teksti i këngës;
- rregullat e këndimit.

**Burimet:**
- teksti i nxënësit;
- materiale të përgatitura nga mësuesi/ja, nga burime të ndryshme rreth temës;
- kënga në CD.

**Lidhja me fushat e tjera:**
- shkencat shoqërore: njohuri për shoqërinë;
- shkencat natyrore: biologjia;
- gjuhët dhe komunikimi: letërsia.

***• Lidhja me temat ndërkurrikulare***
- mjedisi.

**Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve**

● ***Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve***
- Mësuesi/ja shkruan në tabelë: "*Lulja ime e preferuar*" duke u kërkuar për një moment nxënësve/eve të imagjinojnë një kopësht me lule, dhe të thonë emrat e luleve të preferuara. Pse lulet janë shpesh subjekt në tekste këngësh? Diskutohet rreth rëndësisë së mbajtjes së luleve në mjedisin ku jetojmë çdo ditë.

● ***Ndërtimi i njohurive të reja***
- Vendoset në CD kënga "Lule bore".
- Nxiten nxënësit/et të diskutojnë nëse kënga do të ishte më e bukur dhe do të krijonte emocion vetëm përmes muzikës apo të dyjave së bashku?

● **Rivendoset** përsëri kënga dhe **vazhdohet** puna me mësimin e "Lule bore" sipas hapave të mëposhtëm:
- këndimi varg pas vargu,
- përsëritja e vargjeve herë pas here,
- këndimi i strofës,
- këndimi i strofës dhe refrenit,
- përsëritja e këngës nga fillimi në fund,
- interpretimi i këngës me ndjenjë dhe emocion,
- këndimi i këngës vetëm dhe në grup.

● **Gjatë mësimit të këngës, tregohet** kujdes të respektohet *ritmi, intonacioni, interpretimi i* këngës.

Kënga këndohet disa herë në intonacion dhe në ritëm, duke respektuar rregullat e këndimit, dhe duke e kënduar në grup.

● ***Vlerësimi***

Vlerësimi i nxënësit/es do të bëhet për *demonstrimin e rezultateve të arritura në*:
diskutimin me njëri/a-tjetrin/ën rreth luleve dhe karakteristikave të tyre.
këndimin korrekt duke e interpretuar këngën me ndjenjë dhe emocion, sipas rregullave të këndimit në ritëm dhe intonacion.
- interpretimin e këngës me ndjenjë dhe emocion, vetëm ose në grup.

● **Detyra: Përshkruaj** në një ese të shkurtër emocionet që të jep kënga kur e dëgjon apo e këndon.

**Portofoli i nxënësit/es:**
Punimet e zhvilluara nga nxënësit/et, ruhen në dosjet e tyre personale.

***Shënime specifike:***



| Fusha: Arte | Lënda: Muzikë | Shkalla: IV | Klasa VIII |
|---|---|---|---|
| **Tematika:** Gjuha dhe komunikimi muzikor<br><br>**Tema mësimore:** Ritmi 9/8 | | ***• Situata e të nxënit: Dëgjojmë dhe imitojmë ritmet***<br>Vendoset CD-ja për të dëgjuar fragmente të ndryshme muzikore dhe nxënësit/et improvizojnë ritmin që dëgjojnë. Mësuesi/ja rikujton dy ritmet e tjera të mësuara dhe ritmizon ritmin 9/8 duke i nxitur fëmijët ta ndjekin në imitimin e tyre dhe në kuptimin e karakteristikës si ritëm i përzier. | |
| **Rezultatet e të nxënit të kompetencave të lëndës sipas temës mësimore:**<br>Nxënësi/ja:<br>- Identifikon *ritmin 9/8* në ushtrime apo partitura të ndryshme muzikore;<br>- lexon ushtrime ritmike në *ritmin 9/8;*<br>- këndon fragmente muzikore/këngë *në ritmin 9/8;*<br>- krijon duke përdorur një ose të gjitha variantet e *ritmit 9/8*. | | **Fjalë kyçe:**<br>- nota 9/8;<br>- katër variantet muzikore të ritmit 9/8. | |
| **Burimet:**<br>- teksti i nxënësit;<br>- materiale të ndryshme të parapërgatitura nga mësuesi/ja;<br>- fletorja nxënësit;<br>- Shembuj në CD. | | **Lidhja me fushat e tjera:**<br>- matematika: përdorimi i thyesave në matematikë dhe kuptimi i tyre edhe në muzikë. | |

**Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve**

● ***Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve***

Mësimi fillon me një veprimtari konkrete ku mësuesi/ja vendos CD-në për të dëgjuar fragmente të ndryshme muzikore dhe nxënësit/et improvizojnë ritmin që dëgjojnë. Mësuesi/ja ritmizon ritme dyshe dhe treshe, duke i nxitur fëmijët ta ndjekin në imitimin e tyre dhe kuptimin e karakteristikës si ritëm i përzier.

Diskutimet i ndihmojnë të kuptojnë më mirë ritmin 9/8.

● ***Ndërtimi i njohurive të reja***

Ora mësimore vazhdon më tej, ku mësuesi/ja fillon:

- shpjegimin hap pas hapi të *ritmin 9/8,* shumë i përdorur në muzikën tonë popullore, duke vazhduar më tej me
- paraqitjen e shembujve të tjerë të parapërgatitur nga vetë ai/ajo, ose që gjenden në librin apo në fletoren e nxënësit,
- leximin dhe këndimin e ushtrimeve *në ritmin 9/8* me zë,
- ushtrimin përmes krijimit të shembujve të ndryshëm muzikorë në *ritmin 9/8* deri në fund të orës,
- diskutimin rreth *ritmit 9/8* nga vetë nxënësit/et.

● ***Vlerësimi***

Vlerësimi i nxënësit/es do të bëhet për *demonstrimin e rezultateve të arritura në:*
- kuptimin e *ritmit 9/8;*
- identifikimin dhe ritmizimin në ushtrime të ndryshme *të ritmit 9/8*;
- krijimin e ushtrimeve në ritmin 9/8;
- komunikimin qartë të njohurive muzikore, mbi *ritmin 9/8* dhe përdorimin e tij në muzikën tonë popullore;
- bashkëpunimit gjatë plotësimit të detyrës vetëm ose në grup.

● **Detyra: Krijo** në fletoren tënde një ushtrim muzikor në ritmin 9/8 prej 8 masash muzikore. Përdor njërën nga variantet e mësuara të këtij ritmi.



**Portofoli i nxënësit/es:**

Punimet e zhvilluara nga nxënësit/et, ruhen në dosjet e tyre personale.

***Shënime specifike:***



| Fusha: Arte | Lënda: Muzikë | Shkalla: IV | Klasa VIII |
|---|---|---|---|

**Tematika:** Teknika dhe procese

**Tema mësimore:** “Trimëreshat tona”

• ***Situata e të nxënit: Femra dhe kontributi i saj***
Cili është kontributi që kanë dhënë nënat shqiptare gjatë Luftës së Dytë Botërore? Po në shoqërinë e sotme a është e respektuar femra shqiptare?

**Rezultatet e të nxënit të kompetencave të lëndës sipas temës mësimore:**

Nxënësi/ja:
- këndon duke respektuar teknikën e këndimit përmes rregullave të përcaktuara;
- interpreton këngët me ndjenjë dhe emocion;
- respekton interpretimin dhe performimin e shokëve;
- këndon vetëm dhe në grup.

**Fjalë kyçe:**
- melodia e këngës;
- teksti i këngës;
- rregullat e këndimit.

**Burimet:**
- teksti i nxënësit;
- materiale të përgatitura nga mësuesi/ja, nga burime të ndryshme rreth temës;
- kënga në CD.

**Lidhja me fushat e tjera:**
- shkencat shoqërore: historia, gjeografia;
- gjuhët dhe komunikimi: letërsia.

**Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve**

● ***Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve***

Mësuesi/ja shkruan në tabelë: “*Lufta dhe paqja”* duke u kërkuar të diskutojnë se cili është kontributi që kanë dhënë nënat shqiptare gjatë Luftës së Dytë Botërore? Po në shoqërinë e sotme a është e respektuar femra shqiptare?

● ***Ndërtimi i njohurive të reja***
- Vendoset në CD kënga “Trimëreshat tona”.
- Nxiten nxënësit/et të diskutojnë nëse kënga do të ishte më e bukur dhe do të krijonte emocion vetëm përmes muzikës apo të dyjave së bashku?
- **Vendoset** përsëri kënga dhe **vazhdohet** puna me mësimin e “Trimëreshat tona” sipas hapave të mëposhtëm:
  - këndimi varg pas vargu,
  - përsëritja e vargjeve herë pas here,
  - këndimi i strofës,
  - këndimi i strofës dhe refrenit,
  - përsëritja e këngës nga fillimi në fund,
  - interpretimi i këngës me ndjenjë dhe emocion,
  - këndimi i këngës vetëm dhe në grup.

**Gjatë mësimit të këngës, tregohet** kujdes të respektohet *ritmi, intonacioni, interpretimi i* këngës.

Kënga këndohet disa herë në intonacion dhe në ritëm, duke respektuar rregullat e këndimit, sidomos të këndimit në grup.

● ***Vlerësimi***
Vlerësimi i nxënësit/es do të bëhet për *demonstrimin e rezultateve të arritura në*:
- diskutimin me njëri/a-tjetrin/ën rreth luleve dhe karakteristikave të tyre.
- Këndimin korrekt duke e interpretuar këngën me ndjenjë dhe emocion, sipas rregullave të këndimit në ritëm dhe intonacion.
- interpretimin e këngës me ndjenjë dhe emocion vetëm ose në grup.

● **Detyra:** **Kërko** informacion nga burime të ndryshme rreth këngëve të krijuara gjatë luftës Nacionalçlirimtare në Shqipëri dhe diskutoji ato në klasë..
**Gjej** këngë të tjera partizane dhe krijo një album me to.

**Portofoli i nxënësit/es:**
Punimet e zhvilluara nga nxënësit/et, ruhen në dosjet e tyre personale.

***Shënime specifike:***



*Piktura "Tregim nga Lufta Nacionalçlirimtare" nga Nexhmedin Zajmi*

| Fusha: Arte | Lënda: Muzikë | Shkalla: IV | Klasa VIII |
|---|---|---|---|

**Tematika:** Histori, muzika dhe shoqëria

**Tema mësimore: “**Muzika popullore shqiptare”

• ***Situata e të nxënit: Kënga popullore e preferuar***

Vendosen disa fragmente nga këngë popullore të krahinave të ndryshme dhe nxënësit/et listojnë karakteristikat e secilës këngë.

**Rezultatet e të nxënit të kompetencave të lëndës sipas temës mësimore:**

Nxënësi/ja:
- identifikon muzikën popullore nga llojet e tjera muzikore;
- liston karakteristikat e muzikës dhe këngës popullore sipas krahinave;
- diskuton për këngën popullore të trevave të ndryshme shqiptare;
- përdor media (DVD, CD, magnetofon) për të prezantuar punën e vet;
- ndan njohuritë e veta me të tjerët.

**Fjalë kyçe:**
- muzika popullore;
- kënga popullore.

**Burimet:**
- teksti i nxënësit;
- materiale të përgatitura nga mësuesi/ja, me
- fragmente muzikore popullore të ndryshme;
- fletorja e nxënësit;
- CD/DVD.

**Lidhja me fushat e tjera:**
- shkencat sociale: historia, gjeografia;
- gjuha dhe komunikimi: letërsia;
- artet: arti pamor.
- Lidhja me temat ndërkurrikulare
- trashëgimia kulturore.

**Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve**

● ***Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve***
- Mësimi fillon me një veprimtari konkrete ku mësuesi/ja vendos në CD ose DVD disa fragmente nga këngë popullore të krahinave të ndryshme dhe nxënësit/et listojnë karakteristikat e secilës këngë.
- Nxënësit/et diskutojnë rreth karakteristikave të muzikës dhe këngës popullore shqiptare.

● ***Ndërtimi i njohurive të reja***

Veprimtaria mësimore vazhdon më tej, ku mësuesi/ja bën:
- shpjegimin mbi muzikën dhe këngën popullore, duke vendosur një hartë të Shqipërisë dhe përcaktuar ndarjen e muzikës popullore, sipas zonave që ata/ato njohin.
- shpjegimin e karakteristikave të muzikës dhe këngës popullore sipas zonave.
- nxitjen e nxënësve/eve për të bërë krahasimin e mënyrave të të kënduarit sipas krahinave.
- grumbullimin e shembujve muzikorë/këngëve popullore nga *youtube* apo *interneti,* duke diskutuar karakteristikat që ata kanë dhe duke veçuar pse ata/ato i pëlqejnë këto karakteristika.

● ***Vlerësimi***

Vlerësimi i nxënësit/es do të bëhet për *demonstrimin e rezultateve të arritura në**:***

- identifikimin e muzikës dhe këngës popullore sipas krahinave të ndryshme në Shqipëri;
- shpjegimin e karakteristikave të këngës popullore;
- evidentimin e muzikës popullore që pëlqejnë më shumë dhe të shpjegojnë arsyen pse u pëlqen;
- gjetjen dhe krijimin e këngëve të kënduara nga këngëtarë të ndryshëm popullore, duke krijuar portofolin e vet;
- bashkëpunimin në grup për realizimin e detyrave.

● **Detyra: Gjej** informacione nga burime të ndryshme mbi këngët popullore të krahinës tënde dhe diskutoji në klasë.

**Shkruaj** tekstin e një kënge popullore të krahinës tënde.

**Portofoli i nxënësit/es:**

Punimet e zhvilluara nga nxënësit/et, ruhen në dosjet e tyre personale.

***Shënime specifike:***







| Fusha: Arte | Lënda: Muzikë | Shkalla: IV | Klasa VIII |
|---|---|---|---|

**Tematika:** Histori, muzika dhe shoqëria

**Tema mësimore:** "Vallja shqiptare"

• ***Situata e të nxënit: Vallja popullore e preferuar***

Vendosen disa fragmente nga valle popullore të krahinave të ndryshme dhe nxënësit/es listojnë karakteristikat e secilës valle që dëgjojnë ose mund t'i shikojnë në DVD.

**Rezultatet e të nxënit të kompetencave të lëndës sipas temës mësimore:**

Nxënësi/ja:

- identifikon lloje të ndryshme të valleve popullore;
- liston karakteristikat e një ose më shumë valleve popullore shqiptare sipas krahinave;
- diskuton për vallet popullore të trevave të ndryshme shqiptare;
- përdor media (DVD, CD, magnetofon) për të prezantuar punimin e vet;
- ndan njohuritë e veta me të tjerët.

**Fjalë kyçe:**

- vallja popullore.

**Burimet:**

- teksti i nxënësit;
- materiale të përgatitura nga mësuesi/ja, me
- fragmente muzikore popullore të ndryshme;
- fletorja e nxënësit;
- CD/DVD.

**Lidhja me fushat e tjera:**

- shkencat sociale: historia, gjeografia.
- gjuha dhe komunikimi: letërsia.
- artet: arti pamor.

**Lidhja me temat ndërkurrikulare**

- trashëgimia kulturore.

**Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve**

● ***Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve***

Mësimi fillon me një veprimtari konkrete ku mësuesi/ja vendos në CD ose DVD disa fragmente nga valle të ndryshme popullore të krahinave shqiptare dhe nxënësit/et listojnë karakteristikat e secilës valle si: muzika, lëvizjet, kostumet etj.

Nxënësit/et diskutojnë rreth karakteristikave të valleve popullore shqiptare.

● ***Ndërtimi i njohurive të reja***

Veprimtaria mësimore vazhdon më tej, ku mësuesi/ja bën:

- shpjegimin mbi vallen popullore sipas trevave shqiptare.
- shpjegimin e karakteristikave të valles popullore sipas zonave.
- nxitjen e nxënësve/eve për të bërë krahasimin e mënyrave të kërcimit sipas krahinave, por edhe llojit të kërcimit.
- grumbullimin e valleve popullore nga *youtube* apo *interneti,* duke diskutuar karakteristikat që ato kanë dhe veçuar pse ata/ato i pëlqejnë këto karakteristika.

● ***Vlerësimi***

Vlerësimi i nxënësit/es do të bëhet për *demonstrimin e rezultateve të arritura në:*

- identifikimin e valles popullore sipas krahinave të ndryshme në Shqipëri;
- shpjegimin e karakteristikave të valleve popullore;
- evidentimin e valles popullore që pëlqejnë më shumë dhe të shpjegojnë arsyen pse u pëlqen;
- gjetjen dhe krijimin e valleve të interpretuara nga valltarë të ndryshëm popullore, duke krijuar portofolin e vet;
- bashkëpunimin në grup për realizimin e detyrave.

● **Detyra: Kërko** ndihmë nga të rriturit për të mbledhur të dhëna rreth këngëve dhe valleve popullore të zonës ku jeton.

**Portofoli i nxënësit/es:**

Punimet e zhvilluara nga nxënësit/et, ruhen në dosjet e tyre personale.

***Shënime specifike:***

____________________________________________

____________________________________________

____________________________________________

____________________________________________

____________________________________________

____________________________________________

____________________________________________

____________________________________________

____________________________________________

____________________________________________



# VERIFIKOJMË NJOHURITË MUZIKORE

## TEST

**1. Rretho** ***përgjigjen e saktë.***

• *Ritmi 5/8 ka:*

**a)** ***2 lëvizje dore;*** **b)** ***3 lëvizje dore;*** **c)** ***4 lëvizje dore.***

• *Ritmi 7/8* formohet nga:

**a)** ***një masë e thjeshtë;*** **b)** ***dy masa të thjeshta;*** **c)** ***tri masa të thjeshta.***

• *Ritmi 7/8 ka:*

**a)** ***2 lëvizje dore;*** **b)** ***3 lëvizje dore;*** **c)** ***4 lëvizje dore.***

• *Ritmi 9/8 ka:*

**a)** ***2 lëvizje dore;*** **b)** ***3 lëvizje dore;*** **c)** ***4 lëvizje dore.***

**2. Shkruaj** një nga variantet e ritmeve muzikore 5/8, 7/8 dhe 9/8.



**3. Lidh** me shigjetë *numrat e krahut të majtë* me *variantet muzikore* të ritmeve 5/8, 7/8 dhe 9/8.



3 + 2

2 + 3

2 + 2 + 3

3 + 2 + 2

2 + 3 + 2

2 + 2 + 2 + 3

2 + 3 + 2 + 2

3 + 2 + 2 + 2

2 + 2 + 3 +2



**Dëgjo** ***këngë dhe valle popullore nga krahina të ndryshme dhe ngjyros në hartë zonën, së cilës i përkasin. Me*** **të kuqe** ***këngët dhe vallet popullore të Shqipërisë Veriut, me*** **të verdhë** ***ato të Shqipërisë së Mesme dhe me*** **jeshile** ***ato të Shqipërisë së Jugut.***

**Shëno titujt e tyre në tabelat përkatëse.**

**Shqipëria e Veriut**

**Shqipëria e Mesme**

**Shqipëria e Jugut**



| Fusha: Arte | Lënda: Muzikë | Shkalla: IV | Klasa VIII |
|---|---|---|---|

**Tematika:** Teknika dhe procese

**Projekt kurrikular:** "Trashëgimia jonë kulturore materiale dhe jomateriale"

• ***Situata e të nxënit: Muzika përmes njohurive tona***

Nxënësve/eve u kërkohet të gjejnë nëpërmjet internetit materiale muzikore popullore nga krahina të ndryshme të Shqipërisë.

**Rezultatet e të nxënit të kompetencave të lëndës sipas temës mësimore:**

Nxënësi/ja:

- bashkëpunon me të tjerët për të vendosur se si do të realizohet në grup detyra e ngarkuar mbi trashgiminë e muzikës popullore;
- kërkon dhe hulumton nga burime të ndryshme informacioni;
- përzgjedh informacionin e mbledhur;
- përgatit punën e vet individualisht ose në grup;
- respekton mendimin e shokëve/shoqeve;
- përdor media (DVD, CD, magnetofon) për të paraqitur punën e vet.

**Fjalë kyçe:**

- projekt;
- bashkëpunim;
- këngë popullore;
- valle popullore

**Burimet:**

- teksti i nxënësit;
- burime të ndryshme informacioni;
- paraqitje në ppt etj.

**Lidhja me fushat e tjera:**

- shkencat shoqërore dhe mjedisi: historia dhe gjeografia;
- gjuha dhe komunikimi: letërsia.

**Lidhja me temat ndërkurrikulare**

- të njohim kulturën e njëri-tjetrit.

**Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve**



● ***Ndarja e grupeve dhe ndarja e detyrave***

Mësuesi/ja paraqet që në fillim temën: Muzika dhe të rinjtë. Më pas jep dy çështje, të cilat do të zhvillohen nga nxënësit/et në grupe të veçanta, ku secili prej nxënësve/eve mund të zhvillojë aftësitë më të mira që ka:

**Grupi i kërkimit për trashëgiminë kulturore (TK) materiale gjen informacion nga burime të ndryshme rreth:**

1. trashëgimisë kulturore materiale në të gjitha trevat shqiptare;
2. institucioneve që kujdesen për të.

**Grupi i kërkimit për TK jo materiale gjen informacion nga burime të ndryshme rreth:**

1. trashëgimisë kulturore jo materiale në të gjitha trevat shqiptare;
2. historikut të trashëgimisë kulturore jo materiale: vende dhe objekte.



**Grupi i kërkimit për TK muzikore gjen informacion nga burime të ndryshme rreth:**

1. trashëgimisë sonë muzikore: këngë, valle dhe instrumente popullore;
2. institucioneve që kujdesen për TK muzikore.



Grupet punojnë secili në mënyrë të pavarur, i zgjedhur vetë materialet dhe mjetet për të realizuar detyrën e ngarkuar.
Ato i paraqesin produktet e realizuara në fund të tremujorit.
Nxënësit/et e vlerësojnë vetë punën e arritur nga secili grup.

● ***Paraqitja dhe demonstrimi i rezultateve të arritura***

Nxënësit/et:

- punojnë në grup;
- respektojnë mendimin e njëri-tjetrit gjatë punës;
- zhvillojnë detyrën sipas tematikës së caktuar dhe e paraqesin atë.
- ***Detyrë:*** Krijimet e nxënësve/eve ruhen në dosjet e tyre.

● ***Vlerësimi***

Vlerësimi i nxënësit/es do të kryhet për pjesëmarrjen në mënyrë aktive gjatë krijimit muzikor dhe çështje të tjera lidhur me projektin.





# *Planifikimi i periudhës së dytë: Janar - Mars*

| Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe |
|---|
| **Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit**<br>Nxënësi/ja:<br>- zhvillon personalitetin e vet dhe është aktiv në veprimtaritë artistike;<br>- gjykon drejt mesazhin artistik;<br>- shprehet nëpërmjet një komunikimi të qartë dhe saktë me anë të gjuhëve, simboleve, shenjave dhe formave muzikore;<br>- shfrytëzon mjetet artistike dhe mundësitë e komunikimit dhe të të shprehurit në muzikë në mënyrë të pavarur, të vazhdueshme, kritike dhe krijuese.<br><br>**Kompetenca e të menduarit**<br>Nxënësi/ja:<br>- përpunon njohuritë muzikore në mënyrë të pavarur, krijuese dhe me përgjegjësi;<br>- zgjidh probleme të ndryshme muzikore/artistike;<br>- zhvillon aftësitë për të menduar në mënyrë kritike, krijuese dhe ndërvepruese;<br>- ndjek udhëzimet për të realizuar një krijim apo veprimtari muzikore artistike.<br><br>**Kompetenca e të mësuarit për të nxënë**<br>Nxënësi/ja:<br>- vendos mjetet në funksion të realizimit të krijimit muzikor;<br>- përdor burime të ndryshme informacioni për të realizuar një krijim muzikor;<br>- krijon në mënyrë të pavarur detyrën e dhënë.<br><br>**Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin**<br>Nxënësi/ja:<br>- merr përsipër ose drejton aktivitetet muzikore brenda dhe jashtë klasës duke kontribuar në mënyrë krijuese.<br><br>**Kompetenca personale**<br>Nxënësi/ja:<br>- krijon besimin te vetja gjatë veprimtarive muzikore;<br>- merr pjesë në mënyrë aktive në jetën artistike shkollore dhe në komunitet;<br>- ndërgjegjëson veten dhe zhvillon vetëbesimin dhe krijimin e besimit tek të tjerët.<br><br>**Kompetenca qytetare**<br>Nxënësi/ja:<br>- bashkëpunon me të tjerët për çështje të ndryshme kulturore;<br>- respekton punën e të tjerëve;<br>- bashkëpunon me të tjerët pavarësisht kulturës, aftësive dhe nevojave brenda dhe jashtë shkollës për një qëllim të përbashkët.<br><br>**Kompetenca digjitale**<br>- shkëmben informacion si dhe bashkëpunon në rrjetet informuese në internet;<br>- përdor njeh mjetet të ndryshme në funksion të informacionit muzikor si: magnetofon, audio, video CD, DVD etj. |

| Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të lëndës | | |
|---|---|---|
| ***Krijimi muzikor*** | ***Performimi/interpretimi muzikor*** | ***Vlerësimi muzikor*** |
| **Nxënësi/ja:**<br>- shpjegon funksionin dhe rolin e simboleve muzikore në pjesët muzikore që interpreton;<br>- interpreton në kohët të ndryshme (*të përziera),* duke demonstruar se i ka kuptuar ato qartë.<br>- | **Nxënësi/ja:**<br>- këndon duke respektuar kohët dhe simbolikat e mësuara;<br>- këndon ushtrime në kohët e mësuara.<br>- këndon duke respektuar teknikën e këndimit përmes rregullave të përcaktuara;<br>- interpreton këngët me ndjenjë<br>- dhe emocion;<br>- interpreton me zë ose fishkëllimë motivet nga këngë apo melodi popullore;<br>- përdor media (DVD, CD, magnetofon) për të prezantuar punën e vet mbi një muzikë popullore, periudhë historike, biografi të një kompozitori ose vepër muzikore shqiptare apo të huaj;<br>- ndan përvojën e vet me të tjerët.<br>- performon/interpreton këngët në organizimet e klasës apo të shkollës. | **Nxënësi/ja:**<br>- bën lidhje ndërmjet asaj që di mbi muzikën shqiptare që nga muzika popullore e deri te muzika profesioniste;<br>- bën gjykime kritike ndaj një vepre të caktuar, duke u mbështetur në *elementet e* gjuhës muzikore *formën muzikore, karakterin* e pjesëve muzikore;<br>- ndan përvojën/mendimin e vet artistik me të tjerët;<br>- komunikon dhe shpreh mendimin e vet rreth veprave muzikore shqiptare, apo të huaja të<br>- dëgjuara. |

| Nr. | Tematika | Temat mësimore | Situata e parashikuar e të nxënit | Burimet |
|---|---|---|---|---|
| 1 | Teknika dhe procese (T&P) | Melodi dhe këngë popullore | **Situata e të nxënit: Provojmë veten**<br>Zhvillohet një konkurs për leximin dhe këndimin më të mirë të shembujve muzikore, nga ana ritmike dhe melodike. Përzgjidhet grupi më i mirë. | • teksti i nxënësit;<br>• materiale të përgatitura nga mësuesi/ja;<br>• material nga burime të ndryshme rreth temës;<br>• kënga në CD. |
| 2 | Histori, muzika dhe shoqëria (H,M&Sh) | Muzika polifonike | **Situata e të nxënit: Unesco dhe mbrojtja e pasurive kulturore**<br>Shkruhet fjala Unesco në tabelë dhe nxënësit diskutojnë rreth asaj që dinë për këtë institucion. | • teksti i nxënësit;<br>• materiale të përgatitura nga mësuesi/ja, me<br>• fragmente muzikore polifonike të ndryshme;<br>• CD/DVD. |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | | | A është futur edhe *isopolifonia* në ruajtjen e Trashëgimisë Kulturore Botërore? Vendosen në CD fragmente muzikore dhe diskutohet nëse është dëgjuar më parë kjo lloj muzike. Çfarë dihet më shumë për këtë lloj të kënduari? | |
| 3 | Teknika dhe procese (T&P) | "Lunxhëri plot lezete" (valle e kënduar) | **Situata e të nxënit: Lunxhëria**<br>Shkruhet në tabelë fjala *Lunxhëria* dhe u kërkohet nxënësve/eve të sjellin të dhëna dhe fakte për:<br>- qytetin ku ndodhet kjo krahinë<br>- karakteristikat e kësaj krahine<br>- trashëgiminë kulturore që përfaqëson etj.<br>Diskutohet rreth fakteve të mbledhura dhe diskutohet nëse një poezi e bukur, plot me figura artistike, i jep vlerë këngës dhe e bën atë të trashëgueshme brez pas brezi? | • teksti i nxënësit;<br>• materiale të përgatitura nga mësuesi/ja;<br>• materiale nga burime të ndryshme rreth temës;<br>• kënga në CD. |
| 4 | Histori, muzika dhe shoqëria (H,M&Sh) | Muzika e kultivuar shqiptare | **Situata e të nxënit: Filmi "Koncert në fund të vitit '36"**<br>Dëgjohet në CD, ose mund të shihet në DVD një fragment nga muzika popullore e kënduar në filmin "Koncert në fund të vitit '36" dhe diskutohet për këto lloje këngësh dhe për këngëtarët/personazhe të filmit. | • teksti i nxënësit;<br>• materiale të përgatitura nga mësuesi/ja, me<br>• fragmente me muzikë të kultivuar shqiptare;<br>• CD/DVD. |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| 5 | Teknika dhe procese (T&P) | "Kënga e krushqve" | **Situata e të nxënit: Dasma shqiptare**<br>Nxënësit/et ndahen në tri grupe ku përshkruajnë shkurtimisht ritualet që kryhen gjatë ceremonisë së dasmës nga tri pjesët e Shqipërisë, e Veriut, e Mesme dhe e Jugut dhe listohen në tabelë. Më pas përcaktohen të veçantat dhe të përbashkëtat e çdo ceremonie. | • teksti i nxënësit;<br>• materiale të përgatitura nga mësuesi/ja;<br>• material nga burime të ndryshme rreth temës;<br>• kënga në CD. |
| 6 | Historia, muzika dhe shoqëria (H,M&Sh) | Instrumentet muzikore popullore | **Situata e të nxënit: Instrumenti dhe tingëllimi i tij**<br>Vendoset fragmenti muzikor i shkëputur nga një film mjaft i njohur shqiptar dhe nxiten nxënësit/et të flasin rreth instrumentit që dëgjojnë, të bëjnë një përshkrim të tij dhe tingëllimit apo timbrit që ai lëshon. Ata/ato diskutojnë me njëri/a- tjetrin/ën rreth njohurive që kanë për këtë instrument apo edhe për instrumente të tjera. | • teksti i nxënësit;<br>• materiale të përgatitura nga mësuesi/ja, me<br>• fragmente muzikore popullore, të luajtura nga instrumentistë të ndryshëm;<br>• CD/DVD. |
| 7 | Teknika dhe procese (T&P) | "Thuaja rini" | **Situata e të nxënit: E ardhmja**<br>Duke dëgjuar melodinë e këngës diskutohet me shokët/shoqet se si e mendojnë ata/ato të ardhmen e tyre, dëshira dhe realizime, për të qenë i/e dobishëm/me për veten dhe shoqërinë. | • teksti i nxënësit;<br>• materiale të përgatitura nga mësuesi/ja;<br>• material nga burime të ndryshme rreth temës;<br>• kënga në CD. |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| 8 | Historia, muzika dhe shoqëria (H,M&Sh) | Muzika instrumentale shqiptare | **Situata e të nxënit: Kompozitori im i preferuar** Njohja e biografisë së një kompozitori, varet nga dëshira se cilën lloj muzike apo rryme duam dhe pëlqejmë më shumë. Një prej tyre është edhe muzika klasike ku ndër kompozitorët shqiptarë të njohur është edhe Pjetër Gaci. Vendoset një fragment nga koncerti për violinë dhe nxënësit/et nxiten të shpjegojnë përjetimin e emocioneve kur dëgjojnë tingullin e violinës dhe gjithë fragmentin. Ata/ato diskutojnë me njëri/a-tjetrin/ën. | • teksti i nxënësit;<br>• materiale të përgatitura nga mësuesi/ja, me<br>• fragmente nga vepra muzikore instrumentale shqiptare;<br>• CD/DVD. |
| 9 | Historia, muzika dhe shoqëria (H,M&Sh) | Muzika vokale shqiptare | **Situata e të nxënit: Kuic** Për të ndërtuar një vepër të madhe marrin pjesë shumë persona p.sh.: për të vënë në skenë një pjesë dramatike marrin pjesë: *aktorët, regjisori, kostumografi, skenografi etj.* Duke dëgjuar një fragment të shkëputur nga aria e Mrikës, së operës “Mrika” të kompozitorit Prenk Jakova, listohen personat që marrin pjesë në një opera. | • teksti i nxënësit;<br>• materiale të përgatitura nga mësuesi/ja, me<br>• fragmente nga vepra muzikore vokale shqiptare;<br>• CD/DVD. |
| 10 | Historia, muzika dhe shoqëria (H,M&Sh) | Baleti shqiptar | **Situata e të nxënit: Kërcimi im i preferuar** Vendosen disa fragmente nga kërcime të ndryshme dhe një fragment i shkëputur nga muzika e baletit “Halili dhe Hajria”, T. Daija. Çfarë emocionesh përjeton kur shikon apo dhe dëgjon muzikën e këtij baleti? Ndaj opinionin tënd me të tjerët. | • teksti i nxënësit;<br>• materiale të përgatitura nga mësuesi/ja, me<br>• fragmente nga vepra skenike dhe balete shqiptare ;<br>• CD/DVD. |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| 11 | Teknika dhe procese (T&P) | Verifikojmë njohuritë muzikore | **Situata e të nxënit: Test** | • teksti i nxënësit;<br>• materiale të përgatitura nga mësuesi/ja, me<br>• fragmente nga valle popullore të ndryshme;<br>• CD/DVD. |
| 12 | Teknika dhe procese (T&P) | Muzika profesioniste shqiptare pas viteve ‘45 | **Situata e të nxënit: Muzika përmes njohurive tona**<br>Nxënësve/eve u kërkohet të gjejnë nëpërmjet internetit materiale muzikore vokale, instrumentale dhe muzikë baleti. | • teksti i nxënësit;<br>• test i përgatitur nga mësuesi/ja. |



**Shënim: Modele udhëzuese për zhvillimin e mësimit, mësuesi mund të gjejë edhe në “Fletoren e punës” së nxënësit.**

# *Planifikimi ditor për periudhën e dytë: Janar – Mars*

| Fusha: Arte | Lënda: Muzikë | Shkalla: IV | Klasa VIII |
|---|---|---|---|

**Tematika:** Teknika dhe procese (T&P)
**Tema mësimore:** Melodi dhe këngë popullore

***• Situata e të nxënit: Provojmë veten***
Zhvillohet një konkurs për leximin dhe këndimin më të mirë të shembujve muzikorë nga ana ritmike dhe melodike. Përzgjidhet grupi më i mirë.

**Rezultatet e të nxënit të kompetencave të lëndës sipas temës mësimore:**

Nxënësi/ja:
- lexon ushtrime ritmike në *ritmet e përziera 5/8, 7/8, 9/8;*
- këndon ushtrime apo melodi nga *ritmet e përziera 5/8, 7/8, 9/8;*
- demonstron aftësi të mira ritmike dhe melodike;
- punon vetëm ose në grup.

**Fjalët kyçe:**

**Burimet:**
- teksti i nxënësit;
- materiale të përgatitura nga mësuesi/ja;
- fletorja e nxënësit.

**Lidhja me fushat e tjera:**

**Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve**

***● Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve***
Mësimi fillon duke zhvillluar një konkurs për leximin dhe këndimin më të mirë të shembujve muzikorë që gjenden në tekstin e nxënësit nga ana ritmike dhe melodike. Nxënësit/et gjykojnë njëri/a-tjetrin/ën duke vlerësuar aftësitë dhe arritjet më të mira të grupit që konkuron.

***● Ndërtimi i njohurive të reja***
Ora mësimore vazhdon më tej, ku mësuesi/ja fillon:
- ndarjen e klasës në tri grupe për leximin dhe këndimin e shembujve muzikorë;
- përcaktimin së bashku *mësuesi/ja dhe nxënësit/et* të kritereve dhe rezultatet që duhet të arrijë çdo grup në tri nivele *N2-N3-N4;*
- dëgjimin e çdo grupi dhe gjykimin e tyre;
- diskutimin dhe vlerësimin sipas kritereve të vendosura dhe rezultateteve të arritura nga secili grup;
- shpalljen e grupit më të mirë.

***● Vlerësimi***
Vlerësimi i nxënësit/es do të bëhet për *demonstrimin e rezultateve të arritura në:*
- leximin e ushtrimeve ritmike në *ritmet e përziera 5/8, 7/8, 9/8;*
- këndimin e ushtrimeve apo melodive nga *ritmet e përziera 5/8, 7/8, 9/8;*
- demonstrimin e aftësi të mira ritmike dhe melodike;
- komunikimin e qartë të njohurive muzikore, mbi *sinkopën dhe kontratempon* dhe përdorimit të tyre në muzikë;
- bashkëpunimin në grup me të tjerët.

<table>
<tr><th>Fusha: Arte</th><th>Lënda: Muzikë</th><th>Shkalla: IV</th><th>Klasa VIII</th></tr>
<tr><td colspan="2">Tematika: Historia, muzika dhe shoqëria<br><br>Tema mësimore: “Muzika polifonike”</td><td colspan="2">• Situata e të nxënit: Unesko dhe mbrojtja e pasurive kulturore<br>Shkruhet fjala Unesko në tabelë dhe nxënësit/et diskutojnë rreth asaj që dinë për këtë institucion. A është futur edhe isopolifonia në ruajtjen e Trashëgimisë Kulturore Botërore? Vendosen në CD fragmente muzikore dhe diskutohet nëse është dëgjuar më parë kjo lloj muzike. Çfarë dihet më shumë për këtë lloj të kënduari?</td></tr>
<tr><td colspan="2">Rezultatet e të nxënit të kompetencave të lëndës sipas temës mësimore:<br>Nxënësi/ja:<br>- identifikon muzikën polifonike nga ajo homofonike;<br>- liston karakteristikat e muzikës polifonike sipas krahinave;<br>- diskuton për këngën popullore homofonike dhe polifonike të trevave të ndryshme shqiptare;<br>- shpjegon karakteristikat e isopolifonisë shqiptare;<br>- ndan njohuritë e veta me të tjerët.</td><td colspan="2">Fjalë kyçe:<br>- iso – polifonia;<br>- kënga popullore homofonike;<br>- kënga popullore polifonike.</td></tr>
<tr><td colspan="2">Burimet:<br>- teksti i nxënësit;<br>- materiale të përgatitura nga mësuesi/ja, me<br>- fragmente muzikore popullore të ndryshme;<br>- fletorja e nxënësit;<br>- CD/DVD.</td><td colspan="2">Lidhja me fushat e tjera:<br>- shoqëria dhe mjedisi: historia, gjeografia;<br>- gjuha dhe komunikimi: letërsia;<br>- artet: arti pamor.<br><br>Lidhja me temat ndërkurrikulare<br>- trashëgimia kulturore.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve</td></tr>
<tr><td colspan="4">● Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve<br>Mësimi fillon me një veprimtari konkrete ku mësuesi/ja shkruan fjalën Unesco në tabelë dhe nxënësit/et diskutojnë rreth asaj që dinë për këtë institucion. A është futur edhe isopolifonia në ruajtjen e Trashëgimisë Kulturore Botërore? Vendosen në CD fragmente muzikore dhe diskutohet nëse është dëgjuar më parë kjo lloj muzike. Çfarë dihet më shumë për këtë lloj të kënduari? Nxënësit/et diskutojnë rreth karakteristikave të muzikës dhe këngës polifonike shqiptare.</td></tr>
<tr><td colspan="4">● Ndërtimi i njohurive të reja<br>Veprimtaria mësimore vazhdon më tej, ku mësuesi bën<br>- shpjegimin mbi muzikën dhe këngën homofonike dhe polifonike popullore, duke vendosur një hartë të Shqipërisë dhe duke përcaktuar ndarjen e muzikës homofonike dhe polifonike popullore, sipas zonave që ata/ato njohin;</td></tr>
</table>

- shpjegimin e karakteristikave të këngës polifonike sipas zonave;
- nxitjen e nxënësve/eve për të bërë krahasimin e mënyrave të të kënduarit polifonik, sipas krahinave;
- nxitjen për grumbullimin e këngëve popullore *homofonike dhe polifonike* nga *youtube* apo *interneti,* duke diskutuar karakteristikat që ata kanë dhe duke veçuar pse ata/ato i pëlqejnë këto karakteristika.

● ***Vlerësimi***

Vlerësimi i nxënësit/es do të bëhet për *demonstrimin e rezultateve të arritura në:*
- identifikimin e këngës popullore *homofonike dhe polifonike,* sipas krahinave të ndryshme në Shqipëri;
- shpjegimin e karakteristikave të *isopolifonisë*;
- evidentimin e këngës polifonike që pëlqejnë më shumë dhe shpjegojnë arsyen pse u pëlqen;
- gjetjen dhe krijimin e këngëve të kënduar nga këngëtarë të ndryshëm popullorë, duke krijuar portofolin e vet;
- bashkëpunimin në grup për realizimin e detyrave.

● **Detyra: Kërko** ndihmën e të rriturve për të grumbulluar të dhëna për këngën polifonike. **Shkruaj** tekstin e një kënge polifonike që di më mirë.

**Portofoli i nxënësit/es:**

Punimet e zhvilluara nga nxënësit/et, ruhen në dosjet e tyre personale.

***Shënime specifike:***





| Fusha: Arte | Lënda: Muzikë | Shkalla: IV | Klasa VIII |
|---|---|---|---|

**Tematika:** Teknika dhe procese

**Tema mësimore:** "Lunxhëri plot lezete" (valle e kënduar)

**• *Situata e të nxënit: Lunxhëria***

Shkruhet në tabelë fjala *Lunxhëria* dhe u kërkohet nxënësve/eve të sjellin të dhëna dhe fakte për:

- qytetin ku ndodhet kjo krahinë
- karakteristikat e kësaj krahine
- trashëgiminë kulturore që përfaqëson etj.

Diskutohet rreth fakteve të mbledhura dhe diskutohet nëse një poezi e bukur, plot me figura artistike, i jep vlerë këngës. A e bën atë të trashëgueshme brez pas brezi?

**Rezultatet e të nxënit të kompetencave të lëndës sipas temës mësimore:**

Nxënësi/ja:

- këndon duke respektuar teknikën e këndimit përmes rregullave të përcaktuara;
- interpreton këngët me ndjenjë dhe emocion;
- respekton interpretimin dhe performimin e shokëve;
- këndon duke respektuar karakteristikën e këngës në grup.

**Fjalë kyçe:**

- melodia e këngës;
- teksti i këngës;
- rregullat e këndimit.

**Burimet:**

- teksti i nxënësit;
- materiale të përgatitura nga mësuesi/ja, nga burime të ndryshme rreth temës;
- kënga në CD.

**Lidhja me fushat e tjera:**

- shoqëria dhe mjedisi: njohuri për shoqërinë, gjeografia, historia;
- gjuhët dhe komunikimi: letërsia;
- artet: arti pamor.

**• Lidhja me temat ndërkurrikulare**

- trashëgimia kulturore.

**Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve**

**● *Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve***

Mësuesi/ja shkruan në tabelë fjalën *Lunxhëria* dhe i kërkohet nxënësve/eve të sjellin të dhëna dhe fakte për:

- qytetin ku ndodhet kjo krahinë;
- karakteristikat e kësaj krahine;
- trashëgiminë kulturore që përfaqëson etj.
- diskutohet rreth fakteve të mbledhura.

**● *Ndërtimi i njohurive të reja***

Vendoset në CD kënga "Lunxhëri plot lezete". Nxënësit/et nxiten të diskutojnë nëse kënga do të ishte më e bukur dhe do të krijonte emocion vetëm përmes muzikës apo të dyjave së bashku? Nxënësit/et ndahen në tri grupe, për të kënduar këngën sipas partiturës në libër.

**Vendoset** përsëri kënga “Lunxhëri plot lezete” dhe **vazhdohet** puna me mësimin e saj, sipas hapave të mëposhtëm:
- këndimi varg pas vargu,
- përsëritja e vargjeve herë pas here,
- këndimi i strofës,
- këndimi i strofës dhe refrenit,
- përsëritja e këngës nga fillimi në fund,
- interpretimi i këngës me ndjenjë dhe emocion,
- këndimi i këngës vetëm dhe në grup.

● **Gjatë mësimit të këngës, tregohet** kujdes të respektohet *ritmi, intonacioni, interpretimi i* këngës.
Kënga këndohet disa herë në intonacion dhe në ritëm, duke respektuar rregullat e këndimit, dhe duke u kënduar në grup.

***Vlerësimi***
Vlerësimi i nxënësit/es do të bëhet për *demonstrimin e rezultateve të arritura në*:
- diskutimin me njëri/a-tjetrin/ën rreth karakteristikave të qytetit dhe krahinës së tyre.
- këndimin duke interpretuar këngën me ndjenjë dhe emocion, sipas rregullave të këndimit në ritëm dhe intonacion.
- interpretimin e këngës vetëm dhe në grup.

● **Detyra: Kujto** ose **dëgjo** këngë polifonike dhe shkruaj figura letrare artistike si: *metafora, krahasimi, epiteti* etj., që përdor populli në to.

**Portofoli i nxënësit/es:**
Punimet e zhvilluara nga nxënësit/et, ruhen në dosjet e tyre personale.

***Shënime specifike:***



| Fusha: Arte | Lënda: Muzikë | Shkalla: IV | Klasa VIII |
|---|---|---|---|

**Tematika:** Historia, muzika dhe shoqëria

**Tema mësimore:** "Muzika e kultivuar"

***• Situata e të nxënit: Filmi "Koncert në fund të vitit '36"***
Dëgjohet në CD ose mund të shihet në DVD një fragment nga muzika popullore e kënduar në filmin "Koncert në fund të vitit '36" dhe të diskutohet për këto lloje këngësh, këngëtarët/personazhe të filmit.

**Rezultatet e të nxënit të kompetencave të lëndës sipas temës mësimore:**

Nxënësi/ja:
- identifikon muzikën e kultivuar nga llojet e tjera muzikore të kënduara;
- bën dallimin e karakteristikave të muzikës së kultivuar nga ajo popullore burimore;
- diskuton për këngën e kultivuar të trevave të ndryshme shqiptare;
- përdor media (DVD, CD, magnetofon) për të prezantuar punën e vet;
- ndan njohuritë e veta me të tjerët.

**Fjalë kyçe:**
- muzika e kultivuar;
- kënga lirike;
- romanca.

**Burimet:**
- teksti i nxënësit;
- materiale të përgatitura nga mësuesi/ja, me
- fragmente me këngë nga muzika e kultivuar ;
- fletorja e nxënësit;
- CD/DVD.

**Lidhja me fushat e tjera:**
- shoqëria dhe mjedisi: historia, gjeografia;
- gjuha dhe komunikimi: letërsia.

**Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve**

● ***Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve***
Mësimi fillon me një veprimtari konkrete ku mësuesi/ja vendos në CD ose DVD disa fragmente nga muzika /këngët e kënduara në filmin "Koncert në fund të vitit '36" dhe diskutohet për këto lloj këngësh dhe këngëtarët/personazhe të filmit. Nxënësit/et diskutojnë rreth karakteristikave të muzikës dhe këngës së kultivuar shqiptare.

● ***Ndërtimi i njohurive të reja***
Veprimtaria mësimore vazhdon më tej, ku mësuesi/ja bën:
- shpjegimin mbi muzikën e kultivuar shqiptare duke përcaktuar disa karakteristika të saj;
- nxitjen e nxënësve/eve për të diskutuar mbi ndryshimin midis muzikës së mirëfilltë popullore dhe asaj të kultivuar dhe mënyrave të të kënduarit; nxitjen për grumbullimin e shembujve muzikorë/këngëve muzikës së kultivuar nga *youtube* apo *interneti,* duke veçuar arsyen pse ata/ato i pëlqejnë këto këngë.

● ***Vlerësimi***

Vlerësimi i nxënësit/es do të bëhet për *demonstrimin e rezultateve të arritura në:*

- shpjegimin e ndryshimit midis muzikës së kultivuar dhe asaj popullore;
- kërkimin dhe mbledhjen e të dhënave mbi zhvillimin e muzikës së kultivuar dhe prezantimin e tyre në klasë;
- gjetjen e këngëve të kënduara nga këngëtarë të ndryshëm dhe krijimin e një albumi CD ose DVD duke ia bashkëngjitur portofolit të vet;
- bashkëpunimin në grup për realizimin e detyrave.

● **Detyra: Kërko** ndihmë nga të rriturit për të grumbulluar të dhëna për muzikën e kultivuar shqiptare.

● **Shkruaj** tekstin e një kënge që bën pjesë në muzikën e kultivuar shqiptare.

**Portofoli i nxënësit/es:**

Punimet e zhvilluara nga nxënësit/et, ruhen në dosjet e tyre personale.

***Shënime specifike:***



*Banda "Vatra"*



*Tefta Tashko Koço (1910-1947)*



*Kristaq Antoniu (1907-1979)*

| Fusha: Arte | Lënda: Muzikë | Shkalla: IV | Klasa VIII |
|---|---|---|---|

**Tematika:** Teknika dhe procese

**Tema mësimore:** "Kënga e krushqve"

**Situata e të nxënit: Dasma shqiptare**
Nxënësit/et ndahen në tri grupe ku përshkruajnë shkurtimisht ritualet që kryhen gjatë ceremonisë së dasmës nga tri pjesët e Shqipërisë e Veriut, e Mesme dhe e Jugut dhe listohen në tabelë. Më pas përcaktohen të veçantat dhe të përbashkëtat e çdo ceremonie.

**Rezultatet e të nxënit të kompetencave të lëndës sipas temës mësimore:**

Nxënësi/ja:
- komunikon qartë çka di për ritualin e dasmës;
- këndon duke respektuar teknikën e këndimit përmes rregullave të përcaktuara;
- interpreton këngët me ndjenjë dhe emocion;
- respekton interpretimin dhe performimin e shokëve;
- këndon vetëm dhe në grup.

**Fjalë kyçe:**
- melodia e këngës;
- teksti i këngës;
- rregullat e këndimit.

**Burimet:**
- teksti i nxënësit;
- materiale të përgatitura nga mësuesi/ja, nga burime të ndryshme rreth temës;
- kënga në CD.

**Lidhja me fushat e tjera:**
- shoqëria dhe mjedisi: njohuri për shoqërinë;
- gjuhët dhe komunikimi: letërsia.

**Lidhja me temat ndërkurrikulare**
- trashëgimia kulturore.

**Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve**

● ***Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve***

Mësuesi/ja ndan nxënësit/et në tri grupe, ku përshkruajnë shkurtimisht ritualet që kryhen gjatë ceremonisë së dasmës nga tri pjesët e Shqipërisë e Veriut, e Mesme dhe e Jugut dhe listohen në tabelë. Më pas përcaktohen të veçantat dhe të përbashkëtat e çdo ceremonie. Diskutohet rreth karakteristikave të këtyre ritualeve dhe rëndësisë së ruajtjes dhe transmetimit të tyre.

● ***Ndërtimi i njohurive të reja***

Vendoset në CD kënga "Kënga e krushqve".
**Vendoset** përsëri kënga dhe **vazhdohet** puna me mësimin e "Kënga e krushqve" sipas hapave të mëposhtëm:
- këndimi varg pas vargu,
- përsëritja e vargjeve herë pas here,
- këndimi i strofës,
- këndimi i strofës dhe refrenit,
- përsëritja e këngës nga fillimi në fund,
- interpretimi i këngës me ndjenjë dhe emocion,
- këndimi i këngës vetëm dhe në grup.

● **Gjatë mësimit të këngës, tregohet** kujdes të respektohet *ritmi, intonacioni, interpretimi i* këngës.

Kënga këndohet disa herë në intonacion dhe në ritëm, duke respektuar rregullat e këndimit, dhe sidomos të këndimit në grup.

● ***Vlerësimi***

Vlerësimi i nxënësit/es do të bëhet për *demonstrimin e rezultateve të arritura në*:

- diskutimin me njëri/a-tjetrin/ën rreth karakteristikave të këngëve të dasmës së qytetit dhe krahinës së tyre.
- këndimin duke interpretuar këngën me ndjenjë dhe emocion, sipas rregullave të këndimit në ritëm dhe intonacion.
- interpretimin e këngës me ndjenjë dhe emocion vetëm dhe në grup.

● **Detyra: Gjej** informacione nga burime të ndryshme për ritualet e martesës në krahinën/qytetin tënd dhe diskutoji në klasë.

**Përshkruaj** në një ese të shkurtër, emocionet që ndien gjatë një ceremoniali martesor.

**Portofoli i nxënësit/es:**

Punimet e zhvilluara nga nxënësit/et, ruhen në dosjet e tyre personale.

***Shënime specifike:***



*Piktura "Dasma shkodrane" - Kol Idromeno*

<table>
<tr><th>Fusha: Arte</th><th>Lënda: Muzikë</th><th>Shkalla: IV</th><th>Klasa VIII</th></tr>
<tr><td colspan="2">Tematika: Historia, muzika dhe shoqëria<br><br>Tema mësimore: “Instrumentet muzikore popullore”</td><td colspan="2">• Situata e të nxënit: Instrumenti dhe tingëllimi i tij<br>Vendoset fragmenti muzikor i shkëputur nga një film mjaft i njohur shqiptar dhe nxiten nxënësit/et të flasin rreth instrumentit që dëgjojnë, të bëjnë një përshkrim të tij dhe tingëllimit apo timbrit që ai lëshon. Ata/ Ato diskutojnë me njëri/a- tjetrin/ën rreth njohurive që kanë për këtë instrument apo edhe për instrumente të tjera.</td></tr>
<tr><td colspan="2">Rezultatet e të nxënit të kompetencave të lëndës sipas temës mësimore:<br>Nxënësi/ja:<br>- identifikon llojin e instrumentit popullor nga timbri;<br>- liston karakteristikat timbrike të instrumenteve popullore që njeh;<br>- diskuton për pamjen e instrumenteve popullore dhe grupimin e tyre;<br>- ndan njohuritë e veta me të tjerët.Situata e të nxënit: Instrumenti dhe tingëllimi i tij.</td><td colspan="2">Fjalë kyçe:<br>- instrumentet muzikore;<br>- orkestra heterotimbrike;<br>- orkestra homotimbrike.</td></tr>
<tr><td colspan="2">Burimet:<br>- teksti i nxënësit;<br>- materiale të përgatitura nga mësuesi/ja, me fragmente muzikore popullore të ndryshme;<br>- fletorja e nxënësit;<br>- CD/DVD.</td><td colspan="2">Lidhja me fushat e tjera:<br>- shoqëria dhe mjedisi: gjeografia;<br>- gjuha dhe komunikimi: letërsia;<br>- artet: arti pamor.<br><br>• Lidhja me temat ndërkurrikulare<br>- trashëgimia kulturore.</td></tr>
<tr><th colspan="4">Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve</th></tr>
<tr><td colspan="4">● Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve<br>Mësimi fillon me një veprimtari konkrete ku mësuesi/ja vendos në CD ose DVD fragmentin muzikor të shkëputur nga një film mjaft i njohur shqiptar, duke i nxitur nxënësit/et të flasin rreth instrumentin që dëgjojnë, të bëjnë një përshkrim të tij dhe tingëllimit apo timbrit që ai lëshon. Ata/ Ato diskutojnë me njëri/a- tjetrin/ën rreth njohurive që kanë për këtë instrument apo për edhe për instrumente të tjera. Nxënësit/et diskutojnë rreth karakteristikave të muzikës dhe këngës popullore shqiptare.</td></tr>
<tr><td colspan="4">● Ndërtimi i njohurive të reja<br>Veprimtaria mësimore vazhdon më tej, ku mësuesi/ja bën:<br>- shpjegimin mbi instrumentet muzikore, timbrikën dhe llojet e tyre;<br>- grupimin e instrumenteve muzikore popullore dhe emërtimet e tyre;</td></tr>
</table>

- nxitjen e nxënësve/eve për të bërë krahasimin orkestrave populore dhe timbrikën e isntruemteve popullore që ata/ato njohin më mirë;
- nxitjen për grumbullimin  e melodive orkestrale apo solo nga *youtube* apo *interneti,* duke diskutuar për artistë të njohur dhe mjeshtra të luajtjes në instrumentet popullore.

● ***Vlerësimi***

Vlerësimi i nxënësit/es do të bëhet për *demonstrimin e rezultateve të arritura në:*
- identifikimin e instrumenteve muzikore popullore përmes timbrikës së tyre;
- krahasimin midis një orkestre homotimbrike dhe hetereotimbrike duke dhënë disa karakteristika;
- gjetjen dhe krijimin e një CD-je me pjesë instrumentale popullore të ekzekutuar nga instrumentistë popullorë, duke krijuar portofolin e vet;
- bashkëpunimin në grup për realizimin e detyrave.

● **Detyra: Zhvillo** një miniprojekt me temë: “Instrumentisti im popullor i parapëlqyer”.
**Krijo** një album me foto nga orkestra popullore apo muzikantë virtuozë që luajnë në instrumente popullore.

**Portofoli i nxënësit/es:**
Punimet e zhvilluara nga nxënësit/et, ruhen në dosjet e tyre personale.

***Shënime specifike:***



Orkestër heterotimbrike




Orkestër homotimbrike

| Fusha: Arte | Lënda: Muzikë | Shkalla: IV | Klasa VIII |
|---|---|---|---|

**Tematika:** Teknika dhe procese

**Tema mësimore:** "Thuaja rini"

• ***Situata e të nxënit: E ardhmja***
Duke dëgjuar melodinë e këngës diskutohet me shokët/shoqet se si e mendojnë ata/ato të ardhmen e tyre, dëshira dhe realizime, për të qenë i/e dobishëm/me për veten dhe shoqërinë.

**Rezultatet e të nxënit të kompetencave të lëndës sipas temës mësimore:**

Nxënësi/ja:
- këndon duke respektuar teknikën e këndimit përmes rregullave të përcaktuara;
- interpreton këngët me ndjenjë dhe emocion;
- respekton interpretimin dhe performimin e shokëve;
- këndon vetëm dhe në grup.

**Fjalë kyçe:**
- melodia e këngës;
- teksti i këngës;
- rregullat e këndimit.

**Burimet:**
- teksti i nxënësit;
- materiale të përgatitura nga mësuesi/ja, nga burime të ndryshme rreth temës;
- kënga në CD.

**Lidhja me fushat e tjera:**
- shoqëria dhe mjedisi: njohuri për shoqërinë;
- gjuhët dhe komunikimi: letërsia.

**Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve**

● ***Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve***
Mësuesi/ja shkruan në tabelë një fjalë: "*E ardhmja ime"* dhe duke dëgjuar melodinë e këngës u kërkohet për një moment nxënësve/eve të imagjinojnë dhe diskutojnë se si e mendojnë ata/ato të ardhmen e tyre, dëshira dhe realizime, për të qenë i/e dobishëm/me për veten dhe shoqërinë.

● ***Ndërtimi i njohurive të reja***
- Vendoset në CD kënga "Thuaja rini".
- **Vendoset** përsëri kënga dhe **vazhdohet** puna me mësimin e "Thuaja rini" sipas hapave të mëposhtëm:
- këndimi varg pas vargu,
- përsëritja e vargjeve herë pas here,
- këndimi i strofës,
- këndimi i strofës dhe refrenit,
- përsëritja e këngës nga fillimi në fund,
- interpretimi i këngës me ndjenjë dhe emocion,
- këndimi i këngës vetëm dhe në grup.

**Gjatë mësimit të këngës, tregohet** kujdes të respektohet *ritmi, intonacioni, interpretimi i* këngës.

Kënga këndohet disa herë në intonacion dhe në ritëm, duke respektuar rregullat e këndimit, dhe sidomos të këndimit në grup..

● ***Vlerësimi***

Vlerësimi i nxënësit/es do të bëhet për *demonstrimin e rezultateve të arritura në*:

- diskutimin me njëri/a-tjetrin/ën për të ardhmen dhe qëllimet që ata/ato kanë për veten e tyre.
- këndimin duke interpretuar këngën me ndjenjë dhe emocion, sipas rregullave të këndimit në ritëm dhe intonacion.
- interpretimin e këngës vetëm dhe në grup.

● **Detyra: Shkruaj** një ese të shkurtër me temë "Kontributi im për familjen dhe shoqërinë".

**Portofoli i nxënësit/es:**

Punimet e zhvilluara nga nxënësit/et, ruhen në dosjet e tyre personale.

***Shënime specifike:***



| Fusha: Arte | Lënda: Muzikë | Shkalla: IV | Klasa VIII |
|---|---|---|---|

**Tematika:** Histori, muzika dhe shoqëria

**Tema mësimore:** "Muzika instrumentale shqiptare"

• ***Situata e të nxënit: Kompozitori im i preferuar***

Njohja e biografisë së një kompozitori varet nga dëshira se cilën lloj muzike apo rryme duam dhe pëlqejmë më shumë. Një prej tyre është edhe muzika klasike ku ndër kompozitorët shqiptarë të njohur është edhe Pjetër Gaci. Vendoset një fragment nga koncerti për violin dhe nxiten nxënësit/et të shpjegojnë përjetimin kur dëgjon tingullin e violinës dhe gjithë fragmentin. Ata/ato diskutojnë me njëri/a-tjetrin/ën.

**Rezultatet e të nxënit të kompetencave të lëndës sipas temës mësimore:**

Nxënësi/ja:
- identifikon muzikën instrumentale profesioniste nga muzika vokale;
- liston vepra dhe përfaqësues të muzikës instrumentale;
- krahason një pjesë muzikore instrumentale profesioniste shqiptare me një botërore, duke shpjeguar pse i pëlqen;
- ndan njohuritë e veta me të tjerët.Situata e të nxënit: Kompozitori im i preferuar.

**Fjalë kyçe:**
- muzika instrumentale profesioniste;
- poemë simfonike;
- koncert;
- rapsodi;
- sonatë;
- trio instrumentale;
- balada;
- kuartet;
- simfoni.

**Burimet:**
- teksti i nxënësit;
- materiale të përgatitura nga mësuesi/ja, me fragmente muzikore nga vepra të muzikës instrumentale;
- fletorja e nxënësit;
- CD/DVD.

**Lidhja me fushat e tjera:**
- gjuha dhe komunikimi: letërsia.

**Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve**

● ***Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve***

Mësimi fillon me një veprimtari konkrete ku mësuesi/ja vendos në CD një fragment nga koncerti për violinë dhe nxiten nxënësit/et të shpjegojnë përjetimin kur dëgjon tingullin e violinës dhe gjithë fragmentin. Njohja e biografisë së një kompozitori varet nga dëshira se cilën lloj muzike apo rryme duam dhe pëlqejmë më shumë. Një prej tyre është edhe muzika klasike ku ndër kompozitorët shqiptarë të njohur është edhe Pjetër Gaci.

● ***Ndërtimi i njohurive të reja***

Veprimtaria mësimore vazhdon më tej, ku mësuesi/ja bën:
- shpjegimin mbi lindjen dhe zhvillimin e muzikës profesioniste shqiptare;
- jep disa karakteristika të muzikës instrumentale shqiptare dhe sjell informacione mbi kompozitorë të ndryshëm shqiptarë;

<table>
<tr><td>
- nxitjen e nxënësve/eve për të bërë krahasimin e një vepre muzikore shqiptare dhe një botërore;<br>
- grumbullimin e veprave të muzikës instrumentale shqiptare nga youtube apo interneti, duke krijuar CD apo DVD.
</td></tr>
<tr><td>
● Vlerësimi<br>
Vlerësimi i nxënësit/es do të bëhet për demonstrimin e rezultateve të arritura në:<br>
- përshkrimin korrekt të muzikës instrumentale shqiptare;<br>
- renditjen e gjinive muzikore të krijuara nga kompozritorët shqiptarë;<br>
- gjetjen e informacionit mbi biografinë e kompozitorit të preferuar dhe një CD me veprat e tij, duke pasuruar portofolin e vet;<br>
- bashkëpunimin në grup për realizimin e detyrave.
</td></tr>
<tr><td>
● Detyra: Zhvillo një miniprojekt me temë “Kompozitori im shqiptar i parapëlqyer”. Kërko nga burime të ndryshme informacion mbi kompozitorë të muzikës profesioniste shqiptare dhe veprat e tyre.<br>
● Krijo një CD me vepra të ndryshme instrumentale të kompozitorëve shqiptarë.<br><br>
Portofoli i nxënësit/es:<br>
Punimet e zhvilluara nga nxënësit/et, ruhen në dosjet e tyre personale.
</td></tr>
</table>

***Shënime specifike:***



*Kuarteti i harqeve të RTSH-së*

| Fusha: Arte | Lënda: Muzikë | Shkalla: IV | Klasa VIII |
|---|---|---|---|

**Tematika:** Historia, muzika dhe shoqëria

**Tema mësimore: "**Muzika vokale shqiptare"

***• Situata e të nxënit: Kuic***

Për të ndërtuar një vepër të madhe marrin pjesë shumë persona p.sh.: për të vënë në skenë një pjesë dramatike marrin pjesë: *aktorët, regjisori, kostumografi, skenografi etj*. Duke dëgjuar një fragment të shkëputur nga aria e Mrikës, së operës "Mrika" të kompozitorit Prenk Jakova listohen personat që marrin pjesë në një opera.

**Rezultatet e të nxënit të kompetencave të lëndës sipas temës mësimore:**

Nxënësi/ja:
- identifikon lloje të ndryshme të të kënduarit nga gjinia më e vogël deri te më e madhja;
- dëgjon vepra muzikore vokale;
- dëgjon fragmente nga arie shqiptare dhe të huaja dhe gjen motivin popullor shqiptar tek to;
- liston vepra dhe përfaqësues të muzikës vokale shqiptare;
- përdor media (DVD, CD, magnetofon) për të krijuar CD me arie të ndryshme;
- ndan njohuritë e veta me të tjerët.

**Fjalët kyçe:**
- kënga;
- kantata;
- opereta;
- opera.

**Burimet:**
- teksti i nxënësit;
- materiale të përgatitura nga mësuesi/ja, me fragmente muzikore nga arie të ndryshme;
- fletorja e nxënësit;
- CD/DVD.

**Lidhja me fushat e tjera:**
- gjuha dhe komunikimi: letërsia.

**Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve**

***● Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve***

Mësimi fillon me një veprimtari konkrete ku mësuesi/ja përmes një pyetjeje rrufe p.sh.: për të ndërtuar një vepër të madhe marrin pjesë shumë persona si:  për të vënë në skenë një pjesë dramatike marrin pjesë: *aktorët, regjisori, kostumografi, skenografi etj.*kërkon të hulumtojë se sa informacion kanë nxënësit/et. Duke dëgjuar një fragment të shkëputur nga aria e Mrikës, së operas "Mrika" të kompozitorit Prenk Jakova, vazhdon nxitjen e tyre për të dëgjuar veprat shqiptare dhe kuptuar ato.

● ***Ndërtimi i njohurive të reja***

Veprimtaria mësimore vazhdon më tej, ku mësuesi/ja bën:
- shpjegimin mbi lindjen dhe zhvillimin e muzikës vokale shqiptare:
- shpjegimin e gjinive vokale nga më e vogla te më e madhja;
- dëgjimin e fragmenteve muzikore shkëputur nga opera të ndryshme;
- nxitjen për grumbullimin e arieve të ndryshme nga *youtube* apo *interneti,* për të pasuruar portofolin.

● ***Vlerësimi***

Vlerësimi i nxënësit/es do të bëhet për *demonstrimin e rezultateve të arritura në:*
- identifikimin e gjinive të ndryshme vokale nga kënga deri tek opera;
- shpjegimin e karakteristikave që dallon këngën nga opera;
- përcaktimin e një arie shkëputur nga një opera duke shpjeguar arsyen pse u pëlqen;
- grumbullimin dhe krijimin e një CD-je të arieve të ndryshme;
- bashkëpunimin në grup për realizimin e detyrave.

● **Detyra: Zhvillo** një miniprojekt me temë "Opera shqiptare dhe kompozitori im i parapëlqyer". Kërko informacion nga burime të ndryshme mbi kompozitorë të muzikës vokale shqiptare.

● **Krijo** një CD me vepra vokale shqiptare të kompozitorëve shqiptarë.

**Portofoli i nxënësit/es:**

Punimet e zhvilluara nga nxënësit/et, ruhen në dosjet e tyre personale.

***Shënime specifike:***



*Në foto këngëtarë lirik, nga e majta: Mentor Xhemali, Gjoni Athanas, Ibrahim Tukiçi dhe Avni Mula*

| Fusha: Arte | Lënda: Muzikë | Shkalla: IV | Klasa VIII |
|---|---|---|---|

<table>
<tr>
<td>Tematika: Historia, muzika dhe shoqëria<br><br>Tema mësimore: “Baleti shqiptar”</td>
<td>• Situata e të nxënit: Kërcimi im i preferuar<br>Vendosen disa fragmente nga kërcime të ndryshme dhe një fragment të shkëputur nga muzika e baletit “Halili dhe Hajria”, T. Daija. Çfarë emocionesh përjeton kur shikon apo dhe dëgjon muzikën e këtij baleti? Ndaj opinionin tënd me të tjerët.</td>
</tr>
<tr>
<td>Rezultatet e të nxënit të kompetencave të lëndës sipas temës mësimore:<br>Nxënësi/ja:<br>- dallon një kërcim popullore nga një kërcim klasik/baleti;<br>- shpjegon lindjen dhe krijimin e baletit shqiptar;<br>- liston vepra dhe përfaqësues të baletit shqiptar;<br>- përdor media (DVD, CD, magnetofon) për të pasuruar portofolin e vet;<br>- ndan njohuritë e veta me të tjerët.</td>
<td>Fjalë kyçe:<br>- balet;<br>- balerin;<br>- koreograf.</td>
</tr>
<tr>
<td>Burimet:<br>- teksti i nxënësit;<br>- materiale të përgatitura nga mësuesi/ja, me fragmente muzikore nga balete të ndryshme;<br>- fletorja e nxënësit;<br>- CD/DVD.</td>
<td>Lidhja me fushat e tjera:<br>- gjuha dhe komunikimi: letërsia.</td>
</tr>
<tr>
<td colspan="2">Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve</td>
</tr>
<tr>
<td colspan="2">● Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve<br>Mësimi fillon me një veprimtari konkrete, ku mësuesi/ja vendos në CD ose DVD disa fragmente nga kërcime të ndryshme dhe një fragment të shkëputur nga muzika e baletit “Halili dhe Hajria”, T. Daija. Çfarë emocionesh përjeton kur shikon apo dhe dëgjon muzikën e këtij baleti? Nxënësit/et diskutojnë rreth karakteristikave të kërcimeve shqiptare dhe baletit shqiptar.</td>
</tr>
<tr>
<td colspan="2">● Ndërtimi i njohurive të reja<br>Veprimtaria mësimore vazhdon më tej, ku mësuesi/ja bën:<br>- shpjegimin mbi lindjen dhe krijimin e baletit shqiptar:<br>- shpjegimin e veprave dhe përfaqësuesve të baletit shqiptar;<br>- nxitjen e nxënësve/eve për të bërë krahasimin e mënyrave të kërcimit/baletit shqiptar dhe një baleti të huaj;<br>- nxitjen për grumbullimin e fragmenteve nga balete të ndryshme nga youtube apo interneti, për të pasuruar portofolin e tyre.</td>
</tr>
</table>

● ***Vlerësimi***
Vlerësimi i nxënësit/es do të bëhet për *demonstrimin e rezultateve të arritura në:*
- identifikimin e një pjese baleti nga një kërcim tjetër;
- përshkrimin e një baleti dhe biografisë së një koreografi;
- grumbullimin dhe krijimin e një CD /DVD-je me fragmente nga balete të ndryshme;
- bashkëpunimin në grup për realizimin e detyrave.

● **Detyra: Zhvillo** një miniprojekt me temë "Baleti shqiptar dhe kërcimi im i parapëlqyer". Kërko informacion mbi baletet shqiptare dhe të huaja nga burime të ndryshme.
● **Përshkruaj** emocionet që ndien kur shikon një kërcim, p.sh.: një vals.

**Portofoli i nxënësit/es:**
Punimet e zhvilluara nga nxënësit/et, ruhen në dosjet e tyre personale.

***Shënime specifike:***

______________________________________________________________________
______________________________________________________________________
______________________________________________________________________
______________________________________________________________________
______________________________________________________________________
______________________________________________________________________
______________________________________________________________________
______________________________________________________________________
______________________________________________________________________
______________________________________________________________________
______________________________________________________________________
______________________________________________________________________
______________________________________________________________________
______________________________________________________________________


Baleti "Halili dhe Hajria"


Baleti "Cuca e maleve"

# VERIFIKOJMË NJOHURITË MUZIKORE

# TEST

**1. Shkruaj** ***pesë tituj këngësh polifonike nga krahina të ndryshme të Shqipërisë së Jugut.***

1. ______________________________
2. ______________________________
3. ______________________________
4. ______________________________
5. ______________________________



**2. Plotëso** fjalitë e mëposhtme.

- *Instrumentet muzikore popullore i ndajmë në dy grupe:*

**1.** ____________________ **2.** ____________________

- *Përmend dy instrumente muzikore që përbëjnë orkestrinat e Shkodrës:* ____________________; ____________________.
- *Grupimet me instrumente të ndryshme quhen ndryshe grupime* ____________________.
- *Grupimet me instrumente të njëjta quhen ndryshe grupime* ____________________.
- *Muzika instrumentale shqiptare filloi të zhvillohej rreth viteve* ____________________.
- *Koncerti i parë për violinë u kompozua nga kompozitori* ____________________.
- *Simfonia e parë shqiptare u kompozua nga kompozitori* ____________________.
- *Muzika për ansambël është muzikë që krijohet për disa* ____________________ *muzikore.*
- *Simfonia pasqyron një muzikë* ______________________________________________________________
- *Muzika vokale shqiptare u mbështet në* ______________________________________________________________.
- *Gjinitë e para vokale që u krijuan ishin* ____________________________________ ____________________.
- *Opereta e parë shqiptare quhet* ____________________ *dhe u kompozua nga kompozitori* ____________________.
- *Opera e parë shqiptare quhet* ____________________ *dhe u kompozua nga kompozitori* ____________________.

**3. Shkruaj** disa tituj këngësh të muzikës së kultivuar shqiptare.

1. ______________________________
2. ______________________________
3. ______________________________

**4. Dëgjo** fragmentet muzikore dhe shëno numrin në krah të titullit të këngës apo melodisë që dëgjon sipas renditjes.

- Opera “Mrika” ____________
- Koncerti për violinë Pjetër Gaci ____________
- Kënga “Për ty atdhe” ____________
- Simfonia nr. 1, Çesk Zadeja ____________

**5. Dëgjo** ***ose*** **shiko** ***fragmentet e shkëputura nga balete shqiptare dhe shëno numrin në krah të titullit të veprës që dëgjon/shikon sipas renditjes.***

- *Baleti “Bijtë e peshkatarit”* ______________________________
- *Baleti “Shqiponja sypatrembur”* ______________________________
- *Baleti “Delina”* ______________________________

**6. Plotëso** ***tabelën e mëposhtme.***

| | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | **O** | | | | **A** | | | | |
| | **K** | | | | | | **T** | | | |
| | | **A** | | | | | | | **L** | |
| | **S** | | | | | | | **A** | | |

1. Dramë muzikore, e cila përmbledh disa elemente si: subjekti letrar, muzika, skenografia, solistët, kori.
2. Vepër muzikore që luhet për solist dhe orkestër.
3. Gjini e vogël me karakter lirik, e cila luhet me 2, 3, 4, 5 ose dhe me 6, 7 instrumente.
4. Luhet me një numër të madh veglash (orkestër komplete).

| Fusha: Arte | Lënda: Muzikë | Shkalla: IV | Klasa: VIII |
|---|---|---|---|
| **Tematika:** Teknika dhe procese<br><br>**Projekt kurrikular:** "Muzika profesioniste shqiptare pas viteve '45" | | • ***Situata e të nxënit: Muzika përmes njohurive tona***<br>Nxënësve/eve u kërkohet të gjejnë nëpërmjet internetit materiale muzikore vokale, instrumentale dhe muzikë baleti. | |
| **Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:**<br>Nxënësi/ja:<br>- bashkëpunon me të tjerët për të vendosur se si do të realizohet në grup detyra e ngarkuar mbi muzikën profesioniste shqiptare pas viteve '45<br>- kërkon dhe hulumton nga burime të ndryshme informacioni;<br>- përzgjedh informacionin e mbledhur;<br>- përgatit punën e vet individualisht ose në grup;<br>- respekton mendimin e shokëve/shoqeve;<br>- përdor media (DVD, CD, magnetofon) për të paraqitur punën e vet. | | **Fjalë kyçe:**<br>- projekt;<br>- bashkëpunim;<br>- muzikë vokale;<br>- muzikë instrumentale;<br>- balet. | |
| **Burimet:**<br>- teksti i nxënësit;<br>- burime të ndryshme informacioni;<br>- paraqitje në ppt etj. | | **Lidhja me fushat e tjera:**<br>- shkencat shoqërore dhe mjedisi: historia dhe gjeografia;<br>- gjuha dhe komunikimi: letërsia.<br><br>**• Lidhja me temat ndërkurrikulare**<br>- të njohim kulturën e njëri-tjetrit. | |
| **Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve** | | | |

● ***Ndarja e grupeve dhe ndarja e detyrave***

Mësuesi/ja paraqet që në fillim temën: Muzika dhe të rinjtë. Më pas jep katër çështje, të cilat do të zhvillohen nga nxënësit/et në grupe të veçanta, ku secili prej nxënësve/eve mund të zhvillojë aftësitë më të mira që ka:

**Grupi i kërkimit kërkon informacion nga burime ndryshme mbi:**

1. zhvillimin e muzikës profesioniste shqiptare, kompozitorët dhe veprat e tyre;
2. institucionet ku u zhvillua kjo muzikë.



*Liceu artistik "Jordan Misja"*

**Grupi i jetëshkrimeve kërkon informacion nga burime ndryshme mbi:**
1. jetën e kompozitorëve shqiptarë që krijuan dhe zhvilluan këtë lloj muzike;
2. veprat muzikore të këtyre kompozitorëve.


*Çesk Zadeja*

● **Grupi i mbledhjes së veprave muzikore kërkon informacion nga burime ndryshme mbi:**
1. vepra të ndryshme profesioniste muzikore vokale dhe instrumentale: simfoni, koncerte, muzikë baleti, opera, suita, uvertura etj.



Grupet punojnë secili në mënyrë të pavarur, i zgjedhur vetë materialet dhe mjetet për të realizuar detyrën e ngarkuar.
Ato i paraqesin produktet e realizuara në fund të tremujorit.
Nxënësit/et e vlerësojnë vetë punën e arritur nga secili grup.

● ***Paraqitja dhe demonstrimi i rezultateve të arritura***

Nxënësit/et:
- punojnë në grup;
- respektojnë mendimin e njëri-tjetrit gjatë punës;
- zhvillojnë detyrën sipas tematikës së caktuar dhe e paraqesin atë.
- ***Detyrë:*** Krijimet e nxënësve/eve ruhen në dosjet e tyre.

● ***Vlerësimi***

Vlerësimi i nxënësit/es do të kryhet për pjesëmarrjen në mënyrë aktive gjatë krijimit muzikor dhe çështje të tjera lidhur me projektin.





# *Planifikimi i periudhës së tretë: Prill - Qershor*

| **Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe** |
|---|
| **Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit**<br>**Nxënësi/ja:**<br>- zhvillon personalitetin e vet dhe është aktiv në veprimtaritë artistike;<br>- gjykon drejt mesazhin artistik;<br>- shprehet nëpërmjet një komunikimi të qartë dhe saktë me anë të gjuhëve, simboleve, shenjave dhe formave muzikore;<br>- shfrytëzon mjetet artistike dhe mundësitë e komunikimit dhe të të shprehurit në muzikë në mënyrë të pavarur, të vazhdueshme, kritike dhe krijuese.<br>**Kompetenca e të menduarit**<br>**Nxënësi/ja:**<br>- përpunon njohuritë muzikore në mënyrë të pavarur, krijuese dhe me përgjegjësi;<br>- zgjidh probleme të ndryshme muzikore/artistike;<br>- zhvillon aftësitë për të menduar në mënyrë kritike, krijuese dhe ndërvepruese;<br>- ndjek udhëzimet për të realizuar një krijim apo veprimtari muzikore artistike.<br><br>**Kompetenca e të mësuarit për të nxënë**<br>**Nxënësi/ja:**<br>- vendos mjetet në funksion të realizimit të krijimit muzikor;<br>- përdor burime të ndryshme informacioni për të realizuar një krijim muzikor;<br>- krijon në mënyrë të pavarur detyrën e dhënë.<br><br>**Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin**<br>**Nxënësi/ja:**<br>- merr përsipër ose drejton aktivitetet muzikore brenda dhe jashtë klasës, duke kontribuar në mënyrë krijuese.<br><br>**Kompetenca personale**<br>**Nxënësi/ja:**<br>- krijon besimin te vetja gjatë veprimtarive muzikore;<br>- merr pjesë në mënyrë aktive në jetën artistike shkollore dhe komunitet;<br>- ndërgjegjëson veten dhe zhvillon vetëbesimin dhe krijimin e besimit tek të tjerët.<br><br>**Kompetenca qytetare**<br>**Nxënësi/ja:**<br>- bashkëpunon me të tjerët për çështje të ndryshme kulturore;<br>- respekton punën e të tjerëve;<br>- bashkëpunon me të tjerët pavarësisht kulturës, aftësive dhe nevojave brenda dhe jashtë shkollës për një qëllim të përbashkët.<br><br>**Kompetenca digjitale**<br>**Nxënësi/ja:**<br>- shkëmben informacion si dhe bashkëpunon në rrjetet informuese në internet;<br>- Përdor njeh mjetet e ndryshme në funksion të informacionit muzikor si: magnetofon, audio, video, CD, DVD etj. |

| Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të lëndës | | |
|---|---|---|
| **Krijimi muzikor** | **Performimi/interpretimi muzikor** | **Vlerësimi muzikor** |
| **Nxënësi/ja:**<br>• ndërton dhe këndon shkallë me një shenjë në armatur;<br>• demonstron kuptimin e ndërtimit të tyre;<br>• demonstron kuptimin e tonaliteteve nga pjesë të ndryshme muzikore duke dhënë mendimin e vet. | **Nxënësi/ja:**<br>• këndon duke respektuar kohët dhe simbolikat e mësuara;<br>• këndon ushtrime në kohët e mësuara;<br>• këndon duke respektuar teknikën e këndimit përmes rregullave të përcaktuara;<br>• interpreton këngët me ndjenjë dhe emocion;<br>• interpreton me zë ose fishkëllimë motivet nga këngë apo melodi popullore;<br>• përdor media (DVD, CD, magnetofon) për të prezantuar punën e vet mbi një muzikë popullore, periudhë historike, biografi të një kompozitori ose mbi një vepër muzikore shqiptare apo të huaj;<br>• ndan përvojën e vet me të tjerët;<br>• performon/interpreton këngët në organizimet e klasës apo të shkollës. | **Nxënësi/ja:**<br>• reflekton emocionet që i krijon një vepër muzikore gjatë kohës që interpretohet/luhet;<br>• përdor një gjuhë të qartë dhe të thjeshtë muzikore gjatë përjetimit emocional të muzikës së filmave që dëgjon;<br>• përdor një fjalor të thjeshtë muzikor;<br>• respekton pjesë muzikore të kulturave të tjera;<br>merr pjesë në aktivitete të ndryshme brenda dhe jashtë shkollës. |

| Nr. | Tematika | Temat mësimore | Situata e parashikuar e të nxënit | Burimet |
|---|---|---|---|---|
| 1 | Gjuha dhe komunikimi (GJ&K) | Shkalla muzikore Sol Maxhore | **Situata e të nxënit: Loja e radhitjes së notave**<br>8 nxënës/e mbajnë në duar nga një fletë A4 të shkruar me ngjyrë notën përkatëse, vendosen sipas vendodhjes së notës në pentagramin e vizatuar në dyshemenë e klasës, ku secili/a lexon notën që mban në dorë: ***Sol, la, si, do,re, mi, fa#, sol.*** Gjithashtu dëgjohen meloditë e vendosura | Teksti i nxënësit; materiale të ndryshme të parapërgatitura nga mësuesi/ja; këndimi i shkallës Sol + në ngjitje dhe zbritje në CD. |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | | | në CD dhe nxënësi/ja përshkruan ndryshimet që arrin të dalloj mes tyre. | |
| 2 | Gjuha dhe komunikimi (GJ&K) | Shkalla muzikore Mi minore | **Situata e të nxënit: Loja e radhitjes së notave**<br>8 nxënës/e mbajnë në duar nga një fletë A4 të shkruar me ngjyrë notën përkatëse, vendosen sipas vendodhjes së notës në pentagramin e vizatuar në dyshemenë e klasës, ku secili/a lexon notën që mban në dorë: ***Mi, fa#, sol, la, si, do, re, mi.*** | Teksti i nxënësit;<br>materiale të ndryshme të parapërgatitura nga mësuesi/ja;<br>këndimi i shkallës Mi - në ngjitje dhe zbritje në CD. |
| 3 | Teknika dhe procese (T&P) | Këndojmë në gjuhë të huaj | **Situata e të nxënit: Të ngjashëm dhe të ndryshëm**<br>Shkruhet në tabela fjala *"Të ngjashëm dhe të ndryshëm"* dhe u kërkohet nxënësve/eve të japin opinionin e tyre në lidhje me:<br>- respektimin e të drejtave të njeriut;<br>- njohjen dhe respektimin e kulturave.<br>Më pas vendosen këngët dhe nxënësit/et përshkruajnë dallimet në *ritëm, tekst* dhe *melodi* ndërmjet dy këngëve. | Teksti i nxënësit;<br>materiale të përgatitura nga mësuesi/ja;<br>materiale nga interneti rreth temës;<br>kënga në CD. |
| 4 | Gjuha dhe komunikimi (GJ&K) | Shkalla muzikore Fa Maxhore | **Situata e të nxënit: Loja e radhitjes së notave**<br>8 nxënës/e mbajnë në duar nga një fletë A4 të shkruar me ngjyrë notën përkatëse, vendosen sipas vendodhjes së notës në pentagramin e vizatuar në dyshemenë e klasës, ku secili/a lexon notën që mban në dorë: ***Fa, sol, la, si b, do, re, mi, fa.*** | Teksti i nxënësit;<br>materiale të ndryshme të parapërgatitura nga mësuesi/ja;<br>këndimi i shkallës Fa + në ngjitje dhe zbritje në CD. |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| 5 | Gjuha dhe komunikimi (GJ&K) | Shkalla muzikore Re minore | **Situata e të nxënit: Loja e radhitjes së notave**<br>8 nxënës/e mbajnë në duar nga një fletë A4 të shkruar me ngjyrë notën përkatëse, vendosen sipas vendodhjes së notës në pentagramin e vizatuar në dyshemenë e klasës, ku secili/a lexon notën që mban në dorë: ***Re, mi, fa, sol, la, sib, do, re.*** | Teksti i nxënësit;<br>materiale të ndryshme të parapërgatitura nga mësuesi/ja;<br>këndimi i shkallës Re - në ngjitje dhe zbritje në CD. |
| 6 | Gjuha dhe komunikimi (GJ&K) | Ushtrime këndimi në Sol+ dhe Fa+ | **Situata e të nxënit: Provojmë veten**<br>Zhvillohet një konkurs për leximin dhe këndimin më të mirë të shembujve muzikorë nga ana ritmike dhe melodike.<br>Përzgjidhet grupi më i mirë. | Teksti i nxënësit;<br>fletorja nxënësit;<br>ushtrime të ndryshme të parapërgatitura nga mësuesi/ja. |
| 7 | Teknika dhe procese (T&P) | "Jam i lashtë se jam shqiptar" | **Situata e të nxënit: Mbretëresha ilire Teutë**<br>Shkruhet në tabela emri i mbretëreshës Teutë, e cila zëvendësoi pas vdekjes mbretin Agron dhe u kërkohet nxënësve/eve të japin të dhëna dhe fakte për:<br>- *lashtësinë e popullit shqiptar;*<br>- tiparet e Teutës si udhëheqëse.<br>Diskutohet rreth informacionit që nxënësit/et kanë nga lëndët e tjera dhe lexohet teksti i këngës, i cili shpreh qartë krenarinë e historisë dhe kulturës së lashtë të shqiptarëve. | Teksti i nxënësit;<br>materiale të përgatitura nga mësuesi/ja;<br>materiale nga interneti ose burime të tjera rreth temës;<br>kënga në CD. |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| 8 | Historia, muzika dhe shoqëria (H,M&SH) | Muzika e filmit | **Situata e të nxënit: Filmi im i preferuar**<br>Vendosen në CD/dVD disa fragmente muzikore të shkëputura nga filmat shqiptarë. Shkruhet në dërrasë “Filmi im i preferuar” duke nxitur nxënësit/et të flasin rreth filmit shqiptar të preferuar dhe të shpjegojnë arsyen pse e pëlqejnë atë duke sjellë 3 cilësi. | Teksti i nxënësit; materiale të përgatitura nga mësuesi/ja; materiale muzikore në CD. |
| 9 | Historia, muzika dhe shoqëria (H,M&SH) Historia, muzika dhe shoqëria (H,M&SH) | Kolona zanore nga filma të ndryshëm – dëgjim | **Situata e të nxënit: Kolona zanore ime e preferuar**<br>Mësimi fillon me një veprimtari konkrete ku mësuesi/ja vendos në CD kolona zanore të filmave shqiptarë dhe nxënësit/et diskututojnë rreth tyre. | Teksti i nxënësit; materiale të përgatitura nga mësuesi/ja; kolona zanore nga filma shqiptarë në CD. |
| 10 | Teknika dhe procese (T&P) | Verifikojmë njohuritë muzikore | **Situata e të nxënit: Test** | Teksti i nxënësit; test i përgatitur nga mësuesi/ja. |
| | **Projekt:** “Muzika dhe filmi” | | Nxënësve/eve u kërkohet të gjejnë nëpërmjet internetit materiale mbi muzikën e filmave të ndryshëm shqiptarë. | |

# *Planifikimi i periudhës së tretë: Prill – Qershor*

<table>
<tr><th>Fusha: Arte</th><th>Lënda: Muzikë</th><th>Shkalla: IV</th><th>Klasa VIII</th></tr>
<tr><td colspan="2">Tematika: Gjuha dhe komunikimi muzikor<br><br>Tema mësimore: Shkalla muzikore Sol Maxhore</td><td colspan="2">• Situata e të nxënit: Loja e radhitjes së notave<br>8 nxënës/e mbajnë në duar nga një fletë A4 të shkruar me ngjyrë notën përkatëse, vendosen sipas vendodhjes së notës në pentagramin e vizatuar në dyshemenë e klasës, ku secili/a lexon notën që mban në dorë: Sol, la, si, do,re, mi, fa#, sol. Gjithashtu dëgjohen melioditë e vendosura në CD dhe nxënësi/ja përshkruan ndryshimet që arrin të dalloj mes tyre.</td></tr>
<tr><td colspan="2">Rezultatet e të nxënit të kompetencave të lëndës sipas temës mësimore:<br>Nxënësi/ja:<br>- demonstron kuptimin e shkallës muzikore;<br>- ndërton shkallën Sol + në ngjitje dhe në zbritje;<br>- komunikon qartë njohuritë muzikore, mbi shkallën muzikore;<br>- këndon saktë nga ana intonacionit shkallën Sol + në ngjitje dhe zbritje;<br>- ndan përvojën e vet artistike me të tjerët.</td><td colspan="2">Fjalë kyçe:<br>- shkallë muzikore;<br>- shkalla Sol maxhore.</td></tr>
<tr><td colspan="2">Burimet:<br>- teksti i nxënësit;<br>- materiale të përgatitura nga mësuesi/ja;<br>- fletorja e nxënësit;<br>- shkalla Sol + në ngjitje dhe zbritje në CD.</td><td colspan="2">Lidhja me fushat e tjera:<br>- matematika .</td></tr>
<tr><td colspan="4">Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve</td></tr>
<tr><td colspan="4">● Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve<br>Mësimi fillon me një veprimtari konkrete ku mësuesi/ja përzgjedh 8 nxënës/e që mbajnë në duar nga një fletë A4 ku në secilën prej tyre shkruhet me ngjyrë notat: Sol, la, si, do,re, mi, fa#, sol. Ata/ato vendosen sipas vendodhjes së notës në pentagramin e vizatuar në dyshemenë e klasës, ku secili/a lexon notën që mban në dorë: Sol, la, si, do,re, mi, fa#, sol.</td></tr>
<tr><td colspan="4">● Ndërtimi i njohurive të reja<br>Ora mësimore vazhdon më tej, ku mësuesi/ja fillon:<br>- shpjegimin e shkallës Sol Maxhore, si i gjejmë shkallët maxhore me diezis dhe ndërtimin e saj në ngjitje dhe në zbritje, duke shpjeguar se shkalla është renditja<br>- graduale e 8 notave muzikore të vendosura njëra pas tjetrës, dhe ku secila prej tyre ka një lartësi të caktuar.<br>- Shpjegon pse gradi i shtatë i shkallës merr shenjen diezis;<br>- leximin e shkallës dhe këndimin e saj në ngjitje dhe në zbritje;<br>- këndimin vetëm dhe në grup të shkallës disa herë.</td></tr>
</table>

● ***Vlerësimi***

Vlerësimi i nxënësit/es do të bëhet për *demonstrimin e rezultateve të arritura në*:

- diskutimet që ata/ato bëjnë duke lidhur njohuritë e tyre mbi shkallën muzikore.
- ndërtimin e shkallës Sol + dhe kuptimin e saj.
- këndimin korrekt të shkallës në intonacion në ngjitje dhe në zbritje.
- bashkëpunimin dhe këndimin në grup të shkallës, bashkëpunimit në grup me të tjerët.

● **Detyra: Ndërto** në fletoren tënde shkallën Sol + në ngjitje dhe në zbritje.

**Portofoli i nxënësit/es:**

Punimet e zhvilluara nga nxënësit/et, ruhen në dosjet e tyre personale.

***Shënime specifike:***



<table>
<tr><th>Fusha: Arte</th><th>Lënda: Muzikë</th><th>Shkalla: IV</th><th>Klasa VIII</th></tr>
<tr><td colspan="2">Tematika: Gjuha dhe komunikimi muzikor<br><br>Tema mësimore: Shkalla muzikore Mi minore</td><td colspan="2">• Situata e të nxënit: Loja e radhitjes së notave<br>8 nxënës/e mbajnë në duar nga një fletë A4 të shkruar me ngjyrë notën përkatëse, vendosen sipas vendodhjes së notës në pentagramin e vizatuar në dyshemenë e klasës, ku secili/a lexon notën që mban në dorë: Mi, fa#, sol, la, si, do, re, mi.</td></tr>
<tr><td colspan="2">Rezultatet e të nxënit të kompetencave të lëndës sipas temës mësimore:<br>Nxënësi/ja:<br>- demonstron kuptimin e shkallës muzikore;<br>- ndërton shkallën Mi - në ngjitje dhe në zbritje;<br>- komunikon qartë njohuritë muzikore, mbi shkallën muzikore;<br>- këndon saktë nga ana intonacionit shkallën Mi - në ngjitje dhe zbritje;<br>- ndan përvojën e vet artistike me të tjerët.</td><td colspan="2">Fjalë kyçe:<br>- shkallë muzikore;<br>- shkalla Mi minore.</td></tr>
<tr><td colspan="2">Burimet:<br>- teksti i nxënësit/es;<br>- materiale të përgatitura nga mësuesi/ja;<br>- fletorja e nxënësit;<br>- shkalla Mi - në ngjitje dhe zbritje në CD.</td><td colspan="2">Lidhja me fushat e tjera:<br>- matematika.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve</td></tr>
<tr><td colspan="4">● Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve<br>Mësimi fillon me një veprimtari konkrete ku mësuesi/ja përzgjedh 8 nxënës/e që mbajnë në duar nga një fletë A4 ku në secilën prej tyre shkruhet me ngjyrë notat: Mi, fa#, sol, la, si, do, re, mi. Ata/ato vendosen sipas vendodhjes së notës në pentagramin e vizatuar në dyshemenë e klasës, ku secili/a lexon notën që mban në dorë: Mi, fa#, sol, la, si, do, re, mi.</td></tr>
<tr><td colspan="4">● Ndërtimi i njohurive të reja<br>Ora mësimore vazhdon më tej, ku mësuesi/ja fillon:<br>- shpjegimin e shkallës Mi minore dhe ndërtimin e saj në ngjitje dhe në zbritje, duke shpjeguar se kjo shkallë është relativja e shkallës Sol Maxhore, renditja graduale e 8 notave muzikore të vendosura njëra pas tjetrës, dhe ku secila prej tyre ka një lartësi të caktuar;<br>- leximin e shkallës dhe këndimin e saj në ngjitje dhe në zbritje;<br>- Këndimin vetëm dhe në grup të shkallës disa herë.</td></tr>
</table>

● ***Vlerësimi***

Vlerësimi i nxënësit/es do të bëhet për *demonstrimin e rezultateve të arritura në:*

- diskutimet që ata/ato bëjnë duke lidhur njohuritë e tyre mbi shkallën muzikore.
- ndërtimin e shkallës Mi minore dhe kuptimin e saj.
- këndimin korrekt të shkallës në intonacion në ngjitje dhe në zbritje.
- bashkëpunimin dhe këndimin në grup të shkallës, bashkëpunimit në grup me të tjerët.

● **Detyra: Ndërto** në fletoren tënde shkallën Mi minore në ngjitje dhe në zbritje.

**Portofoli i nxënësit/es:**

Punimet e zhvilluara nga nxënësit/et, ruhen në dosjet e tyre personale.

***Shënime specifike:***



| Fusha: Arte | Lënda: Muzikë | Shkalla: IV | Klasa VIII |
|---|---|---|---|

**Tematika:** Teknika dhe procese

**Tema mësimore: “**Këndojmë në gjuhë të huaj”

• ***Situata e të nxënit: Të ngjashëm dhe të ndryshëm***

Shkruhet në tabelë fjala *“Të ngjashëm dhe të ndryshëm”* dhe u kërkohet nxënësve/eve të japin opinionet e tyre në lidhje me:

- respektimin e të drejtave të njeriut;
- njohjen dhe respektimin e kulturave.

Më pas vendosen këngët dhe nxënësit/et përshkruajnë dallimet në *ritëm, tekst* dhe *melodi* ndërmjet dy këngëve.

**Rezultatet e të nxënit të kompetencave të lëndës sipas temës mësimore:**

Nxënësi/ja:

- këndon duke respektuar teknikën e këndimit përmes rregullave të përcaktuara;
- interpreton këngët me ndjenjë dhe emocion;
- respekton interpretimin dhe performimin e shokëve;
- këndon duke respektuar karakteristikën e këngës në grup.

**Fjalë kyçe:**

- melodia e këngës;
- teksti i këngës;
- rregullat e këndimit.

**Burimet:**

- teksti i nxënësit;
- materiale të përgatitura nga mësuesi/ja, nga burime të ndryshme rreth temës;
- kënga në CD.

**Lidhja me fushat e tjera:**

- shoqëria dhe mjedisi: njohuri për shoqërinë, gjeografia, historia;
- gjuhët dhe komunikimi: letërsia.

**Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve**

● ***Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve***

Mësuesi/ja shkruan në tabelë fjalën *“Të ngjashëm dhe të ndryshëm”* dhe u kërkon nxënësve/eve të japin opinionin e tyre në lidhje me:

- respektimin e të drejtave të njeriut;
- njohjen dhe respektimin e kulturave.
- Më pas vendosen këngët dhe nxënësit/et përshkruajnë dallimet në *ritëm, tekst* dhe *melodi* ndërmjet tyre.

● ***Ndërtimi i njohurive të reja***

Vendoset në CD kënga *“Këndojmë në gjuhë të huaj”. (Mësuesi zgjedh njërën nga këngët për ta mësuar në klasë).*

- Nxiten nxënësit/et të diskutojnë nëse kënga do të ishte më e bukur dhe do të krijonte emocion vetëm përmes muzikës apo të dyjave së bashku?
- **Vendoset** përsëri kënga *“Këndojmë në gjuhë të huaj”* dhe **vazhdohet** puna me mësimin e saj sipas hapave të mëposhtëm:
- këndimi varg pas vargu,
- përsëritja e vargjeve herë pas here,

- këndimi i strofës,
- këndimi i strofës dhe refrenit,
- përsëritja e këngës nga fillimi në fund,
- interpretimi i këngës me ndjenjë dhe emocion,
- këndimi i këngës vetëm dhe në grup.

**Gjatë mësimit të këngës, tregohet** kujdes të respektohet *ritmi, intonacioni, interpretimi i* këngës.

- Kënga këndohet disa herë në intonacion dhe në ritëm, duke respektuar rregullat e këndimit, sidomos të këndimit në grup..

● ***Vlerësimi***

Vlerësimi i nxënësit/es do të bëhet për *demonstrimin e rezultateve të arritura në*:

- diskutimin me njëri/a-tjetrin/ën rreth karakteristikave të shteteve përkatese të këngëve.
- këndimin duke interpretuar këngën me ndjenjë dhe emocion, sipas rregullave të këndimit në ritëm dhe intonacion.
- interpretimin e këngës me ndjenjë dhe emocion vetëm dhe në grup.

● **Detyra: Përshkruaj** talentet e shokëve e të shoqeve të tua të klasës.

**Portofoli i nxënësit/es:**

Punimet e zhvilluara nga nxënësit/et, ruhen në dosjet e tyre personale.

***Shënime specifike:***





| Fusha: Arte | Lënda: Muzikë | Shkalla: IV | Klasa VIII |
|---|---|---|---|

**Tematika:** Gjuha dhe komunikimi muzikor

**Tema mësimore:** Shkalla muzikore Fa Maxhore

• ***Situata e të nxënit: Loja e radhitjes së notave***

8 nxënës/e mbajnë në duar nga një fletë A4 të shkruar me ngjyrë notën përkatëse, vendosen sipas vendodhjes së notës në pentagramin e vizatuar në dyshemenë e klasës, ku secili/a lexon notën që mban në dorë: ***Fa, sol, la, sib, do, re, mi, fa.***

**Rezultatet e të nxënit të kompetencave të lëndës sipas temës mësimore:**

Nxënësi/ja:
- demonstron kuptimin e shkallës muzikore;
- ndërton shkallën Fa + në ngjitje dhe në zbritje;
- komunikon qartë njohuritë muzikore, mbi shkallën muzikore;
- këndon saktë nga ana intonacionit shkallën Fa + në ngjitje dhe zbritje;
- ndan përvojën e vet artistike me të tjerët.

**Fjalë kyçe:**
- shkallë muzikore;
- shkalla Fa Maxhore.

**Burimet:**
- teksti i nxënësit;
- materiale të përgatitura nga mësuesi;
- fletorja e nxënësit;
- shkalla Fa + në ngjitje dhe zbritje në CD.

**Lidhja me fushat e tjera:**
- matematika.

**Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve**

● ***Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve***

Mësimi fillon me një veprimtari konkrete ku mësuesi/ja përzgjedh 8 nxënës/e që mbajnë në duar nga një fletë A4 ku në secilën prej tyre shkruhet me ngjyrë notat: ***Fa, sol, la, si b, do, re, mi, fa.*** Ata/ato vendosen sipas vendodhjes së notës në pentagramin e vizatuar në dyshemenë e klasës, ku secili/a lexon notën që mban në dorë: ***Fa, sol, la, si b, do, re, mi, fa.***

● ***Ndërtimi i njohurive të reja***

Ora mësimore vazhdon më tej, ku mësuesi/ja fillon:
- shpjegimin e shkallës Fa maxhore, si i gjejmë shkallë maxhore me bemola dhe ndërtimin e saj në ngjitje dhe në zbritje, duke shpjeguar se shkalla është renditja graduale e 8 notave muzikore të vendosura njëra pas tjetrës, dhe ku secila prej tyre ka një lartësi të caktuar. Shpjegon pse nota Si zbret ½ toni duke u kthyer në Si bemol;
- leximin e shkallës dhe këndimin e saj në ngjitje dhe në zbritje;
- këndimin vetëm dhe në grup të shkallës disa herë.

● ***Vlerësimi***

Vlerësimi i nxënësit/es do të bëhet për *demonstrimin e rezultateve të arritura në:*
- diskutimet që ata/ato bëjnë duke lidhur njohuritë e tyre mbi shkallën muzikore;
- ndërtimin e shkallës Fa Maxhore dhe kuptimin e saj.
- këndimin korrekt të shkallës në intonacion në ngjitje dhe në zbritje.
- bashkëpunimin dhe këndimin në grup shkallës, bashkëpunimit në grup me të tjerët.

● **Detyra:** **Krijo** në fletoren tënde një ushtrim në ritmin 2/4, me 16 masa në tonalitetin Fa maxhor.

**Portofoli i nxënësit/es:**

Punimet e zhvilluara nga nxënësit/et, ruhen në dosjet e tyre personale.

***Shënime specifike:***



| Fusha: Arte | Lënda: Muzikë | Shkalla: IV | Klasa VIII |
|---|---|---|---|

**Tematika:** Gjuha dhe komunikimi muzikor

**Tema mësimore:** Shkalla muzikore Re minore

• ***Situata e të nxënit: Loja e radhitjes së notave***
8 nxënës/e mbajnë në duar nga një fletë A4 të shkruar me ngjyrë notën përkatëse, vendosen sipas vendodhjes së notës në pentagramin e vizatuar në dyshemenë e klasës, ku secili/a lexon notën që mban në dorë: ***Re, mi, fa, sol, la, sib, do, re.***

**Rezultatet e të nxënit të kompetencave të lëndës sipas temës mësimore:**

Nxënësi/ja:
- demonstron kuptimin e shkallës muzikore;
- ndërton shkallën Re minore në ngjitje dhe në zbritje;
- komunikon qartë njohuritë muzikore, mbi shkallën muzikore;
- këndon saktë nga ana intonacionit shkallën Re - në ngjitje dhe zbritje;
- ndan përvojën e vet artistike me të tjerët.

**Fjalë kyçe:**
- shkallë muzikore;
- shkalla Re minore.

**Burimet:**
- teksti i nxënësit;
- materiale të përgatitura nga mësuesi;
- fletorja e nxënësit;
- Shkalla Re - në ngjitje dhe zbritje në CD.

**Lidhja me fushat e tjera:**
- matematika.

**Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve**

● ***Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve***
Mësimi fillon me një veprimtari konkrete ku mësuesi/ja përzgjedh 8 nxënës/e mbajnë në duar nga një fletë A4 ku në secilën prej tyre shkruhet me ngjyrë notat: ***Re, mi, fa, sol, la, sib, do, re.*** Ata/Ato vendosen sipas vendodhjes së notës në pentagramin e vizatuar në dyshemenë e klasës, ku secili/a lexon notën që mban në dorë: ***Re, mi, fa, sol, la, sib, do, re.***

● ***Ndërtimi i njohurive të reja***
Ora mësimore vazhdon më tej, ku mësuesi/ja fillon:
- shpjegimin e shkallës Re minore dhe ndërtimin e saj në ngjitje dhe në zbritje, duke shpjeguar se shkalla Re minore është relativja e shkallës Fa Maxhore, renditja graduale e 8 notave muzikore të vendosura njëra pas tjetrës, dhe ku secila prej tyre ka një lartësi të caktuar;
- leximin e shkallës dhe këndimin e saj në ngjitje dhe në zbritje;
- këndimin vetëm dhe në grup të shkallës disa herë.

● ***Vlerësimi***
Vlerësimi i nxënësit/es do të bëhet për *demonstrimin e rezultateve të arritura në:*
- diskutimet që ata/ato bëjnë duke lidhur njohuritë e tyre mbi shkallën muzikore;
- ndërtimin e shkallës Re - dhe kuptimin e saj;
- këndimin korrekt të shkallës në intonacion në ngjitje dhe në zbritje.
- bashkëpunimin dhe këndimin në grup shkallës bashkëpunimit në grup me të tjerët.

● **Detyra:** **Krijo** në fletoren tënde një ushtrim në ritmin 2/4, me 16 masa në tonalitetin Re minor.

**Portofoli i nxënësit/es:**
Punimet e zhvilluara nga nxënësit/es, ruhen në dosjet e tyre personale.

***Shënime specifike:***



| Fusha: Arte | Lënda: Muzikë | Shkalla: IV | Klasa VIII |
|---|---|---|---|

**Tematika:** Gjuha dhe komunikimi muzikor

**Tema mësimore:** Ushtrime këndimi në Sol + dhe Fa +

• ***Situata e të nxënit: Provojmë veten***
Zhvillohet një konkurs për leximin dhe këndimin më të mirë të shembujve muzikorë nga ana ritmike dhe melodike.
Përzgjidhet grupi më i mirë.

**Rezultatet e të nxënit të kompetencave të lëndës sipas temës mësimore:**

Nxënësi/ja:
- lexon ushtrime ritmike në shkallët maxhore dhe minore të mësuara;
- këndon ushtrime apo melodi në tonalitete të ndryshme muzikore;
- demonstron aftësi të mira ritmike dhe melodike;
- punon vetëm ose në grup me të tjerët.

**Fjalë kyçe:**
- tonalitet;
- shenjë shartimi.

**Burimet:**
- teksti i nxënësit;
- materiale të përgatitura nga mësuesi/ja;
- fletorja e nxënësit.

**Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve**

● ***Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve***
Mësimi fillon duke zhvilluar një konkurs për leximin dhe këndimin më të mirë të shembujve muzikorë që gjenden në tekstin e nxënësit nga ana ritmike dhe melodike. Nxënësit/et gjykojnë njëri/a-tjetrin/ën duke vlerësuar aftësitë dhe arritjet më të mira të grupit që konkuron.

● ***Ndërtimi i njohurive të reja***
Ora mësimore vazhdon më tej, ku mësuesi/ja fillon:
- Ndarjen e klasës në tri grupe për leximin dhe këndimin e shembujve muzikorë;
- përcaktimin së bashku *mësuesi/ja dhe nxënësit/et* të kritereve dhe rezultatet që duhet të arrijë çdo grup në tri nivele *N2-N3-N4;*
- dëgjimin e çdo grupi dhe gjykimin e tyre;
- diskutimin dhe vlerësimin sipas kritereve të vendosura dhe rezultateteve të arritura nga secili grup;
- shpalljen e grupit më të mirë.

● **Vlerësimi**
Vlerësimi i nxënësit/es do të bëhet për demonstrimin e rezultateve të arritura në:
- leximin e ushtrimeve ritmike në shkallët maxhore dhe minore të mësuara;
- këndimin e ushtrimeve apo melodive në shkallët maxhore dhe minore të mësuara;
- demonstrimin e aftësive të mira ritmike dhe melodike;
- komunikimin e qartë të njohurive muzikore, mbi shkallët muzikore me 1 shenjë shartimi dhe përdorimit të tyre në muzikë;
- bashkëpunimin në grup me të tjerët.

| Fusha: Arte | Lënda: Muzikë | Shkalla: IV | Klasa VIII |
|---|---|---|---|

**Tematika:** Teknika dhe procese

**Tema mësimore:** **“**Jam i lashtë se jam shqiptar”

***• Situata e të nxënit: Mbretëresha ilire Teutë***

Shkruhet në tabela emri i mbretëreshës Teutë, e cila zëvendësoi pas vdekjes mbretin Agron dhe u kërkohet nxënësve/eve të thonë të dhëna dhe fakte për:

- *lashtësinë e popullit shqiptar;*
- tiparet e Teutës si udhëheqëse.

Diskutohet rreth informacionit që nxënësit/et kanë nga lëndët e tjera dhe lexohet teksti i këngës i cili shpreh qartë krenarinë e historisë dhe kulturës së lashtë të shqiptarëve.

**Rezultatet e të nxënit të kompetencave të lëndës sipas temës mësimore:**

Nxënësi/ja:
- këndon duke respektuar teknikën e këndimit përmes rregullave të përcaktuara;
- interpreton këngët me ndjenjë dhe emocion;
- respekton interpretimin dhe performimin e shokëve;
- këndon duke respektuar karakteristikën e këngës në grup.

**Fjalë kyçe:**
- melodia e këngës;
- teksti i këngës;
- rregullat e këndimit.

**Burimet:**
- teksti i nxënësit;
- materiale të përgatitura nga mësuesi/ja, nga burime të ndryshme rreth temës;
- kënga në CD.

**Lidhja me fushat e tjera:**
- shoqëria dhe mjedisi: njohuri për shoqërinë, gjeografia, historia;
- gjuhët dhe komunikimi: letërsia.
- Lidhja me temat ndërkurrikulare
- trashëgimia kulturore.

**Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve**

● ***Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve***

Mësuesi/ja shkruan në tabelë emrin e mbretëreshës Teutë, e cila zëvendësoi pas vdekjes mbretin Agron dhe u kërkohet nxënësve/eve të thonë të dhëna dhe fakte për:
- lashtësinë e popullit shqiptar;
- tiparet e Teutës si udhëheqëse.

Diskutohet rreth informacionit që nxënësit/et kanë nga lëndët e tjera dhe lexohet teksti i këngës, i cili shpreh qartë krenarinë e historisë dhe kulturës së lashtë të shqiptarëve.

● **Ndërtimi i njohurive të reja**

Vendoset në CD kënga “Jam i lashtë se jam shqiptar”.
- Nxënësit/et nxiten të diskutojnë nëse kënga do të ishte më e bukur dhe do të krijonte emocion vetëm përmes muzikës apo të dyjave së bashku?

**Vendoset** përsëri kënga “Jam i lashtë se jam shqiptar” dhe **vazhdohet** puna me mësimin e saj sipas hapave të mëposhtëm:
- këndimi varg pas vargu,

- përsëritja e vargjeve herë pas here,
- këndimi i strofës,
- këndimi i strofës dhe refrenit,
- përsëritja e këngës nga fillimi në fund,
- interpretimi i këngës me ndjenjë dhe emocion,
- këndimi i këngës vetëm dhe në grup.

● **Gjatë mësimit të këngës, tregohet** kujdes të respektohet *ritmi, intonacioni, interpretimi i* këngës.

Kënga këndohet disa herë në intonacion dhe në ritëm, duke respektuar rregullat e këndimit, sidomos të këndimit në grup.

● ***Vlerësimi***

Vlerësimi i nxënësit/es do të bëhet për *demonstrimin e rezultateve të arritura në*:
- diskutimin me njëri/a-tjetrin/ën rreth karakteristikave të qytetit dhe krahinës së tyre.
- këndimin duke interpretuar këngën me ndjenjë dhe emocion, sipas rregullave të këndimit në ritëm dhe intonacion.
- interpretimin e këngës me ndjenjë dhe emocion vetëm dhe në grup.

● **Detyra: Kërko** të dhëna në internet për periudhën e mbretërimit të mbretëreshës Teutë dhe mbretit Gent. Pse të bën krenar prejardhja jote shqiptare?

**Portofoli i nxënësit/es:**

Punimet e zhvilluara nga nxënësit/et, ruhen në dosjet e tyre personale.

***Shënime specifike:***



*Isa Boletini me trima - Zef Shoshi*

| Fusha: Arte | Lënda: Muzikë | Shkalla: IV | Klasa VIII |
|---|---|---|---|

**Tematika:** Historia, muzika dhe shoqëria

**Tema mësimore:** "Muzika e filmit"

**• *Situata e të nxënit: Filmi im i preferuar***

Vendosen në CD/DVD disa fragmente muzikore të shkëputura nga filmat shqiptarë. Shkruhet në dërrasë "Filmi im i preferuar", duke nxitur nxënësit/et të flasin rreth filmit shqiptar të preferuar dhe të tregojnë arsyen pse e pëlqejnë atë duke sjellë 3 cilësi.

**Rezultatet e të nxënit të kompetencave të lëndës sipas temës mësimore:**

Nxënësi/ja:
- flet mbi muzikën e filmit shqiptar dhe kompozitorët që krijuan për filmin;
- diskuton për *muzikën e filmit shqiptar;*
- ndan njohuritë e veta me të tjerët.

**Fjalë kyçe:**
- muzika e filmit;
- mjetet e komunikimit;
- kolonë zanore.

**Burimet:**
- teksti i nxënësit;
- materiale të përgatitura nga mësuesi/ja, me fragmente muzikore nga filma shqiptarë;
- fletorja e nxënësit;
- CD/DVD.

**Lidhja me fushat e tjera:**
- gjuha dhe komunikimi: letërsia.

**Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve**

**● *Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve***

Mësimi fillon me një veprimtari konkrete ku mësuesi/ja vendos në CD/DVD disa fragmente muzikore të shkëputura nga filmat shqiptarë. Shkruhet në dërrasë "Filmi im i preferuar", duke nxitur nxënësit/et të flasin rreth filmit shqiptar të preferuar dhe të tregojnë pse e pëlqejnë atë duke sjellë 3 cilësi.

**● *Ndërtimi i njohurive të reja***

Veprimtaria mësimore vazhdon më tej, ku mësuesi/ja bën:
- shpjegimin mbi muzikën e filmit shqiptar, lindjen dhe zhvillimin e saj:
- shpjegimin e veprave dhe biografisë së kompozitorëve, që kompozuan për filmin shqiptar;
- nxitjen e nxënësve/eve për diskutimin e muzikës së filmit të preferuar.

**● *Vlerësimi***

Vlerësimi i nxënësit/es do të bëhet për *demonstrimin e rezultateve të arritura në:*
- përshkrimin e krijimit të muzikës së filmit, dhe biografinë e kompozitorëve që krijuan për këtë lloj muzike në Shqipëri;
- evidentimin e muzikës së filmit që pëlqejnë më shumë duke shpjeguar pse u pëlqen;
- gjetjen dhe krijimin e një CD-je me muzikë nga filmat shqiptarë, duke krijuar portofolin e vet;
- bashkëpunimin në grup për realizimin e detyrave.

● **Detyra: Mblidh** informacion rreth historikut të krijimit të filmit shqiptar.

**Portofoli i nxënësit/es:** Punimet e zhvilluara nga nxënësit/et, ruhen në dosjet e tyre personale.

***Shënime specifike:***



| Fusha: Arte | Lënda: Muzikë | Shkalla: IV | Klasa VIII |
|---|---|---|---|

**Tematika:** Historia, muzika dhe shoqëria

**Tema mësimore:** “Kolona zanore nga filma të ndryshëm – dëgjim”

• ***Situata e të nxënit: Kolona zanore ime e preferuar***

Mësimi fillon me një veprimtari konkrete ku mësuesi/ja vendos në CD kolona zanore të filmave shqiptarë dhe nxënësit/et diskututojnë rreth tyre.

**Rezultatet e të nxënit të kompetencave të lëndës sipas temës mësimore:**

Nxënësi/ja:

- dëgjon dhe identifikon kolonën zanore të filmave shqiptarë;
- evidenton karakteristikat e muzikës së filmit;
- diskuton për muzikën e filmit shqiptar;
- përdor media (DVD, CD, magnetofon) për të prezantuar punën e vet;
- ndan njohuritë e veta me të tjerët.

**Fjalë kyçe:**

- kolonë zanore.

**Burimet:**

- teksti i nxënësit;
- materiale të përgatitura nga mësuesi/ja, me
- fragmente me muzikë nga filmat shqiptarë;
- fletorja e nxënësit;
- CD/DVD.

**Lidhja me fushat e tjera:**

- letërsia;
- gjeografia.

**Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve**

● ***Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve***

Mësimi fillon me një veprimtari konkrete ku mësuesi/ja vendos në CD kolona zanore të filmave shqiptarë dhe nxënësit/et diskututojnë rreth tyre.

● ***Ndërtimi i njohurive të reja***

Veprimtaria mësimore vazhdon më tej, ku mësuesi/ja bën:

- orientimin e nxënësve/eve për dëgjimin e kolonave zanore nga filma të ndryshëm shqiptarë;
- nxitjen e nxënësve/eve për të diskutuar për karakteristikat dhe ndryshueshmërinë e kolonave zanore nga një film tek tjetri;
- nxitjen për grumbullimin e shembujve muzikorë nga filmat shqiptarë nga *youtube* apo *interneti,* duke krijuar portofolin e tyre.

● ***Vlerësimi***

Vlerësimi i nxënësit/es do të bëhet për *demonstrimin e rezultateve të arritura në:*

- identifikimin e kolonave zanore të filmave shqiptarë;
- diskutimin rreth kolonave zanore të filmave;
- kërkimin dhe mbledhjen e të dhënave mbi zhvillimin e muzikës së filmit dhe prezantimin e tyre në klasë;
- gjetjen e kolonave zanore nga filmat shqiptarë dhe krijimin e një albumi CD ose DVD duke ia bashkëngjitur portofolit të vet;
- bashkëpunimin në grup për realizimin e detyrave.

● **Detyra: Krijo** një album me foto nga filmat e tu shqiptarë të parapëlqyer.
**Krijo** një CD me fragmente muzikore të shkëputura nga filmat shqiptarë.

**Portofoli i nxënësit/es:**
Punimet e zhvilluara nga nxënësit/et, ruhen në dosjet e tyre personale.

***Shënime specifike:***



Filmi "Tomka dhe shokët e tij"



Filmi "Skëndërbeu"



Filmi "Nëntori i dytë"

# VERIFIKOJMË NJOHURITË MUZIKORE

# TEST

**1. Rretho** përgjigjen e saktë.

• Në shkallën **Sol+** gjysmëtonet ndodhen në gradët:

a) 2-3 dhe 5-6; b) 4-5 dhe 6-7; c) 3-4 dhe 7-8.

• Në shkallën **Mi -** gjysmëtonet ndodhen në gradët:

a) 2-3 dhe 5-6; b) 4-5 dhe 6-7; c) 3-4 dhe 7-8;



**2. Plotëso** vendet bosh në fjalitë e mëposhtme:

- Për të gjetur shkallën ***Mi minore*** zbresim ____________________ nga grada e ____________________ e shkallës ____________________.
- Shkallët maxhore me bemola i gjejmë duke ____________________ ____________________.
- Gjysmëtonet në shkallën ***Fa Maxhore*** gjenden në gradët ____________________.
- Gradët që formojnë ***akordin*** dhe ***arpezhin*** e shkallës *Fa Maxhore* janë: ____________________.
- Gjysmëtonet në shkallën ***Re minore*** gjenden në gradët: ____________________.
- Gradët që formojnë ***akordin*** dhe ***arpezhin*** e shkallës *Re minore* janë: ____________________.

**3. Ndërto** shkallët **Sol Maxhore** dhe **Mi minore**, **Fa Maxhore** dhe **Re minore**.





**4. Ndërto** një ushtrim me 8 masa në tonalitetin **Sol Maxhor** ose **Fa maxhor**.



**5. Lidh** ***me shigjetë*** *titullin e filmit* ***me emrin e*** *kompozitorit.*



***TITUJT E FILMAVE:***

*"Tana"*
*"I teti në bronz"*
*"Lulëkuqet mbi mure"*
*"Liri a vdekje"*
*"Nëntori i dytë"*
*"Yjet e netëve të gjata"*
*"Tomka dhe shokët e tij"*
*"Gjeneral gramafoni"*
*"Dimri i fundit"*
*"Tinguj lufte"*
*"Debatik"*
*"Fije që priten"*
*"Beni ecën vetë"*
*"Koncert në vitin 1936"*
*"Mësonjëtorja"*
*"Ngadhnjim mbi vdekjen"*
*"Kur zbardhi një ditë"*
*"Shembja e idhujve"*
*"Ballë për ballë"*

***KOMPOZITORËT:***

*Kujtim Laro*
*Aleksandër Peçi*
*Shpëtim Kushta*
*Çesk Zadeja*
*Aleksandër Lalo*
*Tish Daija*
*Limoz Dizdari*
*Feim Ibrahimi*

| Fusha: Arte | Lënda: Muzikë | Shkalla: III | Klasa: VII |
|---|---|---|---|

**Tematika:** Teknika dhe procese

**Projekt kurrikular:** “Muzika dhe filmi”

• ***Situata e të nxënit: Muzika përmes njohurive tona***

Nxënësve/eve u kërkohet të gjejnë nëpërmjet internetit materiale mbi muzikën e filmave të ndryshëm shqiptarë.

**Rezultatet e të nxënit të kompetencave të lëndës sipas temës mësimore:**

Nxënësi/ja:

- bashkëpunon me të tjerët për të vendosur se si do të realizohet në grup detyra e ngarkuar mbi muzikën e filmave shqiptar;
- kërkon dhe hulumton nga burime të ndryshme informacioni;
- përzgjedh informacionin e mbledhur;
- përgatit punën e vet individualisht ose në grup;
- respekton mendimin e shokëve/shoqeve;
- përdor media (DVD, CD, magnetofon) për të paraqitur punën e vet.

**Fjalë kyçe:**

- projekt;
- bashkëpunim;
- kolonë zanore.

**Burimet:**

- teksti i nxënësit;
- burime të ndryshme informacioni;
- paraqitje në ppt etj.

**Lidhja me fushat e tjera:**

- shkencat shoqërore dhe mjedisi: historia dhe gjeografia;
- gjuha dhe komunikimi: letërsia.

**• Lidhja me temat ndërkurrikulare**

- të njohim kulturën e njëri-tjetrit.

**Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve**

● ***Ndarja e grupeve dhe ndarja e detyrave***

Mësuesi/ja paraqet që në fillim temën: Muzika dhe filmi. Më pas jep katër çështje, të cilat do të zhvillohen nga nxënësit/et në grupe të veçanta, ku secili prej nxënësve/eve mund të zhvillojë aftësitë më të mira që ka:

**Hapi I:**

*Kërkim informacioni rreth historikut të krijimit të filmit shqiptar:*

- institucioni i parë i filmit shqiptar;
- filmi i parë shqiptar (regjisori, skenaristi, muzika dhe personazhet kryesore që luajnë në film).



*Kinostudio “ Shqipëria sot”*

**Hapi II:**
*Kërkim informacioni për kompozitorët e muzikës së filmit shqiptar:*
- kompozitorët shqiptarë që kanë kompozuar për filma.


*Robert Radoja*


*Aleksandër Lalo*


*Kujtim Laro*



**Hapi III:**
*Përpunimi i informacionit:*
- Sistemon informacionin e grumbulluar dhe e përgatit atë për prezantim.

Grupet punojnë secili në mënyrë të pavarur, i zgjedhur vetë materialet dhe mjetet për të realizuar detyrën e ngarkuar.
Ato i paraqesin produktet e realizuara në fund të tremujorit.
Nxënësit/et e vlerësojnë vetë punën e arritur nga secili grup.

● ***Paraqitja dhe demonstrimi i rezultateve të arritura***

Nxënësit/et:
- punojnë në grup;
- respektojnë mendimin e njëri-tjetrit gjatë punës;
- zhvillojnë detyrën sipas tematikës së caktuar dhe e paraqesin atë.
- ***Detyrë:*** Krijimet e nxënësve/eve ruhen në dosjet e tyre.

● ***Vlerësimi***

Vlerësimi i nxënësit/es do të kryhet për pjesëmarrjen në mënyrë aktive gjatë krijimit muzikor dhe çështje të tjera lidhur me projektin.

# *Plani vjetor mësimor*

**Mësimi 1: Kujtojmë së bashku**
**Mësimi 2: Sinkopa dhe kontratempo**
**Mësimi 3: Nota 1/8 me pikë vlere**
**Mësimi 4: "Pëllumbi i bardhë"**
**Mësimi 5: Ritmet e përziera, ritmi 5/8**
**Mësimi 6: "O sa bukur paske çil-e"**
**Mësimi 7: Ritmi 7/8**
**Mësimi 8: "Lule bore"**
**Mësimi 9: Ritmi 9/8**
**Mësimi 10: "Trimëreshat tona"**
**Mësimi 11: Muzika popullore shqiptare**
**Mësimi 12: Vallja popullore shqiptare**
**Mësimi 13: Verifikojmë njohuritë muzikore**
**Mësimi 14: Melodi dhe këngë popullore**
**Mësimi 15: Muzika polifonike**
**Mësimi 16: "Lunxhëri plot lezete" (valle e kënduar)**
**Mësimi 17: Muzika e kultivuar shqiptare**
**Mësimi 18: "Kënga e krushqve"**
**Mësimi 19: Instrumentet muzikore popullore**
**Mësimi 20: "Thuaja rini"**
**Mësimi 21: Muzika instrumentale shqiptare**
**Mësimi 22: Muzika vokale shqiptare**
**Mësimi 23: Baleti shqiptar**
**Mësimi 24: Verifikojmë njohuritë muzikore**
**Mësimi 25: Muzika profesioniste shqiptare pas viteve '45**
**Mësimi 26: Shkalla muzikore Sol Maxhore**
**Mësimi 27: Shkalla muzikore Mi minore**
**Mësimi 28: Këndojmë në gjuhë të huaj**
**Mësimi 29: Shkalla muzikore Fa Maxhore**
**Mësimi 30: Shkalla muzikore Re minore**
**Mësimi 31: Ushtrime këndimi në Sol+ dhe Fa+**
**Mësimi 32: "Jam i lashtë se jam shqiptar"**
**Mësimi 33: Muzika e filmit**
**Mësimi 34: Kolona zanore nga filma të ndryshëm (dëgjim)**
**Mësimi 35: Verifikojmë njohuritë muzikore**